# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2021 – Numri: 29

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E enjte, 25 shkurt 2021**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Ligj nr. 13/2021, datë 1.2.2021 | Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)....... | 3791 |
| Dekret i Presidentit nr. 11970, datë 18.2.2021 | Për shpallje ligji.................................................................................... | 3863 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 29.1.2021 | Mbi licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Borie – Lurë 1" me kapacitet të instaluar 1800 kw.................................................................. | 3863 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 29.1.2021 | Mbi licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.................................................................. | 3864 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 29.1.2021 | Mbi miratimin e kërkesës së FTL sh.a., për disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë... | 3865 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 29.1.2021 | Mbi licencimin e shoqërisë "Erdy Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.................................................................. | 3868 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 4.2.2021 | Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Aris Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Guri i Zi", me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC "Daznjanë" me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC "Shëlli" me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw.............. | 3869 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 4.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë "E-Vento s.r.l. Albania" sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar...... | 3870 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 4.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar........................................ | 3872 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 4.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë "HERA" sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar........................................ | 3873 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 4.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar...... | 3875 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 4.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar....... | 3876 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 15.2.2021 | Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 169, datë 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a."............................................ | 3878 |

**LIGJ**
**Nr. 13/2021**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, NË LIDHJE ME PROGRAMIN VJETOR KOMBËTAR PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2019, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA II)**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.2.2021

**Shpallur me dekretin nr.11970, datë 18.2.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.**

**MARRËVESHJE FINANCIMI**
**KUSHTET E VEÇANTA**

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni", i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian, më poshtë i referuar si "Unioni", nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si "Përfituesi IPA II", i përfaqësuar nga Zyra e Kryeministrit, nga ana tjetër, bien dakord si më poshtë.

Neni 1
**Programi**

1. Unioni bie dakord të financojë dhe Përfituesi IPA II bie dakord të pranojë financimin e Programit në vijim:

Programi vjetor i veprimit për Shqipërinë për vitin 2019.

Numri i angazhimit global (CRIS): 2019/041-203.

Ky Program financohet nga Buxheti i Unionit, sipas aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit, IPA II[1].

2. Kostoja totale e vlerësuar e këtij programi është 71 905 555 euro dhe kontributi maksimal i Unionit në këtë program, gjithashtu, është vendosur 70 650 000 euro. Ky program kërkon kontribut financiar nga të dyja palët, përfituesi IPA II dhe Bashkimi. Ndarja e kostove të secilit kontribut financiar gjendet në shtojcën I.

3. Programi do të zbatohet në përputhje me përshkrimin e parashikuar në shtojcën I, që detajohet më tej në dokumentet e veprimit, për të cilat do të bihet dakord nëpërmjet shkëmbimit të letrave ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA II.

Neni 2
**Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional**

1. Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi, siç përcaktohet në nenin 12 të shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) është caktuar për 12 vjet që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi

[1] Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, mbi krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), GZ L 77, 15.3.2014, faqe 11.

2. Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional, siç përcaktohet në nenin 12 të shtojcës II (Kushtet e Përgjithshme) është caktuar për 6 vjet që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3
**Adresat dhe komunikimi**

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Financimit do të bëhen me shkrim, dhe do t'i referohen shprehimisht këtij Programi, siç përcaktohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

**1. Për Komisionin**

Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR)
Drejtoria D
Rue de la Loi 15
B-1049 Bruksel
Belgjikë
Tel.: +32 (0)229-57198
Adresa funksionale *email*-it:
NEAR-D4@ec.europa.eu

**2. Për përfituesin IPA II**

Koordinatori Kombëtar i Fondeve IPA - Zyra e Kryeministrit, Kryeministri
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 7, Tiranë, Shqipëri
Adresa e *email*-it funksionale:
zef.mazi@kryeministria.al

Neni 4
**Pika e kontaktit të OLAF-it**

Pika e kontaktit të përfituesit IPA II që gëzon kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Antimashtrim (OLAF), me qëllim që të lehtësojë aktivitetet operacionale të OLAF-it, do të jetë znj. Blerina Naskaj – Në drejtorinë për inspektimet publike financiare/AFCOS (DIFP@financa.gov.al)

Neni 5
**Marrëveshja Kuadër**

Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Unionit për Shqipërinë, sipas Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), i cili ka hyrë në fuqi më datë 16 prill 2015 (në vijim e referuar si "Marrëveshja Kuadër"). Marrëveshja e Financimit plotëson dispozitat e Marrëveshjes Kuadër. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Marrëveshjes së Financimit, nga njëra anë, dhe dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6
**Shtojcat**

1. Marrëveshja e Financimit përbëhet nga:
a) këto Kushte të veçanta;
b) shtojca I: Programi Kombëtar i Veprimit për Shqipërinë për vitin 2019, ku përshkruhen hollësisht objektivat, rezultatet e parashikuara, aktivitetet, përshkrimi i detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit dhe buxheti i Programit;
c) shtojca IA: Mbështetje buxhetore BE për përfshirjen sociale
d) shtojca II: Kushtet e përgjithshme;
e) shtojca III: Model raporti vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, sipas neneve 58 dhe 59(1) të Marrëveshjes Kuadër;
f) shtojca IV: Model raporti financiar, sipas nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër;
g) shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë shtimi;
h) shtojca VI: Masat e këtij rasti për dhënien e detyrave për zbatimin e buxhetit sipas këtij Programi

2. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcave, nga njëra anë, dhe dispozitave të kushteve të veçanta, nga ana tjetër, përparësi do të kenë këto të fundit. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I dhe/ose shtojcës IA, nga njëra anë, dhe dispozitave të shtojcës II, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të konfliktit midis dispozitave të shtojcës I, nga njëra anë, dhe dispozitave të aneksit IA, nga ana tjetër, e para do të kenë përparësi.

Neni 7
**Dispozita që përjashtojnë ose plotësojnë shtojcën II**

Transfertat në valutë do të llogariten sipas datë-valutës në datën e njoftimit të kreditimit te llogaria

e Thesarit nga Banka e Shqipërisë. Norma e këmbimit e përdorur për qëllime raportimi – për tabelën fiskale të Qeverisë – do të jetë një normë këmbimi fikse e llogaritur nga Banka e Shqipërisë për të gjitha transfertat hyrëse, në përputhje me klauzolën e mosdiskriminimit, në datë-valutën kur vjen transferta hyrëse *forex* – konkretisht, norma e këmbimit fikse në ALL e përcaktuar në vendimin nr. 66 të gushtit 2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës dhe dispozitat vijuese.

Neni 8
**Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën në të cilën është nënshkruar nga pala e fundit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2020.

Kjo Marrëveshje Financimi hartohet në dy kopje në gjuhën angleze, njëra i dorëzohet Komisionit dhe kopja tjetër i dorëzohet përfituesit IPA II.

| **Për Përfituesin IPA II:** | **Për Komisionin:** |
|---|---|
| Z. Zef Mazi<br>Kryenegociator,<br>Koordinator Kombëtar i IPA-së<br>Kryeministria: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",<br>Tiranë, Shqipëri<br><br>Datë: | Znj. Genoveva Ruiz Calavera<br>Drejtor<br>Komisioni Evropian<br>DG NEAR/D<br>Rue de la Loi 15<br>B-1049 Brussels, Belgium<br>Datë: |

SHTOJCA II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja


SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITH-SHME

Pjesa e parë: Dispozitat e zbatueshme të aktiviteteve për të cilat përfituesi IPA II është Autoriteti Kontraktues

Neni 1 – Parime të përgjithshme

Neni 1a – Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

Neni 2 – Vizibiliteti dhe komunikimi

Neni 3 – Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni

Neni 4 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuara

Neni 5 – Dispozitat mbi pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesin IPA II

Neni 6 – Ndërprerja e pagesave

Neni 7 – Rikuperimi i fondeve

Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme për mbështetjen buxhetore

Neni 8 – Dialogu mbi politikat

Neni 9 – Verifikimi i kushteve dhe i disbursimit

Neni 10 – Transparenca e mbështetjes buxhetore

Neni 11 – Rikuperimi i mbështetjes buxhetore

Pjesa e tretë: Dispozitat e zbatueshme për Marrëveshjen përkatëse të Financimit pavarësisht nga metoda e menaxhimit

Neni 12 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

Neni 13 – Lejet dhe autorizimi

Neni 14 – Kërkesat e raportimit

Neni 15 – Të drejtat e pronësisë intelektuale

Neni 16 – Konsultimi ndërmjet përfituesit IPA II dhe Komisionit

Neni 17 – Ndryshimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

Neni 18 – Pezullimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

Neni 19 – Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit

Neni 20 – Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve


PJESA E PARË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË AKTIVITETEVE PËR TË CILAT PËRFITUESI IPA II ËSHTË AUTORITETI KONTRAKTUES

Neni 1
**Parime të përgjithshme**

1. Qëllimi i pjesës së parë është përcaktimi i rregullave për zbatimin e detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit të parashikuara në shtojcën I dhe përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve përkatësisht të përfituesit IPA II dhe Komisionit në kryerjen e këtyre detyrave.

Pjesa e parë do të zbatohet për detyrat e zbatimit të buxhetit që i besohen përfituesit IPA II vetëm në lidhje me kontributet e Bashkimit ose të

kombinuara me fondet e përfituesit IPA II apo të një pale të tretë, në rast se fonde të tilla zbatohen në një bashkëfinancim, d.m.th. aty ku ato janë të bashkuara.

2. Përfituesi IPA II mbetet përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje Financimi dhe në Marrëveshjen Kuadër, edhe nëse i nëndelegon subjekteve të tjera të përcaktuara në shtojcën I kryerjen e disa detyrave të besuara për zbatimin e buxhetit. Komisioni, në veçanti, rezervon të drejtën të pezullojë pagesat dhe të pezullojë/ose të anulojë këtë Marrëveshje Financimi mbi bazën e akteve, mosveprimeve dhe/ose situatave të ndonjë subjekti të përcaktuar.

3. Detyrat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni kryhen nga përfituesi IPA II, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratat e grantit në veprimet e jashtme, të cilat ishin në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara për vizibilitetin dhe komunikimin, të përmendura në nenin 2(2).

Përfituesi IPA II kryen procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, lidh kontratat që rezultojnë, dhe siguron që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmën e auditit të jenë në gjuhën e Marrëveshjes së Financimit në fjalë.

4. Përfituesi IPA II duhet të respektojë normën minimale të kontributeve të tij të përcaktuara në shtojcën I. Në rastin kur kontributet jepen si nga përfituesi IPA II dhe nga Bashkimi Evropian, kontributi i përfituesit IPA II do të vihet në dispozicion në të njëjtën kohë si kontributi përkatës nga Unioni.

5. Përfituesi IPA II duhet të ruajë të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse financiare dhe kontraktuese nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi ose nga data më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për propozime apo procedura e drejtpërdrejtë e dhënies së granteve në mënyrë të drejtpërdrejtë ka filluar para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

**a)** Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) njoftimi i parashikimit me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe çdo ndreqje të gabimeve;

b) caktimi i panelit të listës përfundimtare;

c) raporti i listës përfundimtare (përfshirë anekset) dhe i aplikimeve;

d) dëshmia e publikimit të njoftimit të listës përfundimtare;

e) letrat për kandidatët që nuk janë pjesë e listës përfundimtare;

f) ftesa për tender ose ekuivalente;

g) dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarimet, procesverbalet e mbledhjeve, dëshminë e publikimit;

h) caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) raporti për hapjen e tenderit, duke përfshirë anekset;

j) raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara[2];

k) letërnjoftimi;

l) shkresë përcjellëse për dorëzimin e kontratës;

m) letrat për kandidatët e pasuksesshëm;

n) njoftimi për dhënie/anulim, duke përfshirë dëshminë e publikimit;

o) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

**b)** Për thirrjet për propozime dhe procedurat e drejtpërdrejta për dhënien e granteve në veçanti:

a) caktimi i komisionit të vlerësimit;

b) hapja dhe raporti administrativ përfshirë anekset dhe aplikimet e pranuara[3];

c) letër për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm pas vlerësimit të prospektit;

d) raporti i vlerësimit të prospektit;

e) raport vlerësimi i aplikimit të plotë ose raport negocimi me anekset përkatëse;

f) kontrolli i përshtatshmërisë dhe dokumentet mbështetëse;

g) letra për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm së bashku me listën e miratuar rezervë pas vlerësimit të aplikimit të plotë;

h) letër përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) njoftimi i dhënies/anulimit me dëshminë e publikimit;

j) kontratat e nënshkruara, amendamentet, klauzolat shtesë, raportet e zbatimit dhe korrespondenca përkatëse.

---

[2] Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas përfundimit të procedurës së prokurimit.

[3] Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme: tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.

Gjithashtu, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 5(a) dhe (b) të këtij neni do të plotësohen me të gjitha dokumentet mbështetëse përkatëse, siç kërkohet nga procedurat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimet dhe shpenzimet operacionale, për shembull projekti dhe raportet e kontrolleve në terren, pranimi i furnizimeve dhe punimeve, garancitë, raportet e inxhinierëve mbikëqyrës.

Të gjitha dokumentet financiare dhe kontraktuale përkatëse do të ruhen për të njëjtën kohëzgjatje në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

6. Në respekt të nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të ndershme dhe transparente, të mblidhen për qëllime të ligjshme, të përshtatshme, relevante dhe të limituara për atë qëllim që nevojiten. Të përpunohen në mënyrë që të dhënat personale të jenë të sigurta, të bëhet eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme pas tri viteve të mbylljes së procedurave të grantit; Marrëveshja Financiare për programet vjetore IPA II – shtojca II – Kushtet e përgjithshme (V. prill 2020) mbahet në një formë, e cila lejon identifikimin e të dhënave të subjekteve, për jo më shumë kohë se sa nevojitet për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat. Të dhënat personale që përfshihen në dokumente që do të mbahen nga përfituesit, bazuar në nenin 1.5 duhet të eliminohen kur afati final i përcaktuar në këtë nen ka mbaruar.

### Neni 1a
### **Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi**

1. Përfituesi IPA II duhet të informojë Komisionin menjëherë kur një kandidat, tenderues apo aplikant është në situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, kur ka parregullsi apo mashtrim ose kur ka shkelje të rëndë të detyrimeve kontraktuale.

2. Përfituesi IPA II merr përgjegjësinë mbi informacionin e përmbajtur në "Sistemin e identifikimit dhe përjashtimit të hershëm"(EDES) të Komisionit, kur jepen kontratat e prokurimeve dhe granteve. Qasja në informacion mund të ofrohet nëpërmjet pikës/ave ndërlidhëse ose nëpërmjet konsultimit me rrugë të ndryshme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, Zyrtarin Kontabilist të Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe nëpërmjet *email*-it drejtuar Komisionit BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu, të përcaktuar në nenin 3 te Kushtet e veçanta).

3. Kur përfituesi IPA II vihet në dijeni për situatën e përjashtimit në zbatimin e detyrave të përshkruara në shtojcën I, përfituesi vendos përjashtimin e operatorit ekonomik apo aplikantit për grant nga procedura në vijim të prokurimit ose dhënies së grantit. Përfituesi IPA II mund të vendosë penalitete financiare në raport me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose gjobat financiare vendosen pas procedurës së kundërshtimit që garanton të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II njofton Komisionin sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Në lidhje me paragrafin 3 të këtij neni, përfituesi IPA II konsiderohet në kushtet e mosveprimit, nëse nuk vendos përjashtimin apo/dhe penalitet financiar mbi operatorin ekonomik apo aplikantin e grantit.

5. Në rast të pamundësisë për të vepruar, përfituesi IPA II njofton Komisionin, duke shpjeguar arsyet e pamundësisë për të vepruar. Komisioni rezervon të drejtën e përjashtimit të operatorit ekonomik ose aplikantit për grant nga procedurat në vazhdim të BE-së të dhënies së financimit, dhe/ose të vendosë penalitet financiar mbi një operator ekonomik apo aplikant për grant midis 2–10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

### Neni 2
### **Vizibiliteti dhe komunikimi**

1. Në përputhje me nenin 24(3) të Marrëveshjes Kuadër, përfituesi IPA II merr masa për të siguruar vizibilitetin e financimit të BE për aktivitetet që i janë besuar atij, dhe për të përgatitur një plan koherent aktivitetesh vizibiliteti dhe komunikimi, i cili duhet t'i paraqitet Komisionit për pëlqim brenda 2 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit.

2. Këto aktivitete komunikimi dhe vizibiliteti duhet të jenë në përputhje me Manualin e Vizibilitetit dhe të Komunikimit për Veprimet e

Jashtme të BE-së të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 3

**Kontrollet *ex-ante* për procedurat e granteve dhe të prokurimit dhe kontrollet *ex-post* për kontratat dhe grantet që do të kryhen nga Komisioni**

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle *ex-ante* mbi tenderimin e kontratave, lançimin e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat vijuese të dhënies së prokurimit apo të grantit:

a) miratimi i njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tyre;

b) miratimi i dosjeve të tenderit dhe i udhëzimeve për aplikantët për grantet;

c) miratimi i përbërjes së Komiteteve të Vlerësimit;

d) miratimi i raporteve të vlerësimit dhe të marrjes së vendimeve[4];

e) miratimi i dosjeve të kontratave dhe shtesave të kontratave.

2. Lidhur me kontrollet *ex-ante* Komisioni vendos:

a) të kryejë kontrolle *ex-ante* në të gjitha fushat; ose

b) të kryejë kontrolle *ex-ante* në një nga këto fusha; ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet *ex-ante*.

3. Nëse Komisioni vendos të kryejë kontrolle *ex-ante* në përputhje me paragrafin 2(a) ose (b) të këtij neni, ai nuk do të informojë përfituesin IPA II mbi dosjet e përzgjedhura për kontrolle *ex-ante*. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosje për kontroll *ex-ante*, më së fundi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës apo programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë të kryejë kontrolle *ex-post*, përfshirë auditimet dhe kontrollet në terren, në çdo kohë për çdo kontratë dhe grant të dhënë nga përfituesi IPA II që rrjedh nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi IPA II duhet t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm menjëherë pasi informohet mbi përzgjedhjen e një dosje për kontroll *ex-post*. Komisioni mund të autorizojë një person ose subjekt që të kryejë kontrolle *ex-post* në emër të tij.

Neni 4

**Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe shpenzimet e pranuara**

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operuese e përfituesit IPA II, që është Autoriteti Kontraktues për Programin, do të hapë të paktën një llogari bankare të shprehur në euro. Bilanci i përgjithshëm bankar për Programin do të jetë shuma e bilanceve për të gjitha llogaritë bankare të Programit të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat operuese pjesëmarrëse në përfituesin IPA II.

2. Përfituesi IPA II duhet të përgatisë dhe t'i paraqesë Komisionit planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 14(2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet duhet të bazohen në një analizë të hollësishme të dokumentuar (duke përfshirë programin e planifikuar të kontraktimit dhe pagesave për katërmbëdhjetë muajt në vijim), e cila do të vihet në dispozicion të Komisionit, nëse kërkohet.

3. Plani fillestar për parashikimin e disbursimit duhet të përmbajë një përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e Programit. Planet e mëvonshme do të përmbajnë përmbledhje të parashikimeve vjetore të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm të Programit.

4. Përfituesi IPA II kërkohet që të krijojë dhe të ruajë një sistem kontabiliteti, në përputhje me klauzolën 2(3)(b) të shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër, e cila do të përmbajë të paktën të dhëna për kontratat e menaxhuara në kuadrin e Programit të parashikuar në shtojcën V.

[4] Për kontratat e shërbimit ky hap përfshin kontrolle *ex-ante,* në lidhje me miratimin e listës përfundimtare.

5. Shpenzimet e pranuara në sistemin e kontabilitetit, të parashikuar në pjesën 4 të këtij neni, duhet të jenë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojnë me shpenzimet reale të provuara me dokumente mbështetëse dhe duhet të përdoren, kur është e nevojshme, për të likuiduar parafinancimin e paguar nga përfituesi IPA II, sipas kontratave lokale.

6. Përfituesi IPA II duhet t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) raporti i ndërprerjes siç përcaktohet në nenin 14(4);

b) raportet vjetore siç përcaktohet në paragrafët 2 deri 4 të nenit 14;

c) kërkesën për raportet e fondeve, referuar në nenin 5.

Neni 5

**Dispozitat mbi pagesat e kryera nga Komisioni për Përfituesin IPA II**

1. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë parashikimet e tij fillestare të disbursimit, të përgatitura sipas nenit 4(2), së bashku me kërkesën e pagesës së parë të parafinancimit. Pagesa e parë e parafinancimit duhet të jetë për 100% të disbursimeve të parashikuara për vitin e parë të planit të parashikimit për disbursimet.

2. Përfituesi IPA II duhet të paraqesë kërkesat e pagesave vijuese të parafinancimit, kur bilanci i përgjithshëm bankar për Programin bie nën nivelin e parashikimeve të disbursimit për pesë muajt e ardhshëm të Programit.

3. Çdo kërkesë për parafinancim shtesë duhet të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

a) një pasqyrë përmbledhëse e të gjitha disbursimeve të kryera për Programin;

b) bilancet bankare për Programin në datën e ndërprerjes së kërkesës;

c) një plan parashikimi të disbursimeve për Programin për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm që nga dita e ndërprerjes së kërkesës në përputhje me pikën (d) të shtojcës IV.

4. Përfituesi IPA II mund të kërkojë për çdo financim të mëvonshëm shumën e disbursimeve totale të parashikuara për katërmbëdhjetë muaj që nga data e ndërprerjes së kërkesës, pa bilancet e përmendura në pjesën 3(b) të këtij neni në datën e ndërprerjes së kërkesës për fonde të rritura me ndonjë shumë të financuar nga përfituesi IPA II sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni rezervon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë të mëvonshme parafinancimi, nëse bilancet e përgjithshme bankare të kryera nga Përfituesi IPA II, në kuadrin e këtij Programi dhe të gjitha programet e tjera IPA I ose IPA II të menaxhuara nga Përfituesi IPA II, tejkalojnë parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Kur pagesa reduktohet sipas paragrafit 4 të këtij neni, Përfituesi IPA II duhet të financojë Programin nga burimet e veta deri në shumën e reduktimit. Përfituesi IPA II mund të kërkojë më pas rimbursimin e financimit si pjesë e kërkesës së radhës për fonde të parashikuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë të rikuperojë bilancet e tepërta bankare që kanë mbetur pa u përdorur për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para ushtrimit të kësaj të drejte, Komisioni fton Përfituesin IPA II të japë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën e vazhdueshme për ta gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesat e gjeneruar nga parafinancimi i bilanceve bankare të Programit nuk do të paguhen.

8. Sipas nenit 33(4) të Marrëveshjes Kuadër, nëse ndërprerja e afatit kohor për kërkesën e pagesës tejkalon dy muaj, Përfituesi IPA II mund të kërkojë një vendim nga Komisioni lidhur me faktin nëse do të vazhdojë ndërprerja e afatit kohor.

9. Deklarata financiare përfundimtare përmendur në nenin 37(2) të Marrëveshjes Kuadër i paraqitet ZKA-së jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 6

**Ndërprerja e pagesave**

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e Marrëveshjes së Financimit, në përputhje përkatësisht me nenet 18 dhe 19, si dhe pa cenuar nenin 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, nëse:

a) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze se Përfituesi IPA II ka kryer gabime të konsiderueshme, parregullsi apo mashtrime që vënë në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve të veçanta themelore në zbatimin e Programit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij

në kuadrin e Marrëveshjes së Financimit, duke përfshirë detyrimet në lidhje me zbatimin e planit të vizibilitetit dhe komunikimit;

b) Komisioni ka vendosur ose ka shqetësime serioze në lidhje me faktin nëse Përfituesi IPA II ka kryer gabime sistematike ose të përsëritura, parregullsi, mashtrime ose shkelje të detyrimeve në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi apo detyrimeve të tjera të ngjashme, me kusht që këto gabime, parregullsi, mashtrime ose shkelje e detyrimeve, të kenë ndikim material në zbatimin e Marrëveshjes së Financimit apo të vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të brendshëm të kontrollit të Përfituesit IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve kryesore.

Neni 7
**Rikuperimi i fondeve**

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rikuperojë fondet nga Përfituesi IPA II, siç parashikohet në Rregulloren e Financimit, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni ka vendosur se nuk janë përmbushur objektivat e Programit të përcaktuar në shtojcën I;

b) shpenzime të papranueshme;

c) mosrespektimi i normës së kontributit, siç parashikohet në shtojcën I;

d) shpenzime të krijuara si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve ose shkeljes së detyrimeve në zbatimin e Programit, veçanërisht në procedurën e prokurimit dhe të dhënies së granteve.

2. Në përputhje me të drejtën kombëtare, Përfituesi IPA II rikuperon kontributin e Bashkimit që i paguhet Përfituesit IPA II nga marrësit të cilët ishin në çdonjërën nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1, pikat "b" ose "d" të këtij neni ose përmendur në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti që Përfituesi IPA II nuk arrin të rikuperojë një pjesë apo të gjitha fondet, nuk pengon Komisionin të rikuperojë fondet nga Përfituesi IPA II.

3. Shumat e paguara në mënyrë të parregullt ose të rikuperuara nga Përfituesi IPA II, shumat nga garancitë financiare, të performancës dhe parafinancimit të paraqitura mbi bazën e procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga penalitetet financiare të vendosura nga Përfituesi IPA II për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose Përfituesit e granteve për Përfituesin IPA II do të përdoren sërish për Programin ose do t'i rikthehen Komisionit.

PJESA E DYTË
DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR MBËSHTETJEN BUXHETORE

Neni 8
**Dialogu mbi politikat**

Përfituesi IPA II dhe Komisioni marrin përsipër se do të angazhohen në një dialog të rregullt konstruktiv në nivelin e duhur për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 9
**Verifikimi i kushteve dhe i disbursimit**

1. Komisioni verifikon kushtet për pagesën e kësteve të komponentit të mbështetjes buxhetore, siç përcaktohet në shtojcën I dhe shtojcën IA.

2. Në rastin kur Komisioni nxjerr përfundimin se nuk janë përmbushur kushte për pagesat, ai informon pa vonesë Përfituesin IPA II.

3. Kërkesat e disbursimit të paraqitura nga Përfituesi IPA II janë të pranueshme për financimin e BE-së, me kusht që ato të jenë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në shtojcën I dhe shtojcën IA dhe të jenë paraqitur gjatë fazës së zbatimit operacional.

4. Përfituesi IPA II do të zbatojë rregullat e tij kombëtare në kursin e këmbimit të monedhave të huaja në mënyrë jodiskriminuese për të gjitha disbursimet e komponentit të mbështetjes buxhetore.

Neni 10
**Transparenca e mbështetjes buxhetore**

Përfituesi IPA II, me këtë rast bie dakord për publikimin nga Komisioni të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe çdo ndryshimi të saj, përfshirë me mjete elektronike, si dhe të informacionit bazë për mbështetjen buxhetore që Komisioni e çmon të nevojshme. Përmbajtja e publikimit do të jetë në përputhje me ligjet e BE-së të zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11
**Rikuperimi i mbështetjes buxhetore**

Të gjitha disbursimet e mbështetjes buxhetore apo pjesë të tij mund të rikuperohen nga Komisioni, me respektimin e duhur të parimit të proporcionalitetit, nëse Komisioni vendos se pagesa ka qenë e pavlefshme, për shkak të një parregullsie serioze që i atribuohet Përfituesit IPA II, veçanërisht nëse Përfituesi IPA II ka dhënë informacione të pabesueshme ose të pasakta apo nëse ka vend për korrupsion apo mashtrim.

PJESA E TRETË
DISPOZITAT E ZBATUESHME PËR MARRËVESHJEN PËRKATËSE TË FINANCIMIT PAVARËSISHT NGA MËNYRA E MENAXHIMIT

Neni 12
**Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues**

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën e zbatimit operacional, si dhe fazën e mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit përcaktohet në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha gjatë së cilës kryhen të gjitha aktivitetet operacionale të mbuluara me prokurim, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe përcaktohet në nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta, dhe fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Periudhat e ekzekutimit dhe e zbatimit operacional respektohen nga Autoriteti Kontraktues, kur lidh dhe zbaton prokurimet, kontratat e granteve dhe marrëveshjet e delegimit në këtë Marrëveshje Financimi.

4. Shpenzimet e lidhura me aktivitetet janë të pranueshme për financimin e BE-së, vetëm nëse janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit operacional; shpenzimet e bëra nga Përfituesi IPA II para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Financimit nuk janë të pranueshme për financimin e BE-së.

5. Kontratat e prokurimeve dhe granteve do të përfundojnë më e shumta brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Financimit, përveç:

a) ndryshimeve të kontratave që janë lidhur;

b) kontratave individuale të prokurimit që do të lidhen pas ndërprerjes së parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave në lidhje me auditimin dhe me vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen pas zbatimit operacional;

d) ndryshimit të subjektit të ngarkuar me detyrat e besuara.

6. Një kontratë prokurimi ose granti, e cila nuk ka mundësuar ndonjë pagesë brenda dy viteve të nënshkrimit të saj, do të ndërpritet automatikisht dhe financimi i saj do të tërhiqet.

Neni 13
**Lejet dhe autorizimi**

Çdo lloj leje dhe/ose autorizimi i kërkuar për zbatimin e Programit duhet të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente të Përfituesit IPA II, në përputhje me të drejtën kombëtare.

Neni 14
**Kërkesat e raportimit**

1. Për qëllimet e kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit, sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në nenin 59(1) të Marrëveshjes Kuadër për raportin vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II, KKIPA-ja duhet të përdorë modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Për qëllimet e kërkesave specifike të raportimit, sipas menaxhimit të tërthortë, të përcaktuar në nenin 59(2) të Marrëveshjes Kuadër për pasqyrat ose raportin financiar vjetor, për Përfituesin IPA II,ZKA duhet të përdorë modelin e parashikuar në pikat (a) dhe (b) të shtojcës IV të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

3. Për qëllimet e nenit 59(4) të Marrëveshjes Kuadër, KKIPA-ja duhet të paraqesë një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës IPA II të këtij Programi në Komision, jo më vonë se katër muaj pas disbursimit të fundit për kontraktuesit e vet ose përfituesit e granteve.

4. Për qëllimet e nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA-ja duhet të sigurojë në format elektronik deri më 15 janar të vitit financiar vijues një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit përcaktuar në nenin 4(4). Kjo kopje duhet të shoqërohet me një përmbledhje të audituar dhe nënshkruar të raportit financiar në përputhje me pikën (c) të shtojcës IV.

Neni 15
**Të drejtat e pronësisë intelektuale**

1. Kontratat e financuara në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të parashikojnë që Përfituesi IPA II fiton të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale, në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të bërë për qëllime planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.

2. Përfituesi IPA II duhet të garantojë që Komisioni ose kushdo, apo person tjetër i autorizuar nga Komisioni, do të ketë qasje dhe të drejtën që të përdorë një material të tillë. Vetëm Komisioni do të përdorë një material të tillë për qëllimet e veta.

Neni 16
**Konsultimi ndërmjet Përfituesit IPA II dhe Komisionit**

1. Përfituesi IPA II dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin para krijimit të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në zbatim të nenit 20.

2. Në rastet kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, ai vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me Përfituesin IPA II për të rregulluar dhe për të marrë çdo hap të nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, pezullim ose përfundim të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

4. Komisioni vë në dijeni rregullisht Përfituesin IPA II mbi zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk janë në pjesën e parë të Kushteve të përgjithshme.

Neni 17
**Ndryshimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit**

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje Financimi bëhet me shkrim.

2. Nëse Përfituesi i IPA II kërkon një ndryshim, kërkesa duhet t'i paraqitet Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ky ndryshim është planifikuar të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të ndryshojë dokumentet model në shtojcën III, IV dhe V pa bërë të nevojshme ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Përfituesit IPA II informohen me shkrim për çdo ndryshim të tillë dhe hyrjen e tij në fuqi.

Neni 18
**Pezullimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit**

1. Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse Përfituesi IPA II shkel një detyrim, sipas kësaj Marrëveshjeje Financimi;

b) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse Përfituesi IPA II shkel ndonjë detyrim të përcaktuar, sipas procedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër;

c) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse Përfituesi IPA II nuk përmbush kërkesat për t'i besuar detyrat e zbatimit të buxhetit;

d) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi, nëse Përfituesi IPA II vendos të pezullojë ose të pushojë procesin e aderimit të anëtarësimit në BE;

e) Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi, nëse Përfituesi IPA II shkel një detyrim, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetit ligjor, si dhe në rastet e rënda të korrupsionit;

f) Marrëveshja e Financimit mund të pezullohet në rastet e forcës madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" nënkupton çdo situatë ose ngjarje të paparashikueshme dhe të jashtëzakonshme përtej kontrollit të palëve që

pengon secilën prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo pakujdesie nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktuesve, agjentëve apo të punësuarve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme me gjithë kujdesin e duhur. Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk mund të shpallet në shkelje të detyrimeve të saj nëse pengohet t'i përmbushë ato nga një rast i forcës madhore për të cilin pala tjetër është informuar në mënyrën e duhur. Një palë që përballet me forcë madhore duhet të informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe ndonjë masë për minimizimin e dëmit të mundshëm. Nëse forca madhore ndikon vetëm në një pjesë të Programit, pezullimi i Marrëveshjes së Financimit mund të jetë i pjesshëm;

g) asnjë nga Palët nuk mund të shpallet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj, sipas Marrëveshjeje Financimi, nëse pengohet në përmbushjen e tyre, për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm.

2. Komisioni mund të pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë të gjitha masat e nevojshme paraprake para se të ndodhë pezullimi.

4. Në rastin kur njoftohet pezullimi, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim apo që do të nënshkruhet dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e delegimit.

5. Pezullimi i Marrëveshjes së Financimit bëhet pa cenuar ndërprerjen e pagesave dhe përfundimin e Marrëveshjeje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 19.

6. Palët e përfshira rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit, menjëherë pasi këtë e lejojnë kushtet me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo bëhet pa cenuar ndonjë ndryshim të Marrëveshjeje Financimi që mund të jetë i nevojshëm për të përshtatur Programin me kushtet e reja të zbatimit, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e zbatimit operacional dhe periudhat e ekzekutimit, ose përfundimin e Marrëveshjes së Financimit, në përputhje me nenin 19.

Neni 19

**Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit**

1. Nëse çështjet që çuan në pezullimin e Marrëveshjeje Financimi nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen e Financimit pas një njoftimi brenda 30 ditëve.

2. Marrëveshja përkatëse e Financimit duhet të përfundojë automatikisht, nëse brenda periudhës dyvjeçare të nënshkrimit të saj:

a) nuk ka mundësuar ndonjë pagesë;

b) nuk është nënshkruar asnjë kontratë zbatimi apo marrëveshje delegimi.

3. Në rastin kur përfundimi njoftohet, duhet të tregohen pasojat për prokurimin në vijim dhe kontratat e granteve, si dhe marrëveshjet e delegimit që do të nënshkruhen.

4. Përfundimi i Marrëveshjes përkatëse të Financimit nuk përjashton mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenet 36–44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 20

**Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit, që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nëpërmjet konsultimeve ndërmjet palëve të parashikuara në nenin 16, mund të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit me kërkesën e një prej palëve.

2. Secila palë cakton një arbitër brenda 30 ditëve të kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat nga ana e vet caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë arbitrin e tretë.

3. Nëse arbitrat nuk vendosin ndryshe, zbatohet procedura e përcaktuar në Gjykatën e Përhershme të Rregullave Opsionale të Arbitrazhit për Arbitrazhin që përfshin Shtetet dhe Organizatat Ndërkombëtare. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA V E MARRËVESHJES
SË FINANCIMIT

**Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit rritës**

Sistemi i kontabilitetit të Përfituesit IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të pasqyrojë strukturën organizative të vënë në funksionim për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatura për kryerjen e detyrave. Në veçanti, para autorizimit të një operacioni, të gjitha aspektet (si ato operacionale dhe financiare) e operacionit duhet të verifikohen nga anëtarë të stafit dhe jo nga personi që ka nisur operacionin. Personi që merret me procesin e verifikimit nuk mund të jetë nën varësinë e iniciuesit të transaksionit.

2. Të përfshijë gjurmën e auditimit për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet (amendimet).

3. Të ketë sigurinë e duhur fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet mbështetëse dhe ato të rikuperimit.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të mbajë të paktën informacionet e mëposhtme për kontratat lokale të menaxhuara sipas secilit program:

a) Referenca e kontratës;

b) Vlera e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

c) Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);

d) Data për fillimin e zbatimit të kontratës.

Kjo datë jepet përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të ndryshojë prej saj, si në rastin kur data për fillimin e punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës me anë të një urdhri administrativ.

e) Data për përfundimin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim.

Kjo është data e fundit kur mund të krijohen kosto të pranueshme. Kjo datë nuk përfshin asnjë periudhë garancie apo kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

f) Totali i paguar (me para në dorë) me kontratë;

g) Parafinancimi i paguar me kontratë.

Njohja e shprehur dhe regjistrimi në pasqyrën financiare të parafinancimit të kërkuar me kontratë.

h) Kostot e pranuara – të drejtpërdrejta (me kontratë).

Njohja e qartë e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa pagesa do të mbulojnë direkt shpenzimet që janë kryer. Nuk përfshihet parafinancimi. Pagesat mund të jenë përfundimtare kur parafinancimi është shlyer ose mund të jenë pagesa të përkohshme, kur parafinancimi është shlyer ose kur kontrata nuk përfshin dispozitën e parafinancimit.

i) Kostot e pranuara – indirekte (me kontratë).

Njohja e qartë e kostos si pagesë e shpenzimeve të vitit. Disa fatura apo pasqyra shpenzimesh të paraqitura nga kontraktuesi apo përfituesi i grantit do të kenë lidhje me kostot që janë mbuluar nga parafinancimi i paguar më parë gjatë periudhës së zbatimit të kontratës apo të marrëveshjes së grantit. Në këto raste pagesa e kryer do të jetë më e vogël se kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë edhe zero, nëse e gjithë kostoja mbulohet nga parafinancimi (me siguri ajo do të jetë zero nëse kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur parafinancimin dhe për bilancin e pashfrytëzuar të parafinancimit nxirret një urdhër rikuperimi). Në të gjitha këto raste, sistemi duhet të regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë bilancin e parafinancimit nga shuma e kostos së kompensuar kundrejt parafinancimit, kur përcakton shumën që do të paguhet.

j) Urdhra rikuperimi për të reduktuar parafinancimin (me kontratë).

Pranimi i reduktimit të parafinancimit në pasqyrën financiare pas rikuperimit të parafinancimit të pashfrytëzuar.

k) Urdhra rikuperimi për të reduktuar koston (me kontratë).

Kur një rikuperim është bërë kundrejt kostos së pranuar më parë – mundësisht pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla kostot e regjistruara për vitin duhet të ulen, nëse kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperim pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar në një vit më herët se ato të rikuperimit.

l) Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë apo dokument tjetër të shoqëruar me një raport financiar që mundësojnë kostot e pranuara;

m) Të dhëna në kontekstin e rikuperimit për kostot e papranueshme dhe rikuperimet.

INSTRUMENTI PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPA II)
2014–2020

SHTOJCA IA
MBËSHTETJA BUXHETORE E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT PËR PROGRAMIT E VEPRIMIT VJETOR PËR SHQIPËRINË 2019

Shqipëria
BE-ja për përfshirjen sociale

**Përmbledhja e veprimit**

Ky veprim synon të kontribuojë në forcimin e përfshirjes sociale, duke zgjeruar mbulimin, gjithëpërfshirjen dhe efektivitetin e shërbimeve të kujdesit social, ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe mundësitë për punësim. Veprimi mbështet popullatat e rrezikuara nga varfëria dhe përjashtimi social, përfshirë të rinjtë, meshkujt dhe femrat në rrezik, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat. Veprimi mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, duke përmirësuar aksesueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor, përmes mekanizmave të rinj rregullatorë, financues dhe të sigurimit të cilësisë; si dhe përmes përmirësimit të niveleve të mirëqenies së fëmijëve në arsimin parauniversitar, në përputhje me standardet e arsimit gjithëpërfshirës në BE dhe përforcimit të ndërhyrjeve në inspektim, pedagogji, punë sociale dhe psikologji. Gjithashtu, mbështet Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi përmes modeleve të reja të ofrimit të tyre, hapjen e një programi të ri për punësimin e të rinjve që nuk janë në punë apo në arsim ose formim profesional (JPAFP), zgjerimit të mbulimit me programet mirëqenie-përmes-punës, si dhe forcimit të programeve të arsimit dhe formimit

MARRËVESHJA E FINANCIMIT IPA II
PROGRAMET E VEPRIMIT VJETORE

SHTOJCA IA V.1.1

| | |
|---|---|
| **Identifikimi i veprimit** | |
| **Titulli i programit të veprimit** | Programi i Veprimit Vjetor për Shqipërinë për vitin 2019 |
| **Titulli i veprimit** | BE-ja për përfshirjen sociale |
| **Identifikimi i veprimit** | IPA 2019/041-203/Shqipëri/BE-ja për përfshirjen sociale |
| **Informacion sektorial** | |
| **Sektori IPA II** | Punësimi, mbrojtja sociale dhe përfshirja sociale |
| **Sektor DAC** | 160, infrastrukturë tjetër sociale dhe shërbime |
| **Buxheti** | |
| **Kostoja totale** | 71 905 555 euro |
| **Kontributi i BE-së** | 70 650 000 euro |
| **Linja/t e buxhetit** | 22.02.01.02 |
| **Menaxhimi dhe zbatimi** | |
| **Modaliteti i menaxhimit** | Menaxhim direkt |
| *Menaxhim direkt:*<br>**Delegacioni i BE-së**<br>*Menaxhimi indirekt:*<br>**Autoriteti kombëtar ose subjekt tjetër i ngarkuar** | Menaxhim direkt nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri<br><br>Menaxhim indirekt me Shqipërinë nga Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (NJQFK) |
| **Përgjegjësitë e zbatimit** | Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)<br>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<br>Bashkitë e përzgjedhura |
| **Vendndodhja** | |
| **Zona që përfiton nga veprimi** | Shqipëria |
| **Zonat/t specifike të zbatimit** | Shqipëria |

| Afati | |
|---|---|
| **Afati për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit me përfituesin IPA II** | Jo më vonë se data 31 dhjetor 2020 |
| **Afati për lidhjen e marrëveshjeve të kontributit/ delegimit, prokurimet dhe kontratat e grantit** | 3 vjet pas datës së lidhjes së Marrëveshjes së Financimit, përveç rasteve të renditura në nenin 114(2) të Rregullores Financiare |
| **Periudha indikative operacionale e zbatimit** | 6 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit |
| **Afati për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (data kur ky program duhet të mbyllet)** | 12 vjet pas lidhjes së Marrëveshjes së Financimit |

| Objektivat e politikave/treguesit (formulari DAC) | | | |
|---|---|---|---|
| **Objekti i përgjithshëm i politikave** | **I pasynuar** | **Objektiv i rëndësishëm** | **Objektiv kryesor** |
| Zhvillimi i pjesëmarrjes/qeverisja e mirë | ☐ | ☐ | X |
| Ndihma ndaj mjedisit | X | ☐ | ☐ |
| Barazia gjinore (përfshirë gratë në zhvillim) | ☐ | X | ☐ |
| Zhvillimi i tregtisë | X | ☐ | ☐ |
| Shëndeti riprodhues, amësor, i të sapolindurve dhe i fëmijëve | X | ☐ | ☐ |
| **Treguesit e Konventës së RIO-s** | **I pasynuar** | **Objektiv i rëndësishëm** | **Objektiv kryesor** |
| Diversiteti biologjik | X | ☐ | ☐ |
| Lufta ndaj shkretimit | X | ☐ | ☐ |
| Zbutja e ndryshimeve klimatike | X | ☐ | ☐ |
| Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike | X | ☐ | ☐ |
| **Treguesit e brendshëm**[5] | | | |
| Migrimi[6] | x | ☐ | ☐ |
| Përgjigjja ndaj COVID-it | ☐ | ☐ | x |

[5] Këta tregues kanë objekt/synim tjetër nga kodet DAC. Kriteret për kodimin e ndarjes financiare në CRIS/ABAC.
[6] Lutemi, referojuni notës ARES (2019)1031349, datë 19.2.2019.

**Përshkrimi i Veprimit**

**1.1 Objektivat/rezultatet**

**Objektivi i përgjithshëm** është që të zgjerohet mbulimi, gjithëpërfshirja, efektiviteti dhe përballimi i emergjencave nga shërbimet e kujdesit e social, arsimi parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

**Objektivat specifikë** janë si më poshtë:

1. Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe i cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel vendor.

2. Promovimi i përfshirjes sociale në punësimin dhe punësueshmërinë e rinisë, meshkujve dhe femrave.

3. Përmirësimi i nxënies cilësore gjithëpërfshirëse dhe promovimi i formimit arsimor në arsimin parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë – me fokus të veçantë te romët dhe egjiptianët, aftësia e kufizuar dhe kategoritë e tjera të cenueshme.

**Rezultatet e induktuara** të këtij veprimi janë si më poshtë:

- sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor ngrihet dhe bëhet funksional;
- ngrihet kuadri financiar dhe rregullator për standarde dhe praktika moderne të kujdesit social;
- përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në shkolla;
- rritet përfshirja dhe mirëqenia e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- rritet pjesëmarrja në tregun e punës, duke përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi;
- zgjerohet oferta e arsimit dhe e formimit profesional (AFP) e përshtatur sipas nevojave të të rinjve, femrave, meshkujve dhe popullatave të tjera në rrezik përjashtimi nëpër bashki;
- rritet gama dhe synueshmëria e mbështetjes me asistencë monetare për familjet, në përgjigje të krizës së COVID-19;
- zgjerohet mbështetja për familjet më në nevojë nëpërmjet operacioneve ndihmëse, në përgjigje të krizës së COVID-19;
- rritet gama e masave të synuara për të papunët, në përgjigje të krizës së COVID-19.

**Lista e treguesve për objektivat specifikë:**

- përqindja e popullatës që merr paketën bazë të shërbimeve (sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar, romëve dhe egjiptianëve);
- numri[7] i institucioneve të licencuara publike dhe jopublike të kujdesit social;
- numri i bashkive që kontraktojnë dhe prokurojnë shërbime të kujdesit social;
- shkalla e papunësisë për të rinjtë të grupmoshës 15–29 vjeç, ndarë sipas gjinisë;
- përqindja e të diplomuarve në AFP të punësuar (ndarë sipas gjinisë [SKPA]);
- norma neto e regjistrimit në arsimin bazë (klasat 1–9), ndarë sipas gjinisë[8];
- norma e regjistrimit bruto në arsimin dytësor (klasat 10–12) (ndarë sipas gjinisë)[9];
- performanca e nxënësve në lëndët e matematikës, gjuhës dhe shkencës (vlerësimi i PISA-s);
- numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar që përfitojnë nga programet e nxitjes së punësimit (PNP-të) dhe të formimit profesional;
- numri i familjeve që përfitojnë asistencë monetare, përfshirë mbështetjen e synuar në kuadër të masave për përballimin e krizës së COVID-19;
- numri i familjeve që përfitojnë paketat e ndihmës, në përgjigje të krizës së COVID-19;
- numri i përfituesve në sipërmarrjet e vogla të mbyllura përkohësisht, për shkak të COVID-9, që marrin pagën minimale mujore;
- numri i përfituesve në ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha me aktivitetet ekonomike të tkurrura të prekura nga kriza e COVID-19, që përfitojnë ndihmë financiare.

**1.2 Aktivitetet kryesore**

**1.2.1 Mbështetja buxhetore**

Aktivitetet kryesore për zbatimin e paketës së mbështetjes buxhetore janë: dialogu për politikat, transfertat financiare, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.

- Angazhimi në dialogun për politikat mbi kushtet dhe prioritetet e reformave të qeverisë, verifikimi i kushteve, i objektivave dhe pagimi i mbështetjes buxhetore;

---

[7] Numri i shërbimeve sociale të tipologjive të ndryshme (komunitare, në banesë, kujdes ambulator etj.).

[8] Gjithashtu: të dhënat administrative të MASR-së për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë, ndarë sipas etnisë (romët dhe egjiptianët) dhe sipas aftësisë së kufizuar.

[9] Gjithashtu: të dhënat administrative të MASR-së për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin dytësor, sipas llojit të arsimit (të përgjithshëm, profesional), ndarë sipas etnisë (romët dhe egjiptianët) dhe sipas aftësisë së kufizuar.

- Transferimi i 50.65 milionë eurove vendit përfitues gjatë viteve fiskale 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024
- Mbështetje e vazhdueshme për të forcuar kapacitetet institucionale të Qeverisë për zbatimin e Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS), Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe masat shtesë për të zgjeruar objektin dhe ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës;
- Përmirësimi i aftësive dhe i kapaciteteve të fuqisë punëtore në nivel vendor dhe qendror, për të garantuar cilësi të mirë të ofrimit të shërbimeve sociale; aftësimin për arsim gjithëpërfshirës të mësuesve, psikologëve, punonjësve sociale dhe personelit tjetër nëpër shkolla, institucione AFP dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit; zhvillim të aftësive në menaxhim rastesh dhe praktika të tjera bashkëkohore në punën me nevojat e posaçme të grupeve të ndryshme nëpërmjet asistencës teknike;
- Forcimi i koordinimit të donatorëve përmes dialogut periodik dhe forcimit të kapaciteteve në kuadrin e strategjive për mbrojtjen sociale dhe punësim dhe aftësi, si edhe të arsimit gjithëpërfshirës nëpërmjet asistencës teknike dhe skemave grant;
- Forcimi i koordinimit dhe mbështetjes në përballimin e krizës së COVID-19 në fushën e mbrojtjes sociale dhe punësimit;
- Forcimi i sistemeve të monitorimit dhe të vlerësimit për të gjurmuar zbatimin e strategjive për mbrojtjen sociale dhe punësim dhe aftësi, si edhe të dimensioneve të arsimit gjithëpërfshirës dhe përfshirjes sociale në arsimin parauniversitar (APU);
- Forcimi i koordinimit dhe i zbatimit të politikave në nivel vendor, si edhe i partneriteteve ndërmjet bashkive dhe shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve dhe në monitorimin e vlerësimin e standardeve të reja dhe ekzistuese të ofrimit të shërbimit;
- Monitorimi periodik i kritereve të pranueshmërisë për mbështetjen buxhetore;
- Komunikimi dhe vizibiliteti i mbështetjes buxhetore të lidhur edhe me grantet në mbështetje të nivelit vendor;
- Rritja e transparencës dhe e konsultimeve publike me aktorët e shoqërisë civile dhe palët e tjera kyçe të sektorit, si p.sh., operatorët e biznesit dhe partnerët socialë.
- Grantet që synojnë të mbështesin partneritetet bashkiake dhe të zgjerojnë ofrimin e shërbimeve; përmirësimin e tregut të punës dhe të arsimit gjithëpërfshirës për popullatat rome dhe egjiptiane; si edhe zgjerimin e masave të arsimit gjithëpërfshirës në 320 shkolla, duke përfshirë shkollën për fëmijët me paaftësi dëgjimi dhe fëmijët me paaftësi shikimi.

**1.2.2 Mbështetja plotësuese**

Mbështetja plotësuese përfshin ndërthurjen e asistencës teknike në formën e forcimit të kapaciteteve, monitorimit, verifikimit të përputhshmërisë, komunikimit dhe vlerësimit të skemave grant, në kuadrin e menaxhimit direkt dhe indirekt.

**Rezultatet e pritshme** të mbështetjes plotësuese do të trajtojnë si më poshtë:
- Monitorim i shëndoshë i zbatimit të mbështetjes buxhetore;
- Rritje ndërgjegjësimi për politikat dhe strategjitë SKPA dhe SKMS;
- Forcim i kapaciteteve teknike dhe organizative të MSHMS-së, MASR-së, MFE-së dhe bashkive që të koordinojnë dhe të zbatojnë masat e përfshirjes sociale dhe punësimit përmes Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Grupeve Tematike (GT), si edhe të një Grupi për Nxënien dhe Zhvillimin e Politikave dhe Praktikave (PPDL) që fokusohet te koordinimi me bashkitë;
- Zgjerim i gamës së shërbimeve të integruara të kujdesit social, masave të punësimit dhe të arsimit gjithëpërfshirës në nivel vendor, në përputhje me planet sociale të bashkive; duke përfshirë masat për mbrojtjen e grupeve të cenueshme nga kriza e fundit COVID-19.
- Rritje të përfshirjes sociale për të rinjtë dhe të rriturit romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga zgjerimi i rrezes së shërbimit të punësimit dhe i arsimit gjithëpërfshirës në secilën bashki; duke përfshirë ndikimin e krizës së COVID-19 mbi këtë grup në fushën e punësimit dhe të arsimit;
- Forcim kapacitetesh për nxënie me bazë kompetencash dhe përmirësim të arsimit gjithëpërfshirës në mbarë vendin, bazuar në standardet e BE-së.

**Treguesit kyçe të performancës** të mbështetjes sociale përfshijnë:
- Numri i vlerësimeve të pavarura për zbatimin e reformës nën SKPA dhe SKMS dhe

përputhshmërinë me kërkesat e përgjithshme dhe specifike të kontratës së reformës sektoriale të realizuara;

- Numri i aktiviteteve të komunikimit dhe të ndërgjegjësimit si pjesë e planit të komunikimit për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi SKPA-në dhe SKMS-në;

- Numri i dialogëve për politikat të lehtësuara me palët e interesuara kyçe, qeverisjen vendore, donatorët, aktorët joshtetërorë, për të monitoruar zbatimin e reformës në nivel vendor dhe qendror;

- Numri i shërbimeve që ofrohen në bashki për kujdesin social dhe nxitjen e punësimit;

- Përqindja e popullatës rome dhe egjiptiane të synuar nga shërbimet e punësimit dhe të arsimit gjithëpërfshirës;

- Numri i mësuesve të trajnuar mbi kurrikulën parauniversitare (notat 1–5) me bazë kompetencash kyçe.

**1.3 Logjika e ndërhyrjes**

**Logjika e ndërhyrjes** e këtij veprimi synon të kapë ndërveprimet dhe efektet e kombinuara të kontratës së reformës sektoriale dhe dialogut të përforcuar për politikat në fushën e punësimit, politikës sociale dhe përfshirjes sociale edhe në përgjigje të krizës së COVID-19.

Në **nivelin e inputeve,** transferimi i **fondeve të mbështetjes buxhetore** do t'i mundësojë qeverisë të përmirësojë kapacitetet financiare për të marrë përsipër objektivat e politikave në sektorin e mbrojtjes sociale, punësimit dhe aftësive, si edhe për të zbatuar masat që përmirësojnë rezultatet në arsimin gjithëpërfshirës[10]. Përveç kësaj, forcon kapacitetet e Qeverisë që t'i përgjigjet krizës së COVID-19 përmes masave të synuara. Dialogu i vazhdueshëm për politikat do të fokusohet në përmirësimin e koordinimit në këtë sektor; kjo do të kontribuojë ndër të tjera edhe në përmirësimin e ndjekjes së zbatimit të politikave, si edhe do të përmirësojë monitorimin dhe vlerësimin, transparencën dhe llogaridhënien në këtë sektor. Në nivelin e inputeve, **asistenca teknike** do të mbështetë zbatimin e reformës, zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore, rritjen e komunikimit dhe të ndërgjegjësimit, monitorimin periodik dhe verifikimin e përputhshmërisë së ecurisë së reformës në nivel kombëtar dhe vendor. Gjithashtu, asistenca teknike do të mbështetë zhvillimin dhe zbatimin e skemave grant që mbështetin deri në 10 bashki në këto aspekte: zhvillim të aftësive, rishikim dhe hartim të standardeve për shërbimet e kujdesit social, mekanizmat monitorues dhe gamën komunikimit.

Për më tepër, mbështetja plotësuese në formën e **granteve** do të forcojë:

- **Partneritetet për ofrimin e shërbimeve në nivel bashkie.** Objektivi është të krijohen, të mbështeten dhe të përmirësohen kapacitetet për hartimin dhe ofrimin e shërbimeve; të forcohet disponueshmëria e shërbimeve të integruara të kujdesit social, masave të punësimit dhe arsimit gjithëpërfshirës; si edhe të forcohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive.

- **Gante për nxënien ekonomike dhe gjithëpërfshirëse për romët dhe egjiptianët** do të përmirësojë mundësitë e jetesës dhe përfshirjen sociale të të rinjve dhe të rriturve romë dhe egjiptianë në komunitetet e bashkive të përzgjedhura, duke mbështetur bashkitë dhe organizatat vendore të shoqërisë civile që të ofrojnë shërbime të integruara me bazë komunitetin, të cilat kanë si fokus aksesin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në shërbimet e arsimit gjithëpërfshirës. Gjithashtu, granti mundëson një qasje më të synueshme për të bërë të qëndrueshme investimet e BE-së në fushën e përfshirjes së romeve, si edhe forcon harmonizimin me qasjen sektoriale, lidhur me përfshirjen sociale. Skema grant do të mundësojë ofrimin e shërbimeve të integruara për grupet më në rrezik të prekura nga kriza e COVID-19.

Mbështetja plotësuese në formën e menaxhimit indirekt me Shqipërinë, do të përfshijë:

- **Trajnimin e mësuesve lidhur me kurrikulën e nxënies me bazë kompetence dhe me arsimin e përmirësuar gjithëpërfshirës.** Kjo masë mbështet MASR-në në trajnimin e mësuesve, punonjësve socialë, psikologëve dhe administratorëve arsimorë lidhur me kurrikulën parauniversitare për nxënien me bazë kompetence dhe me standardet e BE-së mbi arsimin gjithëpërfshirës.

**Në nivelin e outputeve/rezultateve (të induktuara),** veprimi do të kontribuojë në:

**Një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar**

[10] Transferimi i fondeve të mbështetjes buxhetore do të shoqërohet me dialog periodik për politikat, mes Qeverisë dhe BE-së, mbi masat për mbushjen e boshllëqeve financiare, bazuar në PBA-në.

**në bashki** (që rezulton nga zbatimi i objektivave strategjikë 2 dhe 3 të SKMS-së) që krijon Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (REKSHKSH) në nivel qendror edhe vendor me klasifikim funksional të standardizuar, stokun dhe fluksin[11], menaxhimin e çështjeve, rendin e punës dhe kapacitetet e menaxhimit të ngarkesës së punës; krijon njësitë e vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR) në bashki, të cilat ndihmojnë që nevojat e personave të vlerësohen dhe të plotësohen; rrit numrin e bashkive që kanë plane kujdesi social. Këto masa do të krijojnë një sistem shërbimesh që udhëheq transformimin dhe konsolidimin e institucioneve të mirëqenies sociale në nivel vendor dhe qendror, orienton shërbime drejt promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe ofrimit të shërbimeve të orientuara nga komuniteti dhe familja; zbatimin e modeleve të reja dhe të unifikuara të shërbimeve të kujdesit social, zbatimin e 17 standardeve të dakordësuara[12] të kujdesit, metodologjinë e menaxhimit të çështjeve, profesionalizimin e fuqisë punëtore të sektorit, si edhe forcimin e praktikës profesionale bazuar në standarde strukturore dhe funksionale. Kjo duhet të rezultojë në zgjerimin e rrjetit me shërbime të integruara sociale në mbarë vendin, rritje të mbulimit, profesionalizim, diversifikim të shërbimeve dhe përmirësim të aksesit në shërbime për qytetarët.

**Kuadri financiar dhe rregullator për praktikat dhe standardet moderne të kujdesit social** për praktikat ekzistuese (që rezulton nga zbatimi i objektivit strategjik 3 të SKMS-së). Kjo masë fokusohet në krijimin e politikave kombëtare dhe modeleve të ofrimit të shërbimit, rishikimin e kuadrit për prokurimin e shërbimeve të kujdesit social, si edhe operacionalizimin e *Fondit Social* që të mbështetë bashkitë në krijimin dhe financimin e shërbimeve të reja të kujdesit social në plan afatgjatë. Kjo duhet të rezultojë në krijimin e një sistemi transparent, llogaridhënës dhe efikas për menaxhimin modern të shërbimeve sociale, si dhe në krijimin e një tregu kontraktuesish për shërbimet sociale të ofruara nga OJF-të, bazuar në standardet strukturore dhe funksionale të dakordësuara dhe kostot financiare, përveç shërbimeve që ofron drejtpërdrejt qeverisja vendore e qendrore.

**Përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve në shkolla** (që rezulton nga objektivi strategjik C i SKMS-së dhe objektivi strategjik 2 i SAPU-së) do të synojë të rritë përfshirjen e nxënësve në arsimin e detyrueshëm në zonat urbane, rurale dhe të largëta; do të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e komisioneve arsimore në vlerësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, do të rritë normat e regjistrimit në shkolla, do të garantojë zgjerim të rrjetit të shërbimeve mbështetëse mësimore, psikologjike dhe punës sociale në shkolla, si edhe do të garantojë shërbimet dhe kushtet e nevojshme për reduktimin e rrezikut të përjashtimit dhe braktisjes së shkollës nga djemtë dhe vajzat, përfshirë fëmijët romë.

**Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës nga të rinjtë, femrat dhe meshkujt dhe popullatat në rrezik përjashtimi** (që rezultojnë nga objektivat strategjikë 1 dhe 3 të SKPA-së) do të rezultojë në një model shërbimesh që rrit rrezen e masave në tregun e punës për grupet e përjashtuara dhe të cenueshme, me fokus të veçantë për personat me aftësi të kufizuara; mundësi punësimi

---

[11] *Stoku* matet në një moment specifik në kohë dhe përfaqëson numrin e rasteve të shërbimeve sociale që ekzistojnë në atë moment, të cilat mund të jenë akumuluar nga e kaluara. *Fluks* është variabël që matet gjatë një intervali kohor. Pra, fluksi matet *ndaj njësisë së kohës* (p.sh., gjatë një viti). Fluksi është pak a shumë i ngjashëm me normat/përqindjen e rasteve të shërbimeve sociale që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga sistemi.

[12] 1. VKM i përgjithshëm i vitit 2005 për parimet dhe rregullat e përgjithshme të menaxhimit të çështjeve. 2. Standardet për fëmijët në institucionet rezidenciale (2005, VKM). 3. Standardet për të moshuarit në institucionet rezidenciale (2006, VKM). 4. Standardet për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në institucionet rezidenciale dhe ditore (20206, VKM). 5. Standardet për të moshuarit në qendrat ditore (2006, VKM). 6. Standardet për viktimat e dhunës në familje në qendrat rezidenciale (2011, VKM). 7. Standardet për viktimat e trafikimit në institucionet rezidenciale (2007, VKM). 8. Standardet për fëmijët në nevojë në qendrat ditore (2013, VKM). 9. Standardet për kujdesin kujdestar për fëmijët në nevojë (2010, VKM). 10. Standardet në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave (2015, VKM). 11. Standardet për asistencën shtëpiake për personat me aftësi të kufizuara (2017, udhëzim ministri). 12. Standardet për asistencën shtëpiake për të moshuarit (2017, udhëzim). 13. Standardet për qendrat shtëpi-familje për fëmijët 16–18 vjeç (2017, udhëzim). 14. Standardet për shërbimet e njësisë së mbrojtjes së fëmijës (2015, VKM). 15. Standardet për linjën kombëtare të këshillit për viktimat e dhunës në familjes (2016, udhëzim). 16. Standardet për qendrat multidisiplinare (2018, udhëzim). 17. Standardet për qendrat e menaxhimit të krizës për viktimat e dhunës në familje (2018, udhëzim).

të përshtatura për kategoritë e marzhinalizuara dhe të cenueshme: të rinjtë, femrat dhe meshkujt, përfshirë të rinjtë romë dhe egjiptianë që nuk janë në punë dhe as në arsim apo formim profesional (PAFP), si edhe krijimi i kushteve për nxitjen e punësimit dhe reduktimin e praktikave diskriminuese në vendin e punës si pjesë e modeleve të reja për nxitjen e punësimit të denjë. Gjithashtu, kjo do të rezultojë në sisteme të përshtatura për zgjerimin e shërbimeve të punësimit, nxitjen e modeleve të bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, si p.sh., investimet për rikonfigurimin dhe shtrirjen e programeve të nxitjes së punësimit (PNP-të) te popullatat në rrezik përjashtimi, zgjerimin e mbulimit të programit të aftësimit për punë (të të papunëve) për të reduktuar varësinë ndaj ndihmës ekonomike (në *cash),* si edhe përmirësimin e integrimit social për punëkërkuesit femra dhe meshkuj.

**Shtrirja e ofertës së arsimit dhe të formimit profesional në të gjitha bashkitë dhe te grupet më të marzhinalizuara** (që rezulton nga objektivat strategjikë 2 dhe 3 të SKPA-së): rritja e ofertave AFP (përfshirë infrastrukturën AFP) në ekonominë rurale, si edhe arritja te personat e cenueshëm në këto zona, me fokus të veçantë për identifikimin e boshllëqeve në aftësi dhe krijimin e kurseve të rishikuara AFP dhe të kualifikimeve të reja; përmirësimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuara; formimi profesional dhe punësimi i femrave dhe i meshkujve të marzhinalizuar dhe të cenueshëm, përfshirë romët dhe personat me aftësi të kufizuara; forcimi i ofruesve AFP që të jenë në gjendje të ofrojnë kurrikula AFP të reja dhe të përshtatura për ekonomitë rurale.

**Përmirësimi i kompetencave dhe i aftësive të personelit mësimdhënës dhe shkollor në nxënien cilësore gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar** (që rezulton nga objektivi strategjik C i SKMS-së dhe objektivi strategjik B4 i PAFP-së): reformimi i Institutit të Zhvillimit të Kurrikulave (IZHK) në një Agjenci të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) do të rezultojë në sisteme planifikimi të përmirësuara për ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës, në përputhje me standardet BE-së, që ofron sigurim cilësie më të mirë dhe funksione inspektimi më afër shkollave dhe komuniteteve, si edhe do të ndryshojë standardet për nxënien me bazë kompetence dhe arsimin gjithëpërfshirës. Masat do të reduktojnë edhe kërkesën e ardhshme për shërbime të kujdesit social.

**Në nivelin e rezultateve** (objektiva specifikë):

- "Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe i cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor" do të rezultojë në forcim të strukturave drejtuese për përfshirjen sociale, ndërsa zgjerohet hapësira financiare për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve të integruara moderne dhe për të përmirësuar aksesueshmërinë për qytetarët dhe grupet e cenueshme, duke përfshirë romët dhe egjiptianët;
- "Përmirësimi i përfshirjes sociale në punësim dhe punësueshmëri për të rinjtë, meshkujt dhe femrat në Shqipëri" do të rezultojë në shërbime publike punësimi më efikase dhe më të aksesueshme, si edhe në shkolla dhe ofrues AFP më të avancuar që do të kontribuojë në një shoqëri më përfshirëse, duke forcuar përfshirjen sociale dhe përfshirjen në tregun e punës për grupet e marzhinalizuara dhe të cenueshme;
- "Përmirësimi i nxënies cilësore gjithëpërfshirëse dhe nxitja e formimit parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë" do të rezultojë në formim arsimor më të mirë bazuar në standardet e nxënies me bazë kompetence, zhvillim të mësuesve dhe përmirësim të mirëqenies së fëmijëve, që nxit aftësive e ardhshme kognitive dhe jokognitive (aftësitë e buta) dhe u mundëson të funksionojnë në tregun e punës dhe të kontribuojnë në një shoqëri më kohezive dhe përfshirëse. Gjithashtu, tjetër rezultat do të jetë që shkollat do të kenë një sistem paralajmërimi të hershëm për identifikimin dhe mbajtjen në shkollë të fëmijëve të cenueshëm, që rrezikojnë ta braktisin shkollën, apo që janë nën rrezikun e bullizmit, abuzimit, neglizhencës dhe radikalizimit.

**2. Zbatimi**

**2.1 Argumentimi për shumat e alokuara për mbështetjen buxhetore**

Shuma e alokuar për komponentin e mbështetjes buxhetore është 50.650 milionë euro dhe 20 milionë euro për mbështetjen plotësuese. Shumat bazohet në një kombinim faktorësh: a) kostimi i strategjive; b) vlerësimi indikativ i boshllëqeve financiare; c) niveli i vlerësuar i financimit kombëtar, që nxit mjaftueshëm mbështetjen e reformave; dhe d) kostimi i masave për përballimin e krizës së COVID-19. Vlerësimi fillestar i kostove totale për zbatimin e Planeve të

Veprimit deri në vitin 2022 është 1.193 milionë euro, nga të cilat 1.038 milionë euro parashikohet të mbulohen me fonde buxhetore – përfshirë rezervat specifike të lëna mënjanë për të mbështetur zbatimin e strategjisë. 86 milionë euro është nënfinancimi total në nivelin qendror të qeverisjes, bazuar në zbatimin e objektivave dhe të masave të përcaktuara në SKPA dhe SKMS dhe të masave për mirëqenien e fëmijëve në shkolla dhe arsimin gjithëpërfshirës, siç përcaktohet në planin APU. Gjithashtu, funksionet e pafinancuara në shërbimet e kujdesit social vlerësohet se arrijnë në 15.8 milionë euro dhe 9 milionë euro për arsimin. Kriteret për disbursimin e mbështetjes buxhetore:

a) Kushtet e përgjithshme për garantimin e të gjitha transheve janë si më poshtë:

- progresi i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2015–2022 dhe të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015–2023, si edhe besueshmëria dhe relevanca e vazhdueshme e tyre;
- zbatimi i një politike të besueshme të stabilitetit makroekonomik;
- progresi i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë së Reformimit të Menaxhimit Financiar Publik;
- progresi i kënaqshëm lidhur me disponueshmërinë e informacionit buxhetor në kohë reale, tërësor dhe të qëndrueshëm.
- treguesit specifikë për disbursimin që mund të përdoren për transhet e ndryshueshme jepen në shtojcën 2. Nëse ka konflikt informacioni midis shtojcës 2 dhe tabelës D, shtojca 2 do të ketë përparësi.

Objektivat dhe treguesit e performancës që zgjidhen për disbursimin, vlejnë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit. Megjithatë, në rrethana të justifikuara siç duhet, Ministria e Financave dhe Ekonomike (MFE), nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar IPA, mund t'i paraqesë një kërkesë Komisionit për ndryshimin e objektivave dhe të treguesve. Ndryshimet e miratuara për këta objektiva dhe tregues mund të miratohen me shkëmbim letrash ndërmjet dy palëve, Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) dhe Komisionit.

Në rast përkeqësimi thelbësor të vlerave kryesore, disbursimet e mbështetjes buxhetore mund të pezullohen formalisht, të pezullohen përkohësisht, të reduktohen apo të anulohen, sipas dispozitave përkatëse të marrëveshjes së financimit.

Zbatimi i masave për COVID-19 lidhur me mbrojtjen sociale dhe punësimin renditen më poshtë:

- Familjet që përfitojnë asistencë sociale, duke përfshirë masat e përballimit të krizës së COVID-19 (VKM 254/27.3.2020 dhe VKM 341/23.4.2020)
- Familjet që përfitojnë paketën e ndihmës për përballimin e krizës së COVID-19 (VKM 236/19.3.2020);
- Përfituesit në sipërmarrje të vogla të mbyllura përkohësisht, për shkak të COVID-19, të cilët marrin pagën minimale mujore (VKM 254/27.3.2020; VKM 7/9.4.2020);
- Përfituesit në sipërmarrje të vogla dhe të mëdha me aktivitet ekonomik të reduktuar, të prekur nga kriza e COVID-19, që përfitojnë ndihmë financiare (VKM 305,/16.4.2020).
- Progresi në zbatimin e masave në fjalë do të vlerësohet bazuar në një raport specifik që autoritetet shqiptare e dorëzojnë në kontekstin e disbursimit të transhit fiks.

**2.2 Hollësitë e mbështetjes buxhetore**

Mbështetja buxhetore totale ndahet në pesë transhe fikse dhe katër transhe variabël. Treguesit specifikë për disbursimin e secilit transh specifikohen në shtojcën 3.

Mbështetja buxhetore i jepet thesarit kombëtar, si mbështetje direkte e pasynuar. Kreditimi i transfertave në euro mund të bëhet në monedhën euro ose lek, që kalojnë me kursin e këmbimit e përshtatshëm, sipas dispozitave përkatëse të marrëveshjes së financimit. Pas marrjes së pagesës, Ministria e Financave paraqet dokumentacion që dëshmon se fondet janë regjistruar në llogarinë e thesarit kombëtar.

**2.3 Struktura organizative dhe përgjegjësitë**

Përfituesit direkt të veprimit të propozuar janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), si edhe qeverisja vendore në bashkitë e përzgjedhura për të marrë pjesë në këtë veprim. Qeveria e Shqipërisë ka vendosur prej kohësh masa ndërinstitucionale dhe operacionale-organizative që të menaxhojë zbatimin e një qasjeje të gjerë sektoriale/ndërsektoriale përmes Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili shërben si sistemi kryesor që përcakton instrumentet dhe mekanizmat për planifikimin e integruar të

politikave publike, duke garantuar alokim efektiv të burimeve financiare.

Urdhri i Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, përcakton qasjen sektoriale/ ndërsektoriale për menaxhimin dhe koordinimin e politikave në fushat dhe sektorët prioritarë me rëndësi të veçantë, si edhe programimin ndërsektorial përmes formimit të një mekanizmi menaxhimi sektorial/ndërsektorial të quajtura Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe Grupet Tematike (GT) për bashkëpunimin në nivel teknik dhe me partnerët për zhvillim, brenda sektorëve specifikë të fushave prioritare përkatëse.

GMIP-ja për "Punësimin dhe aftësitë" është krijuar dhe kryesohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë. Mbledhjen e parë e zhvilloi më 20 dhjetor 2018, në kuadër të urdhrit të rishikuar të Kryeministrit. GMIP-ja për punësimin dhe aftësitë kryen rolin e monitorimit sektorial të Sektorit IPA për Arsimin, Punësimin dhe Politikat Sociale, kapitujt 2, 3, 19, 25, 26 dhe 28 të *acquis,* si dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). GMIP-ja përbëhet nga dy grupe tematike: i. Punësimi dhe trajnimi; dhe ii. Përfshirja dhe mbrojtja sociale. Kjo strukturë garanton bashkëpunim dhe vendimmarrje të përbashkët në nivel të lartë politik dhe drejtues për planifikimin, koordinimin e batimit dhe monitorimin e politikave dhe programeve kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale në fushat prioritare. GMIP-ja për punësimin dhe aftësitë po koordinon edhe punën për përballimin e COVID-19 në bashkëpunim të ngushtë me ministrin për Rindërtimin, që është ngarkuar me rimëkëmbjen pas COVID-19 dhe tërmetit.

Për koordinimin dhe angazhimin e qeverisjes vendore, do të ngrihet një grup për Zhvillimin dhe Mësimin e Politikave dhe Praktikave (PPDL) Praktikave, i bërë nga bashkitë pjesëmarrëse, MFE, MSHMS dhe MASR, për të garantuar dialogun për politikat dhe menaxhimin e njohurive ndërmjet nivelit qendror dhe rajonal. Ky mekanizëm mund të ofrojë kontribute për grupin tematik për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale. Secila bashki pjesëmarrëse do të përfaqësohet në PPDL-ja nga kryetari i emëruar i Ekipit Bashkiak të Ofrimit të Shërbimeve (MSDT). Delegacioni i BE-së do të lidhë marrëveshje partneriteti me bashkitë e përzgjedhura dhe me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për të garantuar bashkëpunimin institucional përgjatë programit.

Në nivel bashkie do të emërohet një koordinator vendor i MSDT-së dhe do të ngrihet një grup pune i përbërë nga përfaqësues të institucioneve përfituese, si edhe në çdo bashki do të ngrihen agjenci të përbëra nga palë të interesuara të tjera. Gjatë zbatimit, do të organizohen sistematikisht konsultime me përfaqësuesit e organizatës së shoqërisë civile, partnerët për zhvillim, biznesin privat dhe palët e tjera të interesuara.

**2.4 Monitorimi dhe raportimi i performancës**

Monitorimi i përditshëm teknik dhe financiar i zbatimit të këtij veprimi do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerit zbatues. Për këtë qëllim, partneri zbatues krijon një sistem të përhershëm monitorimi të brendshëm teknik dhe financiar për veprimin si edhe përgatit raporte progresi periodike (jo më pak se vjetore) dhe raporte përfundimtare. Secili raport duhet të japë panoramën e qartë të zbatimit të veprimit, vështirësitë e hasura, ndryshimet e bëra dhe shkallën e arritjes së rezultateve (rezultatet dhe produktet direkte) matur me treguesit korrespondues, duke përdorur për referencë listën e treguesve të rezultateve. Raporti përpunohet në mënyrë të tillë që të lejojë monitorimin e mjeteve të parashikuara dhe të përdorura, si edhe të hollësive të buxhetit për veprimin. Raporti përfundimtar në formë përshkruese dhe financiare do të mbulojë të gjithë periudhën e zbatimit të veprimit.

MSHMS-ja ka rolin drejtues në mbrojtjen sociale, MFE-ja ka rolin drejtues në punësim dhe aftësi, ndërsa MASR-ja ka rolin drejtues në mirëqenien e fëmijëve në shkolla dhe arsimin gjithëpërfshirës. Bashkitë kanë përgjegjësi për shërbimet e kujdesit social, ofrimin e parashkollorit (çerdhet dhe kopshtet) dhe për bashkëpunimin me Shërbimin Kombëtar të Punësimit (SHKP) për punësimin. Monitorimi përmes grupeve, tematika dhe grupit PPDL bazohet në rezultatet e planit të veprimit që u shërbejnë qëllimeve të treguesve të rezultateve.

Në **nivel kombëtar**, zbatimi i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale monitorohet përmes një sistemi vlerësimi performance, bazuar në rezultate, i cili bazohet në objektivat e politikës dhe objektivat e programit, si pjesë e **Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI)** të Qeverisë, koordinuar nga Kryeministria. SPI-ja përcakton parimet funksionale për të garantuar që planifikimi, buxhetimi dhe monitorimi i politikave të qeverisë të harmonizohen dhe të funksionojnë me efikasitet. SPI-ja është sistemi kombëtar kyç për drejtimet strategjike dhe harmonizimin e alokimit të burimeve. SPI-ja orienton PBA-në dhe procesin e buxhetit vjetor, duke ofruar objektivat e politikave, të cilët përfshihen në udhëzimet që Ministria e Financave u përcjell të gjitha ministrive dhe agjencive për përgatitjen e buxhetit. Gjithashtu, orienton dhe informon GMIP-në për punësimin dhe aftësitë, si edhe punën e SSC-së dhe TC-ve.

Përveç kësaj, do të sigurohet koordinimi me ministrin për Rindërtimit të sapoemëruar, i cili është i ngarkuar me përballimin e pasojave të tërmetit dhe krizës COVID.

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Financave Publike 2014–2020 është thelbësore edhe për mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësive dhe nxënien gjithëpërfshirëse në kontekstin e përmirësimit të PBA-së dhe rrjedhimisht për planifikimin, buxhetimin dhe monitorimin e duhur të SKPA-së dhe SKMS-së, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të bashkive që të harmonizojnë politikat dhe ciklet e tyre të planifikimit dhe buxhetimit me PBA-në.

Zbatimi i Strategjisë MFP është relevant edhe për arritjen e kritereve të përgjithshme të pranueshmërisë lidhur me mbështetjen buxhetore të BE-së për përfshirjen sociale (stabiliteti makroekonomik, menaxhimi i financave publike dhe transparenca dhe mbikëqyrja buxhetore). Raportet e zbatimit të strategjisë MFP hartohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Reformës së Financave Publike, diskutohen dhe miratohen në Komitetin Teknik dhe Komitetin Drejtues, si edhe publikohen çdo vit në tremujorin e parë të vitit pasues. Njëkohësisht, SKPA dhe SKMS dhe masat e harmonizuara me arsimin gjithëpërfshirës do të kontribuojnë në reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social, si edhe do të përmirësojnë kapitalin njerëzor. Për komponentët "asistencë teknike" dhe "grant", Komisioni mund të kryejë vizita monitorimi shtesë me personelin e vet dhe nëpërmjet konsulentëve të pavarur të pajtuar drejtpërdrejt nga Komisioni për vlerësim e monitorim të pavarur (ose të pajtuar nga agjenti përgjegjës i kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e vlerësimeve të tilla). Monitorimet kryhen sipas udhëzimeve të DG NEAR për lidhjen e planifikimit/programimit, monitorimit dhe vlerësimit[13].

Çdo vit do të ketë monitorime që vlerësojnë performancën përkundër kushteve, ku nga shkalla e përputhshmërisë do të varet masa e pagesave të transheve variabël. Secili monitorim do të vlerësojë 4 kriteret e përgjithshme të pranueshme për Mbështetjen Buxhetore Sektoriale (MBS) dhe vlerëson progresin e kënaqshëm, si dhe relevancën dhe besueshmërinë e vazhdueshme të secilit kriter.

Përputhshmëria me të katra kushtet e përgjithshme rezulton në pagimin e transheve fikse pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit. Gjithashtu, DG NEAR mund të përdorë Monitorimin e Orientuar nga Rezultatet (ROM), si pjesë e angazhimeve të veta për të monitoruar shpenzimin e ndihmës, në kuadrin e Rregullores Financiare të BE-së.

**2.5 Vlerësimi dhe auditimi**

Vlerësimet e komponentit "mbështetja buxhetore" duhet të harmonizohen me ushtrime të ngjashme nga ofrues të tjerë të mbështetjes buxhetore me qëllim llogaridhënien dhe nxënien (edhe për rishikimin e politikave) në nivele të ndryshme dhe që kryhen nga konsulentë të pavarur.

Për mbështetjen plotësuese, Komisioni mund të kryejë edhe vlerësime të jashtme nëpërmjet konsulentëve të pavarur, si më poshtë:

a) mision vlerësimi afatmesëm;

b) vlerësim përfundimtar, në fillim të fazës mbyllëse;

c) vlerësim *ex post*.

Për mbështetjen plotësuese, auditimi (nëse ka) do të financohet me një tjetër vendim.

[13] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/tenders/monitoring-and-evaluation_cs

Vlerësimet do të kryhen sipas udhëzimeve të DG NEAR për lidhjen e planifikimit/ programimit, monitorimit dhe vlerësimit.[14]

Komisioni e njofton partnerin zbatues të paktën një muaj përpara për datat e parashikuara kur do të kryhen misionet e vlerësimit. Partneri zbatues bashkëpunon me efikasitet dhe efektivitet me ekspertët e vlerësimit, si edhe u vë në dispozicion, ndër të tjera, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si edhe aksesin në ambientet dhe aktivitetet e projektit.

Raportet e vlerësimit u vihen në dispozicion vendit partner dhe palëve të interesuara kryesore. Partneri zbatues dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, në marrëveshje me vendin partner, vendosin bashkërisht për masa ndjekëse që duhen marrë apo ndonjë rregullim të nevojshëm, përfshirë edhe riorientimin e projektit, nëse rezulton i nevojshëm.

[14] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/tenders/monitoring-and-evaluation_cs

# LIDHJA 1
## PËRZGJEDHJA INDIKATIVE E TREGUESVE TË REZULTATEVE[15]

Inputet, outputet e pritshme direkte dhe të induktuara dhe të gjithë treguesit, objektivat dhe vlerat bazë të përfshira në listën e treguesve të rezultateve janë indikative dhe përditësohen gjatë zbatimit. Tabela me listën indikative të treguesve të rezultateve do të evoluojë gjatë kohëzgjatjes së veprimit: kolona të reja do të shtohen për objektivat e ndërmjetëm (kryesorë), kur është e nevojshme edhe për qëllime raportimi mbi arritjen e rezultateve të matura sipas treguesve.

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi i përgjithshëm: Ndikimi** | Zgjerimi i mbulimit, gjithëpërfshirjes, efektivitetit dhe përballimin e emergjencave të shërbimeve të kujdesit social, arsimit parauniversitar dhe mundësive për punësim për të rinjtë dhe të rritur në Shqipëri, përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi *(Lidhur me ICSP-në dhe me shtyllën 3 të SKZHI 2015–2020)* <br><br> **ICSP = Instrumenti Kontribues në Stabilitet dhe Paqe* | Shkalla e punësimit të popullsisë 15–64 vjeç, sipas gjinisë. | 59.5% - total; *52.4 % - femra 66.7% - meshkuj (AFP 2018)* | 60.5% total | 60.5% total | INSTAT/Anketa e Forcave të Punës (AFP) |
| | | Hendeku gjinor në punësim (15–64) | *14.3 pikë përqindjeje (p.p.) 2018* | 14.05 p.p[16]. | 13.8 p.p. | INSTAT/Anketa e Forcave të Punës (AFP) |
| | | Në rrezik varfëria dhe përjashtimi social[17] [18](AROPE) | 49% (2018) (49.9% femra, 48% meshkuj) | 49% | Trend përmirësimi[19] | INSTAT/Statistika për të ardhurat dhe kushtet e jetesës(AANJ) |
| | | Niveli i përgatitjes i vlerësuar nga KE-ja për kapitullin 19 (Politikat sociale dhe punësimi) | Relativisht e përgatitur | Relativisht e përgatitur | Disi më e përgatitur | Raporti vjetor i KE-së |
| **Objektivat specifikë: Rezultatet** | 1. Përmirësimi i aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivel vendor <br><br> *(me fokus të veçantë për të rinjtë, femrat, romët, personat me aftësi të kufizuara dhe të papunët afatgjatë).* <br> *(lidhur me objektivin specifik 3 të Strategjisë Kombëtare të* | Përqindja e popullsisë që përfiton paketën bazë të shërbimeve të kujdesit social[20] | 0.3% | 0.4% | 0.5% | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Shërbimet Sociale Shtetërore/Të dhëna administrative të qeverisjes vendore |

[15] Treguesit e harmonizuar me dokumentin e programimit shënohen me *. Treguesit e harmonizuar me kuadrin e rezultateve të BE-së shënohen me **.
[16] 0,25 rënie nga vlera bazë e vitit 2018 - 14.3.
[17] AROPE tregon përqindjen e popullsisë, që: a) është në rrezik varfëria pas transfertave sociale (persona që marrin të ardhura të ekuivalentuara nën 60% të të ardhurave mesatare të ekuivalentuara; b) janë të privuar rëndë materialisht (persona që për shkak të mungesës së mjeteve financiare, nuk përballojnë të paktën 4 nga 9 artikuj të privimit material familjar; dhe c) që jeton në familje me zero apo shumë pak intensitet pune (të rriturit punojnë për më pak se 20% e numrit total të muajve gjatë periudhës referuese gjatë së cilës mund të punonin).
[18] Objektivat nuk marrin parasysh ngjarje të paparashikueshme si forcat madhore.
[19] Sipas INSTAT +/- 3%.
[20] Sipër përkufizimit në ligjin 121/2016 dhe VKM-në nr. 518, datë 4.9.2018 (nuk përfshin përfitimet në *cash*).

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | *Mbrojtjes Sociale 2020-2023)* | Numri i institucioneve publike dhe jopublike të liçencuara për kujdesin social[21] | 270 (nëntor 2019) | 280 | 300 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Shërbimet Sociale Shtetërore/Të dhëna administrative nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Shërbimi Social Shtetëror |
| | | Numri i bashkive që kontraktojnë dhe prokurojnë shërbime të kujdesit social në përputhje me kuadrin rregullator të rishikuar dhe të miratuar.<br><br>*(Parakusht për MBS; Qeveria nxjerr udhëzim rregullator mbi kuadrin ligjor për prokurimin e shërbimeve të kujdesit social)* | 0 | 0 | 15 bashki kontraktojnë dhe prokurojnë shërbime të kujdesit social në përputhje me kuadrin rregullator të rishikuar dhe të miratuar. | Agjencia e Prokurimit Publik/Të dhëna administrative nga Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Social Shtetëror |
| | 2. Promovimi i përfshirjes sociale në punësim dhe punësueshmëri për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri *(lidhur me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2020-2022)* | Shkalla e punësimit e rinisë të grupmoshës 15-29 vjeç, sipas gjinisë. | Të rinjtë- 23.1%, *(23,1%-femrat; 23,1% - burrat) AFP 2018* | 22.0% | 21.0 % | Ministria e Financave dhe Ekonomisë/SKPA/INSTAT (AFP) |
| | | Përqindje e të diplomuarve në AFP të punësuar [22] | 64% - 2018 | 64.5%[23] | 65.5%[24] | MFE/SKPA<br>Sistemi i gjurmimit, |
| | 3. Përmirësimi i nxënies cilësore gjithëpërfshirëse dhe promovimi i formimit arsimor në arsimin parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë, me | Norma (%) neto e regjistrimit në arsimin bazë (klasat 1–9), sipas gjinisë[25] | 96.5% (2018 total) (meshkuj: 97.4; femra: 95.6) | 96.6%[26] | 96.7%[27] | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/INSTAT/Statistikat arsimore |

[21] Numri i shërbimeve të kujdesit social të topologjive të ndryshme (komunitare, rezidenciale, kujdes ditor etj.).
22 Llogaritur për secilin vit si numri total i të diplomuarve AFP që punësohen, pjesëtuar me diferencën mes të diplomuarve total me numrin e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e larta.
[23] Rritje me 0,5% nga vlera bazë e vitit 2018 (64%).
[24] Rritje me 1,5% nga vlera bazë e vitit 2018 (64%).
[25] Gjithashtu, të dhënat administrative të MASR-së për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë, ndarë sipas etnikë (romë dhe egjiptianë) dhe aftësisë së kufizuar: Për vitin akademik 2018–2019, janë regjistruar në arsimin bazë publik 3 713 fëmijë romë, 8 150 fëmijë egjiptianë, 3 562 fëmijë me aftësi të kufizuara.
[26] 0.1 pikë përqindjeje rritje nga vlera bazë 96.5%.
[27] 0.2 pikë përqindjeje rritje nga vlera bazë 96.5%

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | fokus të veçantë për romët dhe egjiptianët, aftësinë e kufizuar dhe kategoritë e tjera të cenueshme)<br>*(Për asistencën teknike/grant/asistencën plotësuese)* | Norma (%) bruto e regjistrimit në arsimin dytësor (klasat 10–12) (sipas gjinisë).[28] | 93.9% - total<br>(90.1 % femra;<br>97.4% meshkuj)<br>*(viti akademik 2017–2018)* | 94.4%[29] | 94.9% [30] | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, INSTAT/Statistika arsimore |
| | | Performanca e nxënësve në lëndët e matematikës, gjuhës dhe shkencës (vlerësimi i PISA-s), klasa 9 | Shkencë 417; lexim: 405;<br>Matematikë: 437<br>*(PISA 2018 )* | E pazbatueshme | Shkencë: 422; Lexim: 410;<br>Matematikë: 437<br>*(PISA 2021)* | OECD/Vlerësimi PISA (2018 dhe 2021) |
| | 1.1 Rritet rrezja dhe synimi i mbështetjes me asistencë monetare për familjet, në përgjigje të krizës së COVID-19. | Numri i familjeve që përfitojnë asistencë monetare, duke përfshirë mbështetjen e synuar në kuadër të masave për përballimin e krizës së COVID-19. | 63,440 [31] | 68,500[32] | 63,500[33] | MSHMS/SHSSH/të dhëna administrative |
| | 1.2 Zgjerohet mbështetja për familjet më në nevojë përmes operacioneve ndihmëse, në përgjigje të krizës së COVID-19. | Numri i familjeve që përfitojnë paketat e ndihmës, në përgjigje të krizës së COVID-19. | 0 | 73,000[34] | E pazbatueshme | SHSSH në koordinim me Ministrinë e Mbrojtjes/Të dhëna administrative |
| | 1.3 Ngrihet sistemi i integruar funksional i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor dhe bëhet funksional**.** | Numri i bashkive që përdorin sistematikisht Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (REKSHKSH)[35] | 0<br>REKSHKSH ngritur në nivel kombëtar[36] | 10 | 30 | MSHMS/SHSSH/Të dhëna administrative të MSHMS-së; qeverisja vendore |
| | | Numri i bashkive që ofrojnë shërbime sociale me bazë komunitare për të paktën tri kategori (personat PAK, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, të moshuarit, gratë) | 10[37]<br>(mars 2019) | 15 | 25 | MSHMS/SHSSH/Të dhëna administrative të MSHMS-së; qeverisja vendore |

[28] Gjithashtu, të dhënat administrative të MSHMS-së për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin dytësor, sipas llojit të arsimit (i përgjithshëm, profesional), ndarë sipas etnisë (romët dhe egjiptianët) dhe aftësisë së kufizuar. Për vitin akademik 2018–2019, janë regjistruar në arsimin e përgjithshëm publik dytësor 669 fëmijë romë dhe egjiptianë, si edhe 384 fëmijë me aftësi të kufizuara.
[29] 0.5 pikë përqindjeje rritje nga vlera bazë 93.9%
[30] 1 pikë përqindjeje rritje nga vlera bazë 93.9%
[31] Shifra në fund të shkurtit 2020. Përfshin familjet në regjistrin qendror, familjet dhe kategoritë e veçanta që mbulohen me 6% të buxhetit alokuar bashkive.
[32] Objektivi për këtë tregues është për vitin 2021 dhe përfshin edhe përfituesit që përfitojnë nga paketa e asistencës sociale për COVID.
[33] Objektivi në këtë rast është për qershorin 2021, sepse treguesi mbulon periudhën prill 2020–qershor 2021. Objektivi supozohet të vazhdojë të jetë i njëjtë.
[34] E njëjta shifër nga fundi i marsit 2020 pritet të mbështetet mesatarisht gjatë 3 muajve. Objektivi është për 2020-ën, ngaqë është tregues afatshkurtër i përballimit të krizës së COVID 19.
[35] Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror duhet të regjistrojë rastet të paktën çdo muaj dhe duhet të regjistrojë informacionin e plotë për të gjitha rastet e referuara brenda vitit, përfshirë përfituesit e shërbimeve të kujdesit social (kujdesi i emergjencave; rezidencial, ditor dhe shtëpiak), si edhe rastet e referuara te njësitë e tjera shtetërore dhe joshtetërore.
[36] Për vitin 2019, REKSHKSH-ja është ngritur në të 61 bashkitë, por ende nuk është populluar.
[37] Mars 2019.

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.4 Ngrihet kuadri financiar dhe rregullator për standarde dhe praktika moderne të kujdesit social | Numri i bashkive që përdorin burimet dhe procedurat e Fondit Social | 0 | 14 | 45 | MASR/Të dhëna administrative |
| | 1.5 Përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në shkolla: *Objektivi B i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale (2020–2023); dhe Objektivi B4 i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar)* | Numri i vajzave dhe i djemve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin publik parauniversitar tradicional | 3 946 fëmijë me aftësi të kufizuara të regjistruar për vitin akademik 2018-2019[38] | 4,143[39] | 4,538[40] | MASR/Të dhëna administrative |
| | | Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë që shërbejnë në arsimin parauniversitar publik | 466 (308 psikologë; 158 punonjës socialë)-viti akademik 2018 – 2019) | 512[41] 10% rritje nga vlera bazë | 582[42] 20% rritje nga vlera bazë | MASR/Të dhëna administrative |
| | 2.1 Rritet gama e masave të synuara për të papunët, në përgjigje të krizës së COVID-19. | Numri i përfituesve në sipërmarrjet e vogla të mbyllura përkohësisht, për shkak të COVID-19, që marrin pagën minimale mujore. | 0 | 54,388[43] | E pazbatueshme | MFE/DP e Tatim-Taksave/Të dhëna administrative |
| | | Numri i përfituesve në ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha me aktivitetet ekonomik të tkurrur, të prekur nga kriza e COVID-19, që përfitojnë ndihmë financiare. | 0 | 110,000[44] | E pazbatueshme | MFE/DP e Tatim-Taksave/Të dhëna administrative |
| | | Numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar që përfitojnë nga Programet e Nxitjes së Punësimit (PNP-të) dhe formimit profesional. | 13,678 (2018) | 14.020[45] | 15.098[46] | MFE/Të dhëna administrative të/SKPA/INSTAT/AFP |
| | 2.2 Rritet pjesëmarrja në tregun e punës, përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi (ndarë sipas moshës, gjinisë) | Përqindja e punëkërkuesve të papunë të regjistruar | 43.2 % | 46.2% | 51.2% | MFE/Të dhëna administrative të/AKPA/INSTAT/AFP |

[38] Ndarë sipas gjinisë, vlerat bazë: 1347 vajza, 2599 djem, për vitin akademik 2018–2019.
[39] 5 % rritje për vitin 2020 nga vlera bazë.
[40] 15% rritje nga vlera bazë.
[41] 10% rritje nga vlera bazë totale 466.
[42] 25% rritje nga vlera bazë totale 466.
[43] Objektivi për vitin 2020 si masë afatshkurtër lidhur vetëm me përballimin e COVID-19.
[44] Objektivi për vitin 2020 si masë afatshkurtër lidhur vetëm me përballimin e COVID-19.
[45] Objektivi për këtë tregues është për vitin 2021. Rritje me 2,5% mbi vlerën bazë të vitit 2018.
46 10% rritje nga vlera bazë e vitit 2018.

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Numri i femrave dhe i meshkujve të grup-moshës 15–29 vjeç që nuk janë në punë, arsim apo formim profesional (PAFP) regjistruar në AKPA | 14.035 (2018) | 14.735 [47] | 16.140[48] | MFE/Të dhëna administrative të/AKPA/INSTAT/AFP |
| | 2.3 Përshtatet oferta e arsimit dhe formimit profesional (AFP,) sipas nevojave të të rinjve, femrave dhe burrave dhe popullatave në rrezik përjashtimi në bashki | Numri i kurrikulave me sigurim cilësie rishikuar dhe miratuar për kualifikimet AFP (fillestare dhe në vazhdim), bazuar në rezultatet e vlerësimit të boshllëqeve në aftësi | 87 kualifikime profesionale (AFP fillestare)<br>15 kurse formimi profesional të unifikuara (AFP në vazhdim) janë miratuar deri tani | Titujt AFP të rishikuar dhe kualifikimet e miratuara | 4 kurrikula të rishikuara dhe me sigurim cilësie (1 fillestar dhe 3 në vazhdim) miratuar dhe ofruar në arsimin AFP[49] | MFE dhe AKAFPK |
| | | Ofruesit AFP sigurojnë burime e personel në përputhje me kurrikulat e reja të miratuara | Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të ofruesve të AFP-së | Plani i optimizimit të ofruesve AFP, miratohet | 3 ofrues AFP sigurojnë burime dhe personel për të ofruar kurrikulat e përditësuara | MFE/AKAFPK/SKPA |
| Rezultate direkte | Përmirësohet hapësira financiare për zbatimin e objektivave të strategjive sektoriale SKMS dhe SKPA | % i transheve të disbursuara në kohë dhe sipas shumës së rënë dakord në KRS (Kontrata e reformës sektoriale) | 0 | % e disbursimeve të KRS kryhet sipas planit | 100 % e disbursimeve të KRS kryhen sipas planit | Raportet e disbursimit KRS |
| | | Shuma e hendekut financiar të SKMS-së dhe SKPA (bazuar në PBA 2020–'22) | 86 milionë euro (vlerësuar) | Trend rënës | Trend rënës | Raportet vjetore të zbatimit të strategjisë kombëtare për buxhetet vjetore. |
| | Dialog i vazhdueshëm për politikat me Qeverinë e Shqipërisë mbi zbatimin e strategjisë së reformës SKPA dhe SKMS | Numri i dialogëve për politikat në nivel të lartë teknik/strategjik për diskutimin dhe për rishikimin e zbatimit të SKPA-së dhe të SKMS-së, fokusuar në kushtet e transhit variabël dhe relevancën/besueshmërinë e vazhdueshme dhe progresit të kënaqshëm në zbatimin e strategjive | Takime vjetore të nënkomitetit me (1)<br><br>1 mbledhje GMIP të SKPA-së dhe të SKMS-së<br><br>Mbledhje *ad hoc* (4) (programim, monitorim) | 1<br><br>4 mbledhje vjetore GMIP<br><br>8–10 mbledhje *ad hoc* në vit (programim, monitorim) | 1<br><br>4 mbledhje vjetore GMIP<br><br>10–12 mbledhje *ad hoc* në vit (programim, monitorim) | Raporti vjetor për Shqipërinë<br><br>Raportet vjetore për zbatimin e SKPA-së dhe të SKMS-së dhe planeve të veprimit të tyre.<br><br>Raporti i disbursimit të KRS-së |

47 5% rritje mbi vlerën bazë 14035 (2018).
48 15 % rritje mbi vlerën bazë 14035 (2018).
49 Janë miratuar: 1 kurrikul për kualifikimin fillestar profesional dhe 3 për kurset profesionale afatshkurtra të unifikuara. Supozohet që rishikimi dhe certifikimi të shkojë përtej 4 kurrikulave të përcaktuara për vitin 2022.

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Përpjekje të vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve institucioneve të Qeverisë për zbatimin e strategjisë SKPA dhe SKMS | Shkalla e aftësisë së grupeve tematike ndërinstitucionale sektoriale për zbatimin, monitorimin dhe raportimin për strategjitë SKPA dhe SKMS dhe planet e veprimit | Struktura e GMIP-së dhe e grupeve tematike përkatëse, miratuar në tetor 2018 | 2–3 mbledhje në vit të GMIP-së për SKPA-në dhe për SKMS-në<br><br>Publikim i Raportit Vjetor për zbatimin e Strategjisë dhe PV 2019–2022 | 2–3 mbledhje në vit të GMIP-së për SKPA-në dhe për SKMS-në<br><br>Publikim i raportit vjetor për zbatimin e Strategjisë dhe PV 2019–2022 | Raportet e monitorimit, strategjia dhe planet e veprimit. Procesverbalet e mbledhjeve, të mbledhjes së GMIP-së/grupeve tematike |
| | Forcimi i koordinimit të donatorëve | Numri i mbledhjeve për të koordinuar | Koordinimi i donatorëve me bazë *ad hoc* dhe përmes kuadrit të koordinimit sektorial | Mbledhjet periodike të koordinimit të donatorëve (2–4 në vit) | Mbledhjet periodike të koordinimit të donatorëve (2–4 në vit) | Matrica e donatorëve, raportet për koordinimin e donatorëve |
| | Forcohen sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit për zbatimin e strategjisë | Shkalla në të cilën vendoset vlerësimi vjetor i progresit<br><br>Shkalla në të cilën rekomandimet e sistemit të monitorimit merren parasysh në procesin vendimmarrës | Raport monitorimi për zbatimin e progresit vjetor fokusuar në aktivitetet vjetore të të dyja reformave | Monitorimi vjetor kryhet mbi bazën e kuadrit të vlerësimit të performancës, përfshirë progresin ndaj treguesve të përcaktuar, analizës dhe rekomandimeve | Monitorimi vjetor kryhet mbi bazën e kuadrit të vlerësimit të performancës, përfshirë progresin ndaj treguesve të përcaktuar, analizës dhe rekomandimeve | Raporte monitorimi |
| | Forcohen kapacitetet për koordinimin dhe për monitorimin e zbatimit të strategjisë | Numri i takimeve koordinuese të lehtësuara dhe organizuara në mbështetje të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë<br><br>Numri i personelit teknik të trajnuar në sekretariatin teknik të MFE-së dhe të MSHMS-së, ndarë sipas gjinisë | 2<br><br>2 | 4 në vit<br><br>7 | 4 në vit<br><br>15 | Raport monitorimi i projektit AT; raportet e mbledhjeve; raportet e trajnimit; lista e pjesëmarrësve. |
| | 1. Monitorim i qëndrueshëm i zbatimit të MB | Numri i misioneve të pavarura të monitorimit të organizuara<br><br>Numri i raporteve të monitorimit të përgatitura<br><br>Cilësia dhe korrektësia (në kohë) e kërkesave për pagesë | 0<br><br>0<br><br>E pazbatueshme | 1 në vit<br><br>1 në vit<br>Kërkesat për pagesë janë të plota dhe dorëzohen sipas Kalendarit indikativ | 2 në vit<br><br>2 në vit<br>Kërkesat për pagesë janë të plota dhe dorëzohen sipas kalendarit indikativ | Raportet e Misionit të Pavarur të Monitorimit<br><br>Dosja e pagesave të DBE-së, që verifikon kushtet dhe progresin e zbatimit/MFE |

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Rritje ndërgjegjësimi për zbatimin e strategjitë SKPA dhe SKMS (fushatat specifike sipas grup-moshave dhe grupeve të synuara) | Numri i aktiviteteve të komunikimit në vit (matje me ndjeshmëri gjinore, moshe dhe pakice)<br><br>Numri i aktivitete të rritjes së ndërgjegjësimit (matje me ndjeshmëri gjinore, moshe dhe pakice) | Nuk ka plan komunikimi për strategjitë<br><br>0 | 4 aktivitete komunikimi në vit (2 për secilën strategji)<br><br>4 aktivitete ndërgjegjësimi në vit (2 për secilën strategji) | 8 aktivitete komunikimi në vit (4 për secilën strategji)<br><br>8 aktivitete ndërgjegjësimi në vit (4 për secilën strategji) | Raporti i projektit AT |
| | 3. Forcim i kapaciteteve teknike dhe organizative të MSHMS-së, MASR-së, MFE-së dhe bashkive që të koordinojnë dhe të zbatojnë masat e përfshirjes sociale dhe punësimit | Funksionet organizative, proceset e biznesit, monitorimi dhe vlerësimi; financimi dhe planifikimi i fuqisë punëtore për shërbimet e kujdesit social të realizuara | Aktet nënligjore për shërbimet e kujdesit social nuk janë miratuar | Vlerësimi funksional dhe shpenzimeve realizuar | Funksione dhe procese të reja pune të miratuara | Raporte vjetore të Shërbimit Social Shtetëror/MSHMS<br>Të dhëna administrative nga bashkitë e zgjedhura |
| | | Numri i ndërhyrjeve për përfshirjen sociale dhe i punësimit të hartuara dhe të zbatuara në nivel qendror dhe vendor[50] | 0 | 0 | 10[51] | Raporte vjetore të MSHMS-së dhe të MFE-së<br>Raporte progresi AT |
| | | Numri i dialogëve për politikat të lehtësuara me palët e interesuara kyçe, qeverisjen vendore, donatorët, aktorët joshtetërore, për të monitoruar zbatimin e reformës në nivel vendor dhe qendror | 0 | 4 | 10 | Raporti vjetor i projektit<br>Raporti vjetor i MSHMS-së |
| | | Numri i punonjësve socialë dhe i profesionistëve të tjerë në shërbime publike të trajnuar, bazuar në kurrikulat e arsimit profesional të vazhdueshëm | 0 (Vlerësimet e nevojave për trajnim të realizuara) | 0 (Kurrikulat e rishikuara dhe të miratuara nga ministria përgjegjëse) | 120 | Raporti vjetor i MSHMS-së<br>Raporte progresi AT |
| | | Numri i inspektimeve për sigurimin e cilësisë së shërbimeve sociale publike të kryera | 0 | 0<br>(Vlerësim i organizimit dhe i performancës së funksionit të inspektimit) | 20 [52] | Inspektorati i Punës dhe Shërbimeve Sociale<br>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. |

[50] Ndërhyrjet përfshijnë ose ndërhyrje specifike në kujdesin social, punësim dhe AFP, arsim, ndihmë juridike, ndërmarrje sociale ose ato që përdorin qasje të integruara për të trajtuar kompleksitetin e problematikave të përjashtimit social, ose zgjerim të modeleve të shërbimeve ekzistuese, si edhe pasurim të shërbimeve të reja bazuar në nevojat e identifikuara.
[51] Bazuar në bashkitë e përzgjedhura për skemën e granteve.
[52] Shërbimet e inspektimit të riorganizuara, metodologjia e re e hartuar, përshkrimet e punës të rishikuara të miratuara.

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zgjerim i rrezes së shërbimeve të integruara të kujdesit social, masave të punësimit dhe arsimit gjithëpërfshirës në nivel vendor në përputhje me planet sociale të bashkive. | Numri i shërbimeve për të cilat janë miratuar standardet dhe procedurat e unifikuara të menaxhimit të rasteve (kontrolli funksional dhe i cilësisë) | 17 shërbime | 25 shërbime | 30 shërbime | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/Raporti i projektit AT |
| | | Numri i ndërhyrjeve në kujdesin social, nxitje punësimi dhe arsimi gjithëpërfshirës, të ofruara në 10 bashkitë e synuara; | 0 | 0 | 15 | MSHMS/MFE/MASR Raportet e zbatimit të granteve |
| | | Riprojektimi i shërbimeve të rehabilitimit, punësimit dhe arsimit, që synojnë personat me aftësi të kufizuara | Specifikim i standardeve strukturore dhe funksionale, kanaleve të kujdesit dhe mjeteve të ofrimit, që mungojnë | Vlerësimi i nevojave dhe alternativave për ofrim shërbimesh dhe miks financimi, i realizuar | Protokollet dhe modulet financiare për të paktën 6 shërbime, të hartuara | MSHMS, SHSSH, bashkitë e synuara Raportet e zbatimit të granteve |
| | | Numri i marrëveshjeve në nivel shërbimi për shërbimet e referimit dhe të ndërmjetësimit për punësim, ndërmjet bashkive dhe SHKP-së, formalizuar në komunitetet urbane dhe rurale | 3 | 7 | 10 | SKPA dhe bashkitë e përzgjedhura/marrëveshje formale. |
| | | Numri i rekomandimeve/i masave të integruara në SKPA për të përmirësuar ofertat AFP, që synojnë popullatat rurale | 0<br>(Vlerësimi i boshllëqeve në aftësi për zonat rurale në 100 fshatra është në proces nga INSTAT) | 0<br>(Plani i veprimit në mbështetje të ofertave AFP në zonat rurale, miratuar | 5 | Raporti vjetor i MFE-së<br>Raporti i MFE-së për vlerësimin e boshllëqeve në aftësi, bazuar në të dhënat dytësore nga anketa e 100 fshatrave e INSTAT-it |
| | Forcim i kapaciteteve për arsim gjithëpërfshirës në mbarë vendin, në përputhje me standardet e BE-së | Numri i shkollave të inspektuara, sipas metodologjisë për sigurimin e cilësisë | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) e ngritur me VKM<br><br>Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAPU) ngritur me VKM | Përshkrime pune të reja për personelin e ASCAP-it dhe plani i trajnimit të hartuara dhe të zbatuara<br><br>Përshkrime pune të reja për personelin e DPAPU-së dhe plani i trajnimit të hartuara dhe të zbatuara | Inspektimet e kryera në 100 shkolla | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/ASCAP<br>Të dhëna administrative/raporte |
| | | Përqindja e mësuesve të trajnuar për nxënien me bazë kompetence në kurrikulën parauniversitare të re, notat 1-5 (granti i arsimit gjithëpërfshirës) | 0<br>(Vlerësimi i ndikimit të shpejtë për metodat e reja të mësimdhënies<br><br>Kurrikulat e zbatuara për notat 1– 5) | 0<br>(Kurrikulat për trajnimin e mësuesve, të rishikuara dhe të miratuara nga ASCAP) | 100% | Raportet e MASR-së/Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)<br>Të dhëna administrative |

| | Logjika e ndërhyrjes | Treguesit | Vlerat bazë | Objektivi 2022 | Objektivi përfundimtar 2024 | Burimet dhe mjetet e verifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Përqindja e mësuesve dhe e administratorëve arsimorë të trajnuar për standardet e BE-së për arsimin gjithëpërfshirës, siç janë miratuar (Granti i arsimit) | 0<br>Inventar i të gjitha dokumenteve për arsimin gjithëpërfshirës dhe proces konsultimi me aktorët kyçë në përcaktimin e qasjes së përgjithshme që të ndiqet për arsimin gjithëpërfshirës<br><br>Vlerësimi i nevojave për trajtim të mësuesve dhe drejtuesve të shkollave | 15%[53]<br><br>Kuadri për arsimin gjithëpërfshirës dhe aftësitë mësimdhënëse, i miratuar | 30%<br><br>Udhërrëfyesi për të zbatuar qasjen e arsimit gjithëpërfshirës në arsimin parauniversitar publik. | Raportet e MASR/Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). |
| | | Numri i shkollave të arreduara dhe të pajisura për të ofruar shërbime psikologjike dhe punës sociale/dhoma miqësore për fëmijët (granti i arsimit gjithëpërfshirës) | 0<br>Inventari i shërbimeve të shkollave që duhen arreduar apo përgatitur | 0 | 320 | Raportet e MASR-së/raportet e grantit |
| | Forcim i përfshirjes sociale të të rinjve dhe të të rriturve romë dhe egjiptianë, që përfitojnë nga një gamë e zgjeruar shërbimesh punësimi dhe arsimi gjithëpërfshirës në çdo bashki (grant për romët dhe egjiptianët) | Përqindja e popullatës rome dhe egjiptiane e synuar për punësim dhe shërbime të arsimit gjithëpërfshirës në bashkitë e përzgjedhura (grant) | 0<br>Inventari i boshllëqeve në ofrimin e<br><br>Të dhënat ROMALB | 0 | 50 % | Raportet e zbatimit të grantit<br>Raportet e bashkisë<br><br>Baza e të dhënave ROMALB në MSHMS |

[53] Bazuar në numrin e mësuesve gjatë vitit akademik 2020.

**Lista e shtojcave**

1. Treguesit e performancës për disbursimet
2. Modalitetet dhe kalendari i disbursimit
3. Aktivitete plotësuese
4. Kuadri i vlerësimit të performancës (nëse ka)

SHTOJCA 1
TREGUESIT E PERFORMANCËS QË PËRDOREN PËR DISBURSIMET

**Treguesi nr. 1:** **Numri i familjeve që përfitojnë asistencë monetare, përfshirë mbështetjen e synuar në kuadër të masave për përballimin e krizës së COVID-19 (ndarë në nivel individual sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe pakicës[54]).**
Programi:Strategjia Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2020–2023.
Objektivi:Ulja dhe zbutja e varfërisë. Rritja e transparencës dhe efektivitetit të skemës së asistencës monetare (*cash*).
Veprimi: MSHMS-ja do të vazhdojë dhënien e asistencës monetare standarde për të gjitha familjet e regjistruara në programin e ndihmës sociale, përtej masave të ndërmarra në kuadrin e krizës së COVID-19.
Departamenti përgjegjës:*Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale/Shërbimi Social Shtetëror*

**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Sasior
Njësia matëse: Numër
Shpeshtësia e matjes: Tremujor/vjetor
Rezultati i fundit i njohur: Fundi i shkurtit 2020 – 63 440 familje[55]. Ndarje në nivel individual: 118 858 femra; 125 661 meshkuj; 3 037 romë; 6 297 egjiptianë, 10 571 persona me aftësi të kufizuara.
(2019 nëse ka): Dhjetor 2019- 64 057 familje.

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**
Metoda e mbledhjes së të dhënave: Të dhëna administrative: SHSSH/MSHMS. Të dhënat mblidhen dhe hidhen në sistem nga administratorët socialë në nivel vendor, më pas konsolidohen nga Shërbimi Social Shtetëror. Raporti për këtë tregues duhet të përfshijë numrin e familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike *(cash)* mujore (ndarë në nivel individual sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe pakicës). Për më tepër, MSHMS-ja i publikon këto të dhëna zyrtare si pjesë e raportit vjetor zyrtar të MSHSP-së për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale.

Departamentet përgjegjëse: Shërbimi Social Shtetëror/Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkitë.
Metoda e llogaritjes:Numri i familjeve matet si: Numri i familjeve që përfitojnë asistencë sociale (*cash),* duke përfshirë ndihmën në *cash* lidhur me përballimin e COVID-19.

**Mjetet e interpretimit:**
Kufizimet e njohura dhe trendi: Paketa e krizës së COVID-19 përfshinte një masë për dyfishimin e ndihmës ekonomike *(cash)* për të gjitha familjet për periudhën prill - qershor 2020. Gjithashtu, në bazë të regjistrit të asistencës sociale, qeveria dha një pagesë *cash* për familjet në nevojë. Numri i familjeve pritet të rritet gjatë kësaj periudhe. Qeveria duhet të sigurojë të mos ketë hendek buxhetor në PBA 2020–2022 në mënyrë që të garantojë vazhdimësinë e dhënies së asistencës në *cash* të gjitha familjeve përtej periudhës së mbuluar nga masa për COVID-19. Masa për COVID-19 për asistencën në *cash* mbështetet nga VKM-së nr. 254/2020.

Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike që përfitojnë asistencë në *cash,* duke përfshirë asistencën e ofruar gjatë periudhës së krizës së COVID-19.
**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit: Të dhëna për vitin 2020: T2 2021
**Komente**
**Treguesi nr. 2PNP-të ekzistuese rikonfigurohen për t'iu përgjigjur nevojave të punëkërkuesve të papunë, përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.**
Programi:Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA)
Objektivi: Rritet pjesëmarrja në tregun e punës, përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi (ndarë sipas moshës, gjinisë, romë dhe egjiptiane, si edhe aftësisë së kufizuar).
Veprimi: Shtrirjen e politikave të tregut të punës aktiv edhe te kategoritë e cenueshme dhe të përjashtuara: gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, me vëmendje të veçantë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët, punëkërkuesit e papunë afatgjatë, punëtorët me aftësi të pakta; stazhe dhe mundësi punësimi për kategoritë e marzhinalizuara dhe të cenueshme: femrat dhe meshkujt, përfshirë romët dhe

[54] Ndarja bëhet vetëm për statistikat e MSHMS-së (mbështetja në nivel qendror), sepse të dhënat e hollësishme për mbështetjen në nivel vendor janë në nivel familjeje (afërsisht 5% e numrit total të familjeve).
[55] Shifra i referohet fundit të shkurtit 2020. Përfshin të gjitha familjet që përfitojnë asistencë në *cash n*ga niveli qendror. Përfshin familjet nga kategori të veçanta dhe familjet që përfitojnë nga 6% akorduar bashkive për këtë qëllim.

personat me aftësi të kufizuara; rishikimi, hartimi dhe zbatimi i masave për të nxitur punësimin e femrave dhe meshkujve dhe për të garantuar plotësimin e nevojave ndërsektoriale për cenueshmëri të shumëfishta. PNP-të do të ripërshtaten për të përfshirë përfituesit në rrezik të prekur nga kriza e COVID-19.

Departamenti përgjegjës: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)*

**Përshkrimi i treguesit**

Lloji i treguesit:SasiorN

Njësia matëse: Numri i punëkërkuesve të papunë që përfitojnë nga PNP-të

Shpeshtësia e matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur: (2018) i) 13 678 (4 808 punëkërkues në PNP-të dhe 8 870 punëkërkues në programet e formimit profesional nga totali 74 686 i punëkërkuesve të regjistruar (SKPA 2018) ose 18,31%.

Masat e reja në ligjin për nxitjen e punësimit të miratuara në vitin 2019.

(Tri vitet e fundit, nëse ka):i. 2017: 89,780/16.4%; 2016: 119,710/14.96%; 2015: 149,882/13.15%

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Të dhëna administrative: Të dhëna zyrtare të AKPA-së lidhur me mbulimin e PNP-ve dhe përcjellë zyrtarisht nga MFE-ja. Gjithashtu: raporti zyrtar i MFE-së për zbatimin e SKPA-së. Raporti për përballimin e COVID-19.

Departamentet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave: AKPA/MFE

Metoda e llogaritjes: i. Përqindja llogaritet duke përpjesëtuar numrin e punëkërkuesve të papunë që përfitojnë nga Programet e Nxitjes së Punësimit (PNP-të) në vitin e synuar me numrin total të punëkërkuesve të papunë që përfitojnë nga PNP-të në vitin bazë 2018, shumëzuar me 100.

**Mjetet e interpretimit**

Kufizimet e njohura dhe trendi: Ky tregues llogaritet bazuar në të dhënat e mbledhura nga AKPA. Të dhënat administrative duhet të jenë të sakta dhe të vlefshme, që të përdoren si bazë. Luhatjet në numrin total të punëkërkuesve të papunë të regjistruar mund të ndikojë në % e përfituesve të PNP-ve. Miratimi i ligjit të ri për nxitjen e punësimit dhe aktet nënligjore përkatëse janë parakusht thelbësor për arritjen e suksesshme të këtij treguesi.

Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat efektivitetin e SHKP-së në masat e tregut të punës aktiv për kategoritë më të cenueshme dhe rritjen e punësueshmërisë së tyre.

**Kalendari i dokumentimit**

Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2020: T2 2021

Të dhëna për vitin 2021: T2 2022

Të dhëna për vitin 2022: T2 2023

Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** Është thelbësore të garantohet cilësi e mirë dhe fizibilitet i të dhënave të mbledhura për Përfituesit e PNP-ve dhe të papunët e regjistruar pranë AKPA-së. PNP-të do të rishikohen në kuadrin e përballimit të COVID-19 dhe do të përfshijnë forma të tjera aktivizimi me fokus te punësueshmëria siç janë "aftësitë e buta (të komunikimit etj.)" dhe trajnimet nga Qendrat e Formimit Profesional.

**Treguesi nr. 3: Numri i bashkive që përdorin sistematikisht Regjistron Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (REKSHKSH)**

Programi:Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale

Objektivi:Sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor ngrihet dhe bëhet funksional.

Veprimi: Trajnimi i zyrtarëve vendore dhe Shërbimit Social Shtetëror mbi përdorimin dhe funksionalitetet e REKSHKSH-së; hedhja e informacionit historik dhe ditor mbi përfituesit e shërbimeve të kujdesit social dhe rastet e referuara; vlerësim periodik i ngarkesës së menaxhimit të rasteve.

Departamenti përgjegjës: *Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë*

**Përshkrimi i treguesit**

Lloji i treguesit:Sasior

Njësia matëse: Numër

Shpeshtësia e matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i njohur: 0 (2019)

(tri vitet e fundit, nëse ka):E pazbatueshme

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Mbledhja administrative e të dhënave (raporti vjetor i SHSSH-së); raporti i botuar nga REKSHKSH-ja dhe raporti vjetor i monitorimit të SKMS-së.

Departamentet përgjegjëse për Shërbimi Social Shtetëror/Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale mbledh të dhënat çdo vit për çdo bashki përmes regjistrit.
mbledhjen e të dhënave:

Metoda e llogaritjes: Numri i bashkive që përdorin Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror të paktën çdo muaj dhe regjistrojnë informacion të plotë për të gjitha rastet e referuara brenda vitit, duke përfshirë përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror (emergjencat; rezidencial, ditor dhe shtëpiak) si dhe rastet e referuara te njësitë e tjera shtetërore dhe joshtetërore. Numri total i përfituesve do të llogaritet bazuar në shifrat e fluksit (numrit total të rasteve të menaxhuara gjatë vitit) për bashkitë në vitin e parë të vlerësimit; dhe stokut (numrit total të raste/përfituesve të shërbimit në fund të periudhës) dhe fluksit (numrit të rasteve të reja, të rezervuara dhe ekzistuese) për bashkitë në çdo vlerësim vijues, sipas të dhënave të REKSHKSH për numrin total të përfituesve.

**Mjetet e interpretimit**

Kufizimet e njohura dhe trendi: Baza e të dhënave administrohet nga Shërbimi Social Shtetëror. Bashkitë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve (OSHC-të) do të hedhin të dhënat në distancë. Shërbimi Social Shtetëror ka përgjegjësinë të ndërlidhë REKSHKSH me regjistrat e tjerë ekzistues (kryesisht me Regjistrin e Asistencës Sociale) dhe të mbikëqyrë të dhënat e hedhura nga përdoruesit, përfshirë bashkitë, por jo të vlerësojë cilësinë. Numri total i rasteve të referuara gjatë vitit në çdo bashki mblidhet nga REKSHKSH-ja e administruar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Mjetet e interpretimit:Kjo mat stokun dhe fluksin e rasteve në sistemin e kujdesit social shtetëror dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të rasteve.

**Kalendari i dokumentimit**

Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** MSHMS-ja dhe SHSSH-ja do të duhet të nxjerrin udhëzime të qarta për të gjitha bashkitë dhe OSHC-të mbi përdorimin e regjistrit dhe të monitorojnë rregullisht procesin e hedhjes së të dhënave. Trajnimi i zyrtarëve vendorë mbi përdorimin e REKSHKSH duhet të zhvillohet brenda muajit dhjetor 2020 dhe gjatë vitit 2021.

**Treguesi nr. 4 Numri i bashkive që ofrojnë shërbime sociale me bazë në komunitet për të paktën tri kategori (personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, të moshuarit, femrat)[56]**

Programi:Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
Objektivi:Sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor ngrihet dhe bëhet funksional.

Veprimi: Ofrimi i asistencës teknike dhe financiare për bashkitë që të ngrenë dhe/ose të zgjerojnë shërbime të reja për kategoritë në nevojë, asistimi i tyre në ngritjen e njësive të vlerësimit të nevojave dhe Referimit (NJVNR) në nivel bashkie, orientimi dhe mbështetja rreth standardeve në dhënien e shërbimit dhe kontraktimin; monitorimi i dhënies së shërbimit.

Departamenti përgjegjës: *Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Social dhe bashkitë*

**Përshkrimi i treguesit**

Lloji i treguesit:Sasior *(output)*
Njësia matëse: Numër
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: (2018) - 10 (Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Sarandë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë, Lushnjë)
(Tri vitet e fundit, nëse ka):E pazbatueshme

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Mbledhja administrative e të dhënave.
Departamentet përgjegjëse për Shërbimi Social Shtetëror/Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale koordinon mbledhjen e të dhënave administrative nga secila bashki, bazuar në
mbledhjen e të dhënave:dispozitat e ligjit 121/2016; Raporti Vjetor i Shërbimit Social Shtetëror bazuar në raportimet e bashkive.

Metoda e llogaritjes: Numri i bashkive që ofrojnë të paktën një shërbim me bazë në komunitet në territorin e tyre për të paktën tri prej kategorive në vijim: të rriturit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, femrat, siç përcaktohet në VKM-në 518/2018, neni II/b.

**Mjetet e interpretimit**

Kufizimet e njohura dhe trendi: VKM-ja nr. 518, datë 4.9.2018, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" përcakton llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror me bazë komunitare. Ky tregues nuk përfshin shërbimet rezidenciale apo përfitimet në *cash*.

Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat shkallën e ofrimit të shërbimeve me bazë komunitare në nivelin vendor për këto kategori në nevojë, për të treguar mbulimin e nevojave në nivel vendor.

[56] Shërbimet sociale me bazë në komunitet janë përcaktuar duke iu referuar ligjit nr. 121/ 2016 për Kujdesin Shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024
**Komente**

**Treguesi nr. 5 Numri i bashkive që përdorin burimet dhe procedurat e fondit social**
Programi:Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
Objektivi:Ngrihet kuadri financiar dhe rregullator për standarde dhe praktika moderne të kujdesit social
Veprimi: Miratimi i rregullores për procedurat e alokimit të Fondit Social dhe metodologjisë përkatëse, përgatitja e dokumentacionit standard (thirrjes për propozime, metodologjisë së vlerësimit me pikë etj. sipas rastit); vlerësimi i nevojave në nivel vendor, krijimi i strukturave të brendshme për vlerësimin e kërkesave dhe alokimin e fondeve; monitorimi i zbatimit në nivel vendor; raportimi për performancën.
Departamenti përgjegjës: *Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale dhe bashkitë*

**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Sasior
Njësia matëse: Numër
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: (2019) 0
(Tri vitet e fundit, nëse ka):E pazbatueshme

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**
Metoda e mbledhjes së të dhënave: Mbledhja administrative e të dhënave: MSHMS dhe bashkitë.
Departamentet përgjegjëse për Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale do të ofrojë të dhëna për numrin e bashkive që përfitojnë dhe përdorin Fondin Social, për kriteret dhe mbledhjen e të dhënave:procedurat e përdorura për alokimin e Fondit Social

Metoda e llogaritjes: Numri i bashkive që ka marrë fonde nga buxheti i shtetit (MSHMS) përmes Fondit Social dhe ka krijuar rezerva financiare vendore në buxhet (fondet sociale vendore); VKM-ja e rishikuar për Fondin Social.

**Mjetet e interpretimit**
Kufizimet e njohura dhe trendi: Miratohet VKM-ja për kriteret e alokimit të Fondit Social. Alokimi i Fondi Social në ministritë e linjës përfshihet në programin buxhetor Kujdesi Social i MSHMS-së. Meqë është në fillim të zbatimit, do të nevojiten rishikime për përmirësime të mëtejshme.
Mjetet e interpretimit:Treguesi mat peshën në buxhetin kombëtar të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor dhe qendror.

**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021:T2 2022
Të dhëna për vitin 2022:T2 2023
Të dhëna për vitin 2023:T2 2024

**Komente**

**Treguesi nr. 6: Numri i vajzave dhe i djemve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin publik parauniversitar të zakonshëm**[57]

Programi:Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale

Objektivi:Përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në shkolla

Veprimi: Vlerësimi i efikasitetit dhe i efektivitetit të komisioneve aktuale dhe vlerësimi i rregullave dhe i procedurave për funksionimin e komisioneve multidisiplinore në vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara; marrëveshje me MSHMS për shkëmbimin e të dhënave nga vlerësimet e aftësisë së kufizuar bazuar në modelin biopsikosocial (pilotuar në 2 njësi në Bashkinë Tiranë në vitin 2019; në Bashkinë Tiranë në vitin 2020 dhe në qarqet e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit në vitin 2021); zhvillimi i mekanizmave për gjurmimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe garantimi i integrimit në arsimin parauniversitar të zakonshëm, kur është e përshtatshmes.

Departamenti përgjegjës: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar; MSHMS.

**Përshkrimi i treguesit**

Lloji i treguesit:Sasior

Njësia matëse: Rritja e përqindjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin parauniversitar të zakonshëm në raport me vlerën/vitin bazë

Shpeshtësia e matjes: Vjetore

Rezultati i fundit i ditur: (viti akademik 2018–2019) total - 3,946 fëmijë (1,371 vajza dhe 2,599 djem)

(Tri vitet e fundit, nëse ka):2017–2018: 3,665 fëmijë, (1,222 vajza dhe 2443 djem); 2016–2017: 3,151 fëmijë, (1,034 vajza dhe 2,117 djem); 2015–2016: 3,140 fëmijë (1,131 vajza dhe 2,009 djem)

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Mbledhja administrative e të dhënave: të dhënat e përgatitura zyrtarisht nga shkollat parauniversitare/Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe të përcjella zyrtarisht Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Gjithashtu, MSHMS-ja/komisionet e aftësisë së kufizuar për identifikimin dhe përcjelljen e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në moshë shkollore. Të dhënat do të ndahen sipas gjinisë,

Departamentet përgjegjëse Drejtoritë rajonale arsimore dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
për mbledhjen e të dhënave:

Metoda e llogaritjes: Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin publik parauniversitar të zakonshëm në (fillim të) vitit akademik në raport me fëmijët me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin publik parauniversitar të zakonshëm në vitin bazë 2018–2019 (klasat 1-12, me përjashtim të arsimit profesional dytësor).

**Mjetet e interpretimit**

Limitet e njohura dhe trendi: MSHMS-ja dhe MASR-ja duhet të ngrenë mekanizma për shkëmbim periodik informacioni për të garantuar që të vlerësohen nevojat arsimore të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara. MASR-ja në bashkëpunim me MSHMS-në do të duhet të bëjnë një vlerësim të rregullave aktuale për funksionimin e komisioneve arsimore multidisiplinare dhe t'i rishikojnë në përputhje me modelin e ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar.

Mjetet e interpretimit: Treguesi mat efektivitetin e komisionit multidisiplinar në vlerësimin e nevojave arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe në mundësimin e tyre që të regjistrohen në arsimin e zakonshëm. Arsimi parauniversitar përfshin klasat 1–12, me përjashtim të arsimit profesional dytësor. Nuk përfshin fëmijët me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin parauniversitar të posaçëm (652 fëmijëve, nga të cilat 199 vajza në vitin akademik 2018–2019, si edhe 476 fëmijë, nga të cilët 142 vajza në vitin akademik 2017–2018).

**Kalendari i dokumentimit**

Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022

Të dhëna për vitin 2022: T2 2023

Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente**Të dhënat do të mblidhen edhe të ndara sipas gjinisë (djem dhe vajza)

[57] Arsimi parauniversitar përfshin klasat nga 1 deri 12, me përjashtim të arsimit profesional dytësor.

**Treguesi nr. 7 Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë që shërbejnë në shkollat publike parauniversitare**

Programi:Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
Objektivi:Përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në shkolla
Veprimi: Rritja e numrit të psikologëve dhe të punonjësve socialë në arsimin publik parauniversitar që ofrojnë shërbime psikosociale; miratimi i protokolleve për shërbimin psikosocial në shkolla dhe për bashkëpunimin/referimin te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor sipas nevojës.
Departamenti përgjegjës: *Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*

**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Sasior *(output)*
Njësia matëse: Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë të rekrutuar në arsimin e zakonshëm publik parauniversitar.
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: 464 total/viti akademik 2018–2019 i) 308 psikologë, 158 punonjës socialë në shkollat publike parauniversitare.
(Tri vitet e fundit, nëse ka):347 total/viti akademik 2017–2018; 356 total/viti akademik 2016–2017; 307 total/viti akademik 2015–2016.

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**
Metoda e mbledhjes së të dhënave: Mbledhje administrative e të dhënave: Të dhëna të përgatitura zyrtarisht nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
Departamentet përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Metoda e llogaritjes: i. Numri total i psikologëve dhe i punonjësve socialë në shkollat publike parauniversitare në vitin e caktuar pjesëtuar me numrin total të psikologëve dhe punonjësve sociale në shkolla publike parauniversitare në vitin bazë (viti akademik 2018–2019).
**Mjetet e interpretimit**
Kufizimet e njohura dhe trendi: Rritja e numrit të psikologëve dhe të punonjësve sociale në shkollat publike parauniversitare do të duhet të shoqërohet me masa adekuate për sigurimin e ambienteve të punës. Psikologët dhe punonjësit socialë do të kenë nevojë edhe për trajnim si të bashkëpunojnë me njësitë e mbrojtjes së fëmijës në nivel bashkie, si edhe me institucionet dhe agjencitë e tjera që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë.

**Mjetet e interpretimit:** Ky tregues synon të garantojë mbështetjen e përshtatshme psikologjike dhe me shërbime sociale në shkolla si edhe që ekzistojnë mekanizmat për parandalimin dhe/ose zbulimin dhe referimin te shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve për fëmijët në situata të cenueshme; për punën me fëmijët me aftësi të kufizuara apo me probleme të sjelljes etj.
**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024
**Komente**

**Treguesi nr. 8 Përqindje të punëkërkuesve të papunë të regjistruar**
Programi:Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA)
Objektivi:Rritet pjesëmarrja në tregun e punës, përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi (ndarë sipas moshës, gjinisë).
Veprimi: Modeli i shërbimit zbatohet me përmirësime në profilizim klienti, shtrirje, kërkim pune dhe kontraktim; përmirësohen profilet për moshën, gjininë, aftësinë e kufizuar, romët dhe egjiptianët; Vlerësimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme të tregut të punës për popullatat në rrezik përjashtimi; regjistrimi; përmirësimi i profilizimit të klientit dhe këshillimit të punëkërkuesve; trajnimi i personelit të SHKP-së mbi nevojat e veçanta të gjinisë, të rinjve, pakicave dhe kategorive të tjera; rritja e vizibilitetit dhe shtrirjes së shërbimeve publike të punësimit.
Departamenti përgjegjës: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (SKPA)*
**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Sasior
Njësia matëse: Përqindje
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: (2018) - 43.2 % (74,686 stoku i punëkërkuesve të regjistruar (SKPA 2018)/172,622 të papunë (AFP 2018, grupmosha 15–64 vjeç)
(Tri vitet e fundit, nëse ka):2017: 47.8%; 2016: 62.2%; 2015: 64.9%

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Administrative dhe statistikore (anketim): Të dhënat e përgatitura zyrtarisht nga SHKP mbi stokun e punëkërkuesve të regjistruar dhe që i përcillen zyrtarisht MFE-së; të dhënat mbi papunësinë që përgatiten zyrtarisht nga INSTAT bazuar në Anketën e Forcave të Punës (AFP).

Departamentet përgjegjëse për AKPA/MFE për stokun vjetor të punëkërkuesve të regjistruar, që përgatitjen çdo vit dhe i përcillen zyrtarisht MFE-së; INSTAT për numrin total mbledhjen e të dhënave: të të papunëve, publikimi vjetor i të dhënave ekonomike të agreguara AFP deri T2 të vitit "n+1".

Metoda e llogaritjes: Përqindja e të papunëve të regjistruar në AKPA llogaritet duke pjesëtuar stokun vjetor të punëkërkuesve të regjistruar në AKPA me numrin total të të papunëve që rezulton nga anketa vjetore AFP.

**Mjetet e interpretimit**

Kufizimet e njohura dhe trendi: Metodologjia e AFP-së ka brendësuar kërkesat e EUROSTAT-it dhe nuk është e anshme. Për stokun e punëkërkuesve të regjistruar, ky tregues llogaritet edhe bazuar në të dhënat administrative të mbledhura nga ShKP-ja. Të dhënat administrative duhet të jenë të sakta dhe të vlefshme që të përdoren si bazë. Përqindja e punëkërkuesve të regjistruar nuk mund të jetë të papunë; kjo mund të cenojë saktësinë e matjeve.

Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat efektivitetin e SHKP-së për të arritur te grupet e synuara dhe për të plotësuar nevojat e grupeve më të cenueshme.

**Kalendari i dokumentimit**

Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** Stoku i punëkërkuesve të regjistruar në vitin 2018 ishte 74,686, nga të cilët 14,035 të moshës 15—29 vjeç, 60,651 të moshës 30–64. Përqindja e punëkërkuesve femra të regjistruar ishte 52% në vitin 2018; 53% në 2017 dhe 50% në 2016. AKPA-ja duhet të vërë në dispozicion të dhëna të ndara sipas moshës, gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe grupeve të pakicave (romët dhe egjiptianët).

**Treguesi nr. 9Numri i femrave dhe i meshkujve të grup-moshës 15–29 vjeç që nuk janë në punë, arsim apo formim profesional (PAFP) të regjistruar në AKPA.**

Programi:Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA)

Objektivi: Rritet pjesëmarrja në tregun e punës, përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi (ndarë sipas moshës, gjinisë, romëve dhe egjiptianëve, aftësisë së kufizuar).

Veprimi: Vlerësimi dhe hartimi i politikave adekuate të tregut të punës për të rinjtë që nuk janë në punë, arsim apo formim profesional; regjistrimi; përmirësimi i profilizimit të klientit dhe këshillimit të punëkërkuesve të rinj; trajnimi i personelit të AKPA-së mbi nevojat e veçanta të gjinisë, të rinjve, pakicave dhe kategorive të tjera; rritja e vizibilitetit dhe shtrirjes së shërbimeve publike të punësimit.

Departamenti përgjegjës: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)*

**Përshkrimi i Treguesit**

Lloji i treguesit:Sasior *(output)*
Njësia matëse: Rritja me përqindje
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: (2018)14,035 të rinj PFAP të regjistruar në AKPA
(Tri vitet e fundit, nëse ka):2017: 17,175 2016: 29,716 2015: 41,977

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**

Metoda e mbledhjes së të dhënave: Të dhëna administrative: AKPA/MFE për stokun vjetor të të rinjve PAFP si punëkërkues të papunë, të përgatitura me bazë vjetore dhe përcjellë zyrtarisht nga MFE-ja; edhe raporti vjetor zyrtar i MFE-së për zbatimin e SKPA-së.

Departamentet përgjegjëse përAKPA/MFE
mbledhjen e të dhënave:

Metoda e llogaritjes: Ky tregues matet si raport mes numrit të të rinjve PAFP si punëkërkues të papunë në vitin n me numrin e të rinjve PAFP të regjistruar si të papunë në vitin bazë, shumëzuar me 100.

**Mjetet e interpretimit**

Kufizimet e njohura dhe trendi:Ky tregues llogaritet bazuar në të dhënat e mbledhura nga SHKP-ja. Të dhënat administrative duhet të jenë të sakta dhe të vlefshme që të përdoren si bazë.

Mjetet e interpretimit: Ky tregues mat efektivitetin e ShKP-së për të arritur te të rinjtë PAFP dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës.
**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** Është thelbësore të garantohet cilësi e mirë dhe fizibilitet i të dhënave të mbledhura nga SHKP-ja për të rinjtë PAFP, duke përfshirë identifikimin e besueshëm për të rinjtë PAFP. Të dhënat do të duhet të ndahen sipas gjinisë, aftësisë së kufizuar, grupeve të pakicave (rome/egjiptiane) dhe rajoneve/bashkive.

**Treguesi nr. 10 Numri i kurrikulave me sigurim cilësie, rishikuar dhe miratuar për kualifikimet AFP (fillestare dhe në vazhdim), bazuar në rezultatet e vlerësimit të boshllëqeve në aftësi**

Programi:Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA)
Objektivi:Arsimi dhe formimi profesional (AFP) përshtaten sipas nevojave të të rinjve, femrave dhe meshkujve dhe popullatave në rrezik përjashtimi në bashki.
Veprimi: Vlerësimi dhe analiza e boshllëqeve dhe nevojave për aftësi në zonat rurale dhe urbane; rishikimi dhe lidhja e kurrikulave me Kuadrin Shqiptar të Kualifikimeve; zhvillimi i kurrikulave të kualifikimit përshtatur me nevojat e popullatave urbane dhe rurale, personave me aftësi të kufizuara.
Departamenti përgjegjës: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)*

**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Sasior
Njësia matëse: Numër
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i njohur: (2018) 87 kualifikime profesionale për AFP fillestare dhe 15 kurse trajnimi profesional të unifikuara për AFP në vazhdim
(Tri vitet e fundit, nëse ka):E pazbatueshme

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**
Metoda e mbledhjes së të dhënave: Komunikim zyrtar nga AKAFPK-ja dhe MFE-ja për numrin e kurrikulave të reja të hartuara, për vitin, si edhe numrin e kurseve që rezultojnë në dhënien e kualifikimit;
Departamentet përgjegjëse përAKAFPK
mbledhjen e të dhënave:
Metoda e llogaritjes: Numri i kualifikimeve të reja të hartuara, për vitin, si edhe numri i kurseve që rezultojnë në dhënien e kualifikimit.

**Mjetet e interpretimit**
Kufizimet e njohura dhe trendi:E pazbatueshme
Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat përshtatjen e ofertës AFP ndaj tregut të punës në zonat urbane dhe rurale.

**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 202: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** Gjatë vitit 2019, INSTAT-i do të realizojë një vlerësim të boshllëqeve në aftësi për zonat rurale në 100 fshatra (analizë dytësore e të dhënave ekzistuese për 100 fshatrat), si dhe duhet të përgatitet një plan veprimi për të mbështetur ofertën AFP në zonat rurale. AKAFPK-ja do të duhet të plotësohet me burime që të zbatojë planin dhe të përmbushë kërkesën në zonat urbane dhe rurale.

**Treguesi nr. 11Ofruesit AFP sigurojnë burime e personel në përputhje me kurrikulat e reja të miratuara**
Programi:Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA)
Objektivi:Arsimi dhe formimi profesional (AFP) përshtaten sipas nevojave të të rinjve, femrave dhe meshkujve dhe popullatave në rrezik përjashtimi në bashki.

Veprimi: Racionalizimi dhe optimizimi i rrjetit të ofruesve AFP sipas nevojave të tregut të punës dhe kërkesave rajonale; analiza dhe përmirësimi i kurrikulave, *workshope*-ve (takimeve të punës) dhe pajisjeve në dispozicion të ofruesve AFP, përfshirë ambientet/shërbimet për nevojat e vajzave/grave dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Departamenti përgjegjës: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (SKPA)*

**Përshkrimi i treguesit**
Lloji i treguesit:Cilësor/sasior
Njësia matëse: Numër
Shpeshtësia e matjes: Vjetore
Rezultati i fundit i ditur: (2018) nuk dihet
(Tri vitet e fundit, nëse ka):NA

**Zhvillimi dhe cilësia e treguesit**
Metoda e mbledhjes së të dhënave: Komunikim zyrtar nga AKAFPK-ja dhe MFE-ja; edhe raporti i progresit zyrtar i MFE-së për zbatimin e SKPA-së
Departamentet përgjegjëse për AKAFPK
mbledhjen e të dhënave:
Metoda e llogaritjes: Komunikim zyrtar nga AKAFPK-ja dhe MFE-ja; edhe raporti i progresit zyrtar i MFE-së për zbatimin e SKPA-së.

**Mjetet e interpretimit**
Limitet e njohura dhe trendi:Tre ofruesit AFP duhet të sigurojnë burimet e përshtatshme për të ofruar 4 kurrikulat e miratuara brenda vitit 2021.
Mjetet e interpretimit:Ky tregues mat përshtatjen e ofertës AFP me tregun e punës në zonat urbane dhe rurale.
**Kalendari i dokumentimit**
Data e realizimit:Të dhëna për vitin 2021: T2 2022
Të dhëna për vitin 2022: T2 2023
Të dhëna për vitin 2023: T2 2024

**Komente** Në vitin 2019 duhet të realizohet një vlerësim i konsoliduar i kapaciteteve ekzistuese të ofruesve FAP, duke pasur parasysh vlerësimin e boshllëqeve në aftësi me fokus të veçantë për zonat rurale.

# SHTOJCA 2
# MODALITETET DHE KALENDARI I DISBURSIMIT

Kjo shtojcë trajton katër fusha kryesore sipas kontekstit sektorial të vendit/ndërhyrjes: 1. përgjegjësitë; 2. kalendari indikativ i disbursimit; 3. kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh; 4. kushtet e veçanta për disbursimin e secilit transh.

**1. Përgjegjësitë**

*Bazuar në kushtet e disbursimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Financimit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do t'i dërgojë Komisionit Evropian një kërkesë zyrtare për disbursimin e çdo transhi sipas kalendarit në tabelën A më poshtë. Kërkesa duhet të përfshijë: i. analizën e plotë dhe argumentimin për pagimin e fondeve duke i bashkëngjitur dokumentet mbështetëse; ii. një formular me informacion financiar, të nënshkruar siç duhet, që lehtëson kryerjen e pagesave.*

**2. Kalendari indikativ i disbursimit**

Kalendari indikativ paraqitet më poshtë:

**Tabela A: Kalendari indikativ i disbursimit**

| **Viti fiskal i vendit** | **Viti 2020** | | | | **Viti 2021** | | | | **Viti 2022** | | | | **Viti 2023** | | | | **Viti 2024** | | | | **Total** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Lloji i transhit | T1 | T2 | T3 | T4 | T1 | T2 | T3 | T4 | T1 | T2 | T3 | T4 | T1 | T2 | T3 | T4 | T1 | T2 | T3 | T4 | |
| Transhi fiks | | | | 15.65 | | | | 1.5 | | | | 1.5 | | | | 1.5 | | | | 1.5 | 21.65 |
| Transhi variabël | | | | | | | | 5 | | | | 8 | | | | 8 | | | | 8 | 29 |
| **Total** | | | | **15.65** | | | | **6.5** | | | | **9.5** | | | | **9.5** | | | | **9.5** | **50.65** |

**3. Kushtet e përgjithshme për disbursimin e secilit transh**

*Kushtet e përgjithshme më poshtë për disbursimin e secilit transh janë të zbatueshme për të gjitha transhet; dhe të gjitha kërkesat për disbursim transhi duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm.*

**Tabela B: Kushtet e përgjithshme për disbursimin e transheve**

| **Fusha** | **Kushtet** | **Burimi i verifikimit** |
|---|---|---|
| Politika publike | Progresi i kënaqshëm në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2015–2022 dhe të *Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale* 2015–2023, si edhe besueshmëria dhe relevanca e vazhdueshme e tyre, ose e strategjive pasuese dhe e masave të emergjencës së COVID-19. | Raportet e progresit vjetor të SKPA (2020–2022), SKMS (2020–2023); dhe për zbatimin e planeve të veprimit të tyre (vjetore, çdo maj–qershor).<br>Raporti për zbatimin e masave lidhur me krizën e COVID-19 në fushën e mbrojtjes sociale dhe punësimit (rreth shtator–tetor 2020).<br>Raport nga mbështetja plotësuese në kuadrin e kësaj mase (vjetor, T2 N+1). |
| Stabiliteti makroekonomik | Zbatimi i një politike të besueshme të stabilitetit makroekonomik. | Raportet vjetore të Qeverisë (çdo muaj prill, N+1).<br>Raportet e FMN-së, Bankës Botërore, BE (vjetore dhe të posaçme)<br>Vlerësimi i DG ECFIN i programit të reformave ekonomike të Shqipërisë, PRE (vjetor).<br>Përfundimet e Nënkomitetit të MSA-së për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (vjetore). |
| Menaxhimi financiar publik | Progres i kënaqshëm në zbatimin e programit për përmirësimin e menaxhimit financiar publik. | Raportet e progresit për zbatimin e strategjisë për përmirësimin e MFP-së (Raporti vjetor i zbatimit të strategjisë MFP të paraqitur Komitetit Drejtues të MFP).<br>Raportet e FMN-së, Bankës Botërore, BE-së lidhur me MFP (vjetore dhe të posaçme).<br>Vlerësimi i *DG NEAR* me kontribute nga drejtoritë e përgjithshme përkatëse (*DG BUDGET, DG MARKT, DG TAXUD*) (vjetor dhe i posaçëm). |
| Transparenca buxhetore | Progresi i kënaqshëm lidhur me disponueshmërinë e informacionit buxhetor në kohë reale, tërësor dhe të qëndrueshëm. | Botimet zyrtare shtetërore dhe faqet e internetit përkatëse (proces i vazhdueshëm);<br>Raporti vjetor i MFE-së për progresin e zbatimit të Strategjisë MFP.<br>Vlerësimet e palëve të treta p.sh. Indeksi i Buxhetit të Hapur (vjetore). |

**4. Kushtet e veçanta për disbursimin e secilit transh**

*Kushtet e veçanta për disbursimin, të përcaktuara në Tabelat C dhe D, janë të zbatueshme për disbursimin e një transhi specifik. Kërkesat për disbursim transhi duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përshtatshëm për kushtet e veçanta.*

**Tabela C: Kushtet e veçanta për disbursimin e transheve**

| Transhi | Shuma | Data indikative e kërkesës për disbursim (muaj/vit) | Data indikative e disbursimit (muaj/vit) | Kushtet/kriteret/aktivitetet për disbursim | Burimi i verifikimit përfshirë kohën ose disponueshmërinë e të dhënave (nëse ka) |
|---|---|---|---|---|---|
| Transhi fiks i parë | 15.65 milionë € | T3 2020 | T4 2020 | Disbursimi bazuar në:<br>-Kriteret e përgjithshme. Përmbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagimit.<br>-Kriteret e veçanta: Raporti i Qeverisë Shqiptare për arritjen e parakushteve për disbursim deri në fund të shtatorit 2020.<br>-Zbatimin e masave COVID-19 lidhur me mbrojtjen sociale dhe punësimin. | Raportet vjetore për:<br>- Progresin në zbatimin e SKMS-së (2020–2023)<br>- Progresin në zbatimin e SKPA-së (2020–2022)<br>- Ruajtjen e stabilitetit makroekonomik ose një politike makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit<br>- Zbatimin e Strategjisë MFP<br>- Raportin për zbatimin e masave për krizën e COVID-19, përfshirë të dhënat e përshkruara në treguesit përkatës. |
| Transhi fiks i parë | 5 milionë € | T2 2021 | T3 2021 | Transhi variabël i përcaktuar në shtojcën 2 për modalitetet dhe kalendarin e disbursimit për treguesit nr. 1, 2. | Kushtet për Transhin variablël detajuar të shtojcën 2 dhe tabelën D. |
| Transhi fiks i dytë | 1.5 milionë € | T2 2021 | T3 2021 | Disbursimi bazuar në:<br>-Kriteret e përgjithshme. Përmbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagimit. | Raportet vjetore, për:<br>- Progresin në zbatimin e SKMS-së (2020–2023)<br>- Progresin në zbatimin e SKPA-së (2020–2022)<br>- Ruajtjen e stabilitetit makroekonomik ose një politike makroekonomike të orientuar drejt stabilitetit<br>- Zbatimin e Strategjisë MFP. |
| Transhi variabël i tretë | 8 milion € | T2 2022 | T3 2022 | Transhi variabël i përcaktuar në shtojcën 2 për modalitetet dhe kalendarin e disbursimit për treguesit nr. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 | Kushtet për transhin variabël detajuar në shtojcën 2 dhe tabelën D. |
| Transhi fiks i tretë | 1.5 milion € | T2 2022 | T3 2022 | Disbursimi bazuar në:<br>-Kriteret e përgjithshme. Përmbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagimit. | Raportet vjetore, për:<br>Zbatimi i SKMS-së 2020–2023.<br>- Progresi në zbatimin e SKPA-së 2020–2023.<br>- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik ose e politikës makroekonomike orientuar drejt stabilitetit<br>- Zbatimi i Strategjisë MFP. |
| Transhi variabël i tretë | 8 milionë € | T2 2023 | T3 2023 | Transhi variabël i përcaktuar në shtojcën 2 për modalitetet dhe kalendarin e disbursimit për treguesit nr. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 | Kushtet për transhin variabël të detajuara në shtojcën 2 dhe tabelën D. |
| Transhi fiks i katërt | 1.5 milionë € | T2 2023 | T3 2023 | Disbursimi bazuar në:<br>-Kriteret e përgjithshme. Përmbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagimit. | Raportet vjetore për:<br>- Progresi në zbatimin e SKMS-së 2020–2023.<br>- Progresi në zbatimin e SKPA-së 2020–2023.<br>- Ruajtja e stabilitetit makroekonomik ose e politikës makroekonomike orientuar drejt stabilitetit<br>- Zbatimi i Strategjisë MFP. |
| Transhi variabël i katërt | 8 milionë € | T2 2024 | T3 2024 | Transhi variabël i përcaktuar në shtojcën 2 për modalitetet dhe kalendarin e disbursimit për treguesit nr. 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 | Kushtet për transhin variabël detajuar në shtojcën 2 dhe tabelën D |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Transhi fiks i pestë | 1.5 milionë € | T2 2024 | T3 2024 | Disbursimi bazuar në:<br>-Kriteret e përgjithshme. Përmbushja e parakushteve të përgjithshme të pranueshmërisë para pagimit. | Raportet vjetore për:<br>- Progresin në zbatimin e SKMS-së 2020–2023.<br>- Progresin në zbatimin e SKPA-së 2020–2023.<br>- Ruajtjen e stabilitetit makroekonomik ose e politikës makroekonomike orientuar drejt stabilitetit<br>- Zbatimin e Strategjisë MFP. |

Kushtet e disbursimit për transhin variabël janë caktuar për vitin e parë dhe mund të ndryshohen.

**5. Llogaritja e transhit variabël**

Në shumicën e rasteve, vlera bazë duhet të përparojë me të dhënat e performancës së çdo viti pasardhës. Kjo do të thotë që rezultatet e arritura në vitin e parë të programit bëhen efektivisht vlerat bazë ndaj së cilës vlerësohet performance e vitit të dytë, përveçse kur parashikohet ndryshe.

Në rastin e mundësisë së pagimit të pjesshëm *pro rata (proporcional)* të specifikuar në tabelën D, përqindja e transhit variabël është e barabartë me përqindjen e progresit ndërmjet vitit bazë dhe objektivit për vitin e dhënë, në rastet kur progresi i pjesshëm do të jetë të paktën 40% ose më lart, përveçse kur parashikohet ndryshe.

Në raste përjashtimore ku ngjarje të jashtëzakonshme ose rrethana të paparashikuara pengojnë përmbushjen e objektivave të miratuar, mund të anashkalohet ose neutralizohet një kusht i treguesit. Në këtë rast, shuma përkatëse transferohet në transhin e radhës ose rialokohet në treguesit e tjerë të të njëjtit transh. Raste të tilla duhet t'i kërkohen drejtorit të DG NEAR nga koordinatori kombëtar i IPA-së dhe autorizohen nga i pari me shkëmbim të letrave ndërmjet dy palëve.

Në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara siç duhet, marrëveshjet e financimit mund të lejojnë rivlerësim të disa objektivave të papërmbushur në vitin pasardhës (kundrejt objektivit fillestar), nëse ka një trend pozitiv dhe Qeveria nuk e arrin objektivin për shkak të goditjeve/tronditjeve të jashtme. Rastet e tilla duhet të specifikohen në dokumentacionin e treguesit.

**Tabela D: Transhi variabël**

| **Kontrata e reformës sektoriale: BE-ja për përfshirjen sociale** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë<br>Arritja deri në T2 2021<br>Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë<br>Arritja deri: T2 2022<br>Vlerësimi deri: T3 2022** | **Kësti variabël i tretë<br>Arritja deri: T2 2023<br>Vlerësimi deri: T3 2023** | **Kësti variabël i katërt<br>Arritja deri: T2 2024<br>Arritja deri: T3 2024** | **Pesha** |
| | | | | |
| **1. Treguesi: Numri i familjeve që përfitojnë asistencë monetare, përfshirë mbështetjen e synuar në kuadër të masave për përballimin e krizës së COVID-19** | | | | |
| **Objektivi 1.1:** 68,500 familje të regjistruara në programin e ndihmës ekonomike marrin asistencë në *cash,* duke përfshirë ndihmën lidhur me krizën e COVID-19 | E pazbatueshme | E pazbatueshme | E pazbatueshme | <u>2,500,000 euro</u><br><br>Viti 1: 2,500,000 euro) |
| Vlera bazë: 63,440 në fund të shkurtit 2020; familjet përfituese të ndihmës ekonomike standarde në *cash.*<br>REKNE ngritur me VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, ligji nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë". | | | | |
| Burimi i verifikimit: Raporti tremujor dhe vjetor i SHSSH-së bazuar në të dhënat administrative të raportuara dhe të përcjellë zyrtarisht nga MSHMS-ja/Raporti vjetor për Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (hollësitë në shtojcën 1) | | | | |
| **Realizim i pjesshëm:**<br>E pazbatueshme | E pazbatueshme | E pazbatueshme | E pazbatueshme | |
| **2. Treguesi: PNP-të ekzistuese rikonfigurohen për t'iu përgjigjur nevojave të punëkërkuesve të papunë, përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi** | | | | |

| Kontrata e reformës sektoriale: BE-ja për përfshirjen sociale | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë**<br>**Arritja deri në T2 2021**<br>**Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë**<br>**Arritja deri: T2 2022**<br>**Vlerësimi deri: T3 2022** | **Kësti variabël i tretë**<br>**Arritja deri: T2 2023**<br>**Vlerësimi deri: T3 2023** | **Kësti variabël i katërt**<br>**Arritja deri: T2 2024**<br>**Arritja deri: T3 2024** | **Pesha** |
| **Objektivi 2.1:** Numri i të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga PNP-të (përfshirë formimin profesional) rritet me 2.5% mbi vlerën bazë të vitit 2018. | **Objektivi 2.2.** Numri i të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga PNP-të (përfshirë formimin profesional) rritet me 5% mbi vlerën bazë të 2018. | **Objektivi 2.3.** Përqindja e të papunëve të regjistruar që përfitojnë nga PNP-të (përfshirë formimin profesional) rritet me 7.5% mbi vlerën bazë të 2018. | **Objektivi 2.4.** Përqindja e të papunëve të regjistruar, që përfitojnë nga PNP-të (përfshirë formimin profesional) rritet me 10% mbi vlerën bazë të 2018. | 6,000,000 Euro<br><br>(Viti 1: 2,500,000 euro;<br>viti 2: 1,300,000 euro;<br>viti 3: 1,100,000 euro;<br>viti 4: 1,100,000 euro) |
| Vlera bazë: (2018) i) 13,678 (4808 punëkërkues në PNP-të dhe 8870 punëkërkues në programet e formimit profesional nga totali i 74,686 punëkërkuesve të regjistruar (AKPA 2018) ose 18,31% | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimin | | | | |
| **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme *proporcionalisht* (minimumi 40% arritje) | **Realizim i pjesshëm:**<br>E zbatueshme *proporcionalisht* (minimumi 40% arritje) | **Realizim i pjesshëm:**<br>E zbatueshme *proporcionalisht* (minimumi 40% arritje) | **Realizim i pjesshëm:**<br>E zbatueshme *proporcionalisht* (minimumi 40% arritje) | |

| | Kontrata e Reformës Sektoriale të BE-së për përfshirje sociale | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë**<br>**Arritja deri në T2 2021**<br>**Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë**<br>**Arritja deri në T2 2022**<br>**Vlerësimi deri në T3 2022** | **Kësti variabël i tretë**<br>**Arritja deri T2 2023**<br>**Vlerësimi deri T3 2023** | **Kësti variabël i katërt**<br>**Arritja deri T2 2024**<br>**Vlerësimi deri T3 2024** | **Pesha** |
| **Treguesi 3: Treguesi: Numri i bashkive që përdorin sistematikisht Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror.** | | | | |
| **Objektivi 3.1: E pazbatueshme** | **Objektivi 3.2:** Të paktën 10 bashki përdorin REKShKSh sistematikisht [58] | **Objektivi 3.3:** Të paktën 20 bashki përdorin REKShKSh sistematikisht | **Objektivi 3.4:** Të paktën 30 bashki përdorin REKShKSh sistematikisht | 2,250,000 euro<br><br>(Viti 2: 750,000 euro;<br>viti 3: 750,000 euro;<br>viti 4: 750,000 euro) |
| Baza: REKSHKSH-ja e krijuar në vitin 2018 sipas VKM-së nr. 136/2018, 0 bashki e përdorin në T4 2019. | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimin | | | | |
| **Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme** | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme *pro rata* (minimumi 40% arritje) në proporcion me bashkitë që përdorin REKSHKSH sistematikisht (minimumi 4 bashki). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme *pro rata* (minimumi 40% arritje) në proporcion me bashkitë që përdorin REKSHKSH sistematikisht (minimumi 14 bashki). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme *pro rata* (minimumi 40% arritje) në proporcion me bashkitë që përdorin REKSHKSH sistematikisht (minimumi 24 bashki). | |

[58] Përdoret, matet sistematikisht me numrin e të dhënave të hedhura. Kjo matje tregon kryesisht shifrat e stokut dhe fluksit. Numri i bashkive që përdorin Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, të paktën çdo muaj dhe që kanë regjistruar informacionin e plotë për të paktën 80% të rasteve të referuara brenda vitit, përfshirë përfituesit e shërbimeve të kujdesit social (emergjencat; rezidencial, ditor dhe shtëpiak) si edhe rastet e referuara te njësitë e tjera shtetërore. Numri total i përfituesve do të llogaritet bazuar në shifrat e stokut (numri total i përfituesve të shërbime në fund të periudhës) dhe shifrat e fluksit (numri total i rasteve të menaxhuara gjatë vitit).

| | Kontrata e Reformës Sektoriale të BE-së për përfshirje sociale | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë<br>Arritja deri në T2 2021<br>Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë<br>Arritja deri në T2 2022<br>Vlerësimi deri në T3 2022** | **Kësti variabël i tretë<br>Arritja deri T2 2023<br>Vlerësimi deri T3 2023** | **Kësti variabël i katërt<br>Arritja deri T2 2024<br>Vlerësimi deri T3 2024** | **Pesha** |
| | | | | |
| **Treguesi 4: Treguesi: Numri i bashkive që ofrojnë shërbime sociale me bazë në komunitet për të paktën tri kategori: të rriturit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë në rrezik, të moshuarit, femrat** [59] | | | | |
| **Objektivi 4.1: E pazbatueshme** | **Objektivi 4.2:** 15 bashki ofrojnë të paktën një shërbim me bazë në komunitet për të paktën tri prej kategorive në vijim: të rriturit me aftësi të kufizuar, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, femrat. | **Objektivi 4.3:** 20 bashki ofrojnë të paktën një shërbim me bazë në komunitet për të paktën tri prej kategorive në vijim: të rriturit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, femrat. | **Objektivi 4.4:** 25 bashki ofrojnë të paktën një shërbim me bazë në komunitet për të paktën tri prej kategorive në vijim: të rriturit me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë, të moshuarit, femrat.. | 2,250,000 euro<br><br>(Viti 2: 750,000 euro;<br>viti 3: 750,000 euro;<br>viti 4: 750,000 euro) |
| Viti bazë: 10 bashki | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| **Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme** | **Realizim i pjesshëm:** 10 bashki ofrojnë shërbime për të paktën tri kategori dhe 5 bashki të reja ofrojnë shërbime për të paktën 2 nga 4 grupet (2/3 e Transhit) | **Realizim i pjesshëm:** 15 bashki ofrojnë shërbime për të paktën tri kategori dhe 5 bashki të reja ofrojnë shërbime për të paktën 2 nga 4 grupet (2/3 e transhit). | **Realizim i pjesshëm:** 20 bashki ofrojnë shërbime për të paktën tri kategori dhe 5 bashki të reja ofrojnë shërbime për të paktën dy nga 4 grupet (2/3 e këstit) | |
| **Treguesi 5: Numri i bashkive që përdorin burimet dhe procedurat e fondit social** | | | | |
| **Objektivi: 5.1/E pazbatueshme** | **Objektivi 5.2:** Fondi Social bëhet funksional në 14 bashki. | **Objektivi: 5.3**. 30 bashki po përdorin burimet nga fondi social. | **Objektivi 5.4:** 45 bashki po përdorin burimet nga Fondi Social . | 4,000,000 euro<br><br>(Viti 2: 1,000,000 euro;<br>viti 3: 1,500,000 euro;<br>viti 4: 1,500,000 euro) |
| Vlera bazë: FS funksional në 0 bashki ( 2019) | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursimin | | | | |
| **Realizim i pjesshëm: NA** | **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:**<br>*Pro-rata* ndaj numrit të bashkive që përdorin burime nga fondi social (minimum 20 bashki). | **Realizim i pjesshëm:**<br>Proporcionalisht ndaj numrit të bashkive që përdorin burime nga fondi social (minimum 30 bashki). | |
| **Treguesi 6: Numri i vajzave dhe djemve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin e zakonshëm publik parauniversitar.** | | | | |
| **Objektivi 6.1:** E pazbatueshme | **Objektivi 6.2:** Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm publik parauniversitar deri në 5% mbi vitin bazë (105% e vitit bazë). | **Objektivi 6.3:** Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm publik parauniversitar deri në 10% mbi vitin bazë (110% e vitit bazë). | **Objektivi 6.4:** Rritje në numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin e zakonshëm publik parauniversitar deri në 20% mbi vitin bazë (120% e vitit bazë). | 2,000,000 euro<br><br>(Viti 2: 800,000 euro;<br>viti 3: 600,000 euro;<br>viti 4: 600,000 euro) |

[59] Shërbime sociale me bazë komunitare për kategoritë e përcaktuara në Ligjin për Kujdesin Shoqëror në Republikën e Shqipërisë nr. 121/2016.

| | Kontrata e Reformës Sektoriale të BE-së për përfshirje sociale | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë<br>Arritja deri në T2 2021<br>Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë<br>Arritja deri në T2 2022<br>Vlerësimi deri në T3 2022** | **Kësti variabël i tretë<br>Arritja deri T2 2023<br>Vlerësimi deri T3 2023** | **Kësti variabël i katërt<br>Arritja deri T2 2024<br>Vlerësimi deri T3 2024** | **Pesha** |
| Viti bazë: 3946 (viti akademik 2018–2019) | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | |
| **Treguesi 7: Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë që shërbejnë në shkollat publike parauniversitare** | | | | |
| **Objektivi 7.1:** E pazbatueshme | **Objektivi 7.2:** Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë që shërbejnë në shkollat e zakonshme parauniversitare publike deri në 10% (110% e vitit bazë). | **Objektivi 7.3:** Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë që shërbejnë në shkollat e zakonshme parauniversitare publike deri në 20% (120% e vitit bazë). | **Objektivi 7.4:** Numri i psikologëve dhe i punonjësve socialë që shërbejnë në shkollat e zakonshme parauniversitare publike deri në 25% (125% e vitit bazë); | 3,000,000 euro<br><br>(Viti 2: 1,000,000 euro;<br>viti 3: 1,000,000 euro;<br>viti 4: 1,000,000 euro) |
| Viti bazë: i) 466 total: 308 psikologë, 158 punonjës socialë në shkollat publike parauniversitare (viti akademik 2018 -2019) | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | |
| **Treguesi 8: Përqindja e punëkërkuesve të papunë të regjistruar.** | | | | |
| **Objektivi 8.1:** E pazbatueshme | **Objektivi 8.2:** Përqindja e punëkërkuesve të papunë të regjistruar rritet deri 3 pikë përqindje krahasuar me vitin bazë. | **Objektivi 8.3:** Përqindja e punëkërkuesve të papunë të regjistruar rritet deri 5 pikë përqindje krahasuar me vitin bazë. | **Objektivi 8.4:** Përqindja e punëkërkuesve të papunë të regjistruar rritet deri 8 pikë përqindje krahasuar me vitin bazë. | 1,500,000 euro<br><br>(Viti 2: 500,000 euro<br>viti 3: 500,000 euro<br>viti 4: 500,000 euro) |
| Viti bazë: 43.2 pikë përqindje (2018) | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme proporcionalisht (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme pro rata (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme pro rata (min. 40% arritje). | |
| **Treguesi 9: Numri i femrave dhe meshkujve të moshës 15 - 29 vjeç që nuk janë në punë, arsim apo formim profesional (PAFP) të regjistruar në AKPA.** | | | | |
| **Objektivi 9.1:** E pazbatueshme | **Objektivi 9.2:** Numri i të rinjve punëkërkues PAFP të regjistruar u rrit deri në 5 pikë përqindje mbi vitin bazë 2018 (105%). | **Objektivi 9.3**: Numri i të rinjve punëkërkues PAFP të regjistruar u rrit deri në 10 pikë përqindje mbi vitin bazë 2018 (110%). | **Objektivi 9.4:** Numri i të rinjve punëkërkues PAFP të regjistruar u rrit deri në 15 pikë përqindje mbi vitin bazë 2018 (115%). | 2,000,000 euro<br><br>(Viti 2: 600,000 euro;<br>viti 3: 600,000 euro; |
| Viti bazë: (2018) 14,035 i të rinjve PAFP të regjistruar në AKPA. | | | | |

| | Kontrata e Reformës Sektoriale të BE-së për përfshirje sociale | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kësti variabël i parë<br>Arritja deri në T2 2021<br>Vlerësimi deri në T3 2021** | **Kësti variabël i dytë<br>Arritja deri në T2 2022<br>Vlerësimi deri në T3 2022** | **Kësti variabël i tretë<br>Arritja deri T2 2023<br>Vlerësimi deri T3 2023** | **Kësti variabël i katërt<br>Arritja deri T2 2024<br>Vlerësimi deri T3 2024** | **Pesha** |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | viti 4: 800,000 euro) |
| **Realizim i pjesshëm:** 11.1/E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme pro rata (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme pro rata (min. 40% arritje). | **Realizim i pjesshëm:** E zbatueshme pro rata (min. 40% arritje). | |
| **Treguesi 10: Numri i kurrikulave me sigurim cilësie të rishikuara dhe miratuara për kualifikimet (fillestare dhe të vazhdueshme) e AFP bazuar në rezultatin e vlerësimit të boshllëqeve në aftësi.** | | | | |
| **Objektivi 10.1:** E pazbatueshme | **Objektivi 10.2:** Titujt dhe kualifikimet e rishikuara të AFP-së u aprovuan në përputhje me KKK.-në. | **Objektivi 10.3:** Një kurrikul fillestare AFP dhe tri kurrikulave afatshkurtra të unifikuara hartohen dhe janë me sigurim cilësie. | **Objektivi 10.4:** Katër kurrikula gjithsej (1 kurrikul me sigurim cilësie për kualifikimin fillestar profesional dhe 3 kurrikula për kurset afatshkurtra FP të unifikuara) miratohen dhe ofrohen në AFP. | 1,500,000 euro (viti 2: 500,000 euro;<br>viti 3: 500,000 euro;<br>viti 4: 500,000 euro) |
| Viti bazë: 87 kualifikime profesionale për AFP fillestare dhe 15 kurse të unifikuara të formimit profesional për AFP të vazhdueshëm. | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| **Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme** | **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:** Të paktën dy kurrikula hartohen dhe kanë sigurim cilësie. | **Realizim i pjesshëm:** Të pakën dy kurrikula me sigurim cilësie miratohen dhe ofrohen në AFP. | |
| **Treguesi 11: Ofruesit AFP sigurojnë burime e personel në përputhje me kurrikulat e reja të miratuara.** | | | | |
| **Objektivi 11.1:** NA | **Objektivi 11.2:** Miratohet plani i optimizimit të ofruesve AFP. | **Objektivi 11.3:** Nënshkruhet kontraktimi i 3 ofruesve AFP për azhurnimin e kurrikulave. | **Objektivi 11.4:** ofrues AFP sigurojnë burime dhe personel për të ofruar kurrikulat e përditësuara. | 2,000,000 euro (Viti 2: 800,000 euro;<br>viti 3: 700,000 euro;<br>viti 4: 500,000 euro) |
| Viti bazë: Vlerësim i konsoliduar për kapacitetet ekzistuese të ofruesve AFP më 2019-ën. | | | | |
| Burimi i verifikimit: Shtojca 2: Treguesit e performancës që përdoren për disbursim | | | | |
| **Realizim i pjesshëm: E pazbatueshme** | **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | **Realizim i pjesshëm:** E pazbatueshme | |

SHTOJCA 3
AKTIVITETET PLOTËSUESE: NDARJA INDIKATIVE E BUXHETIT DHE PLANIFIKIMI PËR PROCEDURAT E KONTRAKTIMIT

| | **BUXHETI (€)** | | **AFATI[60]** | |
|---|---|---|---|---|
| **MODALITETET E ZBATIMIT** | **Total** | **Kontributi i BE-së** | **Shpallja e procedurës** | **Nënshkrimi i kontratës** |
| PROKURIMI – **MENAXHIM DIREKT** | | | | |
| Kontrata shërbimi | 8,700,000 | 8,700,000 | T1 2020 | T42020 |
| GRANTE- **MENAXHIM DIREKT** | | | | |
| 15 deri 20 kontrata granti, indikative | 10,333,333 | 9,300,000 | T2 2020 - T3 2022 | T1 2021- T1 2023 |
| **MENAXHIM INDIREKT NGA SHQIPËRIA** | | | | |
| 1 kontratë granti, indikative | 2,222,222 | 2,000,000 | T1 2021 | T4 2021 |
| **TOTAL** | **21,255,555** | **20,000,000** | | |

[60] Afati: Tremujor (T1, T2, T3, T4) viti.

SHTOJCA I
PROGRAMI I VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2019

## 1. IDENTIFIKIMI

| | |
|---|---|
| **Përfituesi** | Shqipëria |
| **Akti bazë**<br><br><br>**Referenca e angazhimit CRIS/ ABAC**<br>**Kostoja totale**<br>**Kontributi i BE-së**<br>**Linja buxhetore**<br><br>**Kostoja totale e programit**<br>**Kontributi i BE-së për këtë program** | Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, e cila themelon Instrumentin e Paraanëtarësimit IPA II<br><br>2019/041-203<br><br>71 905 555 euro<br>70 650 000 euro<br>22.02 01 02<br><br><br>71 905 555 euro<br>Euro 70 650 000 |
| **Metoda e zbatimit** | Me menaxhim të drejtpërdrejtë nga Komisioni Evropian<br><br>Me menaxhim të tërthortë me Shqipërinë |
| **Data përfundimtare për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit me Përfituesin IPA II** | Jo më vonë se data 31 dhjetor 2020 |
| **Data përfundimtare për lidhjen e kontratave, duke përfshirë konkluzionet e kontributeve/ marrëveshjeve të deleguara** | 3 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit |
| **Data indikative për zbatimin operacional** | 6 vjet nga data e lidhjes së Marrëveshjes së Financimit |
| **Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit**<br>(data në të cilën ky program duhet të tërhiqet dhe të mbyllet) | 12 vjet nga lidhja e Marrëveshjes së Financimit. |

### 1.1 PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

### 1.2 SEKTORËT E PËRZGJEDHUR NË KËTË PROGRAM VEPRIMI

Arsyeja për zgjedhjen e sektorëve specifikë, që janë pjesë e këtij programi:

Programi IPA për vitin 2019 përmban një veprim në sektorin e edukimit, punësimit dhe politikat sociale.

Përmirësimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare është një prioritet në Dokumentin Strategjik Kombëtar. Me këtë qëllim, Programi Vjetor i vitit 2019, do të mbështesë përfshirjen sociale. Veprimi "BE për përfshirjen sociale", ka si qëllim të kontribuojë në forcimin e përfshirjes sociale duke rritur mbulimin, përfshirjen dhe efektivitetin e shërbimeve të kujdesit social, dispozitat e edukimit gjithëpërfshirës dhe mundësitë e punësimit. Veprimi mbështet popullsinë në risk varfërie dhe të përjashtuarit social, duke përfshirë meshkujt, burra dhe gra me risk, njerëz me paaftësi fizike dhe minoritetet. **Veprimi mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale,** duke përmirësuar aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit social përmes financimeve të reja dhe ngritjes së mekanizmave rregullatore të cilësisë së shërbimeve, si dhe përmirësimi i niveleve të mirëqenies së fëmijëve në sistemin parauniversitar, në përputhje me standardet e edukimit gjithëpërfshirës evropian dhe përmirësimin e ndërhyrjeve për rritjen e nivelit të inspektimeve, ndërhyrjet në sistemin pedagogjik, punën sociale dhe ndërhyrjet psikologjike. Gjithashtu, **mbështet Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive,** duke promovuar punësimin dhe mundësitë e krijimit të vendeve të punës përmes modeleve të reja të dhënies së shërbimeve, prezantimin e programeve të reja për punësimin e të rinjve të papunë, arsimimin ose trajnimin, shpërndarjen e programeve të mirëqenies në punë

dhe forcimin e programeve të trajnimit profesional nëpër bashkitë e Shqipërisë.

BE-ja ka dhënë një kontribut të madh në sektorin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale, kryesisht fokusuar në fushën e punësimit përmes mbështetjes për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, me objektivin për të kontribuar në një treg pune sa më efektiv dhe gjithëpërfshirës, si dhe: i. të rrisë pjesëmarrjen në tregun e punës e të mundësojë vende punësimi për të gjithë; ii. të rrisë cilësinë dhe të zgjerojë përhapjen e arsimit dhe arsimit profesional; iii. të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e institucioneve të tregut të punës dhe shërbimeve.

Vlerësimi i asistencës së IPA 2007–2013 nxori në pah nevojën për tregues më të mirë dhe linjëzimet me prioritetet kombëtare. Ky veprim është në linjë me dokumentet strategjike, si p.sh.: Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale.

***Lista e veprimeve të parashikuara nën sektorët/prioritetet e selektuara:***

| Sektori/prioriteti/veprimi | Menaxhim i drejtpërdrejtë | Menaxhim i tërthortë | |
|---|---|---|---|
| | | Me një subjekt të besueshëm | Me Përfituesit e IPA II |
| ***Edukimi, punësimi dhe politikat sociale*** | | | |
| Veprimi 1 – BE për përfshirjen sociale | 68, 650, 000 euro | 0 euro | 2, 000,000 euro |
| **TOTALI** | **68, 650, 000 euro** | **0 euro** | **2, 000,000 euro** |

## 1.3 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I VEPRIMEVE

Asistenca e parashikuar për Programin Vjetor të Veprimit për Shqipërinë për vitin 2019 konsiderohet se ndjek kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në përputhje me nenin 215 TFEU.[61]

| **SEKTORI** | **EDUKIMI, PUNËSIMI DHE POLITIKAT SOCIALE** | | **70 650 000 euro** |
|---|---|---|---|
| **Veprimi 1** | **BE për përfshirjen sociale** | **Menaxhimi direkt - mbështetje buxhetore** | **50 650 000 euro** |
| | | **Menaxhimi direkt - asistencë plotësuese** | **18 000 000 euro** |
| | | **Menaxhim i tërthortë nga Shqipëria** | **2 000 000 euro** |

[61] www.sanctionsmap.eu. Ju lutemi vini re se harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve vjen nga aktet ligjore të botuara në Gazetën Zyrtare (OJ). Në rast të mospërputhjes midis akteve ligjore të botuara dhe përditësimeve në faqen e internetit është versioni i gazetës zyrtare që mbizotëron.

**1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritura dhe treguesit kryesorë të performancës**

- Përshkrimi i veprimit dhe objektivat

Objektivi **i përgjithshëm** është të zgjerojë mbulimin, gjithëpërfshirjen, efektivitetin dhe reagimin ndaj emergjencave të shërbimeve të kujdesit social, arsimin parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

Objektivat **specifikë** janë si më poshtë:

- përmirësimi i aksesit dhe i cilësisë së shërbimeve të integruara të kujdesit social në nivelin lokal;
- të promovojë përfshirjen sociale në punësim dhe punësim për të rinjtë, burrat dhe gratë;
- rritja e të mësuarit cilësor gjithëpërfshirës dhe promovimi i arritjeve arsimore në arsimin parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë - me një fokus të veçantë te romët dhe egjiptianët, paaftësitë dhe prejardhje të tjera të pafavorshme.

**Rezultatet e pritura de treguesit kryesorë të performancës**

Rezultatet e pritura të veprimit janë:

- sistemi funksional i integruar i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar është i vendosur dhe funksional;
- krijimi i kornizës financiare dhe rregullatore për praktikën dhe standardet moderne të kujdesit social;
- përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve në shkolla;
- rritja e mirëqenies dhe përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta;
- rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës, përfshirë të rinjtë, gratë, burrat dhe popullata të tjera në rrezik përjashtimi;
- edukimi dhe aftësimi profesional (VET), ofruar dhe përshtatur për nevojat e të rinjve, grave dhe burrave dhe popullatave në rrezik përjashtimi në njësitë vendore;
- rritja e ndihmës dhe mbështetjes së synuar në para *cash* për familjet në përgjigje të krizës së COVID-19;
- mbështetje e zgjeruar për familjet më të rrezikuara përmes operacionit lehtësues që i përgjigjet krizës COVID-19;
- shtimi i masave të synuara për informimin e të papunëve në përgjigje të krizës së COVID-19;
- treguesit kryesorë të performancës (për objektivin specifik):
- përqindja e popullsisë që merr paketën bazë të shërbimeve (të ndara sipas gjinisë, paaftësisë, romëve dhe egjiptianëve)
- numri i[62] institucioneve publike dhe jopublike të licencuara të kujdesit social;
- numri i qeverive lokale në kontraktimin dhe prokurimin e shërbimeve të kujdesit social;
- shkalla e papunësisë së të rinjve, për personat 15–29 vjeç, të ndarë sipas gjinisë.
- përqindja e punësimit të të diplomuarve të vet (e ndarë sipas gjinisë (NESS)
- shkalla neto e regjistrimit në arsimin bazë (klasa 1–9) e ndarë sipas gjinisë[63]
- shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm (klasa 10–12) (e ndarë sipas gjinisë)[64]
- performanca e studentëve në lëndët e matematikës, shkrim-leximit dhe shkencës (rezultati i vlerësimit të programit për vlerësimin ndërkombëtar të studentit (pisa)) nota 9.

**2. Supozimet dhe kushtet**

Supozimet për veprimin përfshijnë i. autoritetet shqiptare (Qeveria e Shqipërisë, Parlamenti) do të sigurojnë angazhimin e tyre të plotë për të punuar drejt arritjeve të objektivave të programit, si dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e tyre; ii. Ministria e Financave dhe Ekonomisë si institucioni kryesor për koordinimin e palëve të interesit në sektor do të operojë një strukturë koordinuese për monitorimin e rregullt të strategjive kryesore dhe zbatimin e Planeve të Veprimit, si dhe çdo përditësim të kërkuar; iii. alokimi i duhur i fondeve do të sigurohet në buxhetin kombëtar vjetor dhe programin buxhetor afatmesëm për zbatimin e NESS, NSSP dhe masat e arsimit gjithëpërfshirës, dhe në veçanti për funksionimin e Fondit të ri Social për shërbimet e kujdesit social.

Kushtet e veprimit përfshijnë:

---

62 Numri i shërbimeve të kujdesit social të tipologjive të ndryshme (komunitet, residenciale, kujdes ditor etj.).

63 Për më tepër: Të dhënat administrative të MASR-it për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin bazë të ndarë sipas përkatësisë etnike (romë dhe egjiptian) dhe paaftësisë.

64 Për më tepër: Të dhënat administrative të MASR-it për numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm sipas llojit të arsimit (të përgjithshëm, profesional) dhe të ndarë sipas përkatësisë etnike (romë dhe egjiptian) dhe paaftësisë.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NAES), duke përfshirë një plan operativ 3-vjeçar është miratuar nga paraqitja e kërkesës për disbursim për këstin e parë fiks (në mënyrë indikative Q2 2020).

- Vendimi i Këshillit të Ministrave për ristrukturimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional, Trajnimit dhe Kualifikimit (NAVETQ) me planin shoqërues 3-vjeçar është miratuar nga paraqitja e kërkesës së disbursimit për këstin e parë fiks (në mënyrë indikative Q2 2020).

- Përditësimi dhe zgjatja e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive deri në vitin 2022 dhe Planit shoqërues të Veprimit është miratuar deri në fund të vitit 2019.

- Përditësimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020–2023 dhe Planit shoqërues të Veprimit është miratuar deri në fund të vitit 2019.

- Të dhënat e sondazhit të Statistikave të Bashkimit Evropian mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (EU-SILC) publikohen jo më vonë se nga paraqitja e kërkesës për disbursim për këstin e parë fiks (në mënyrë indikative Q2 2020)

- Qeveria lëshon udhëzime rregullatore transparente për termat dhe kushtet në të cilat organizatat jofitimprurëse mund të marrin pjesë në prokurimin publik për tenderët e lëshuar nga organet publike për sigurimin e shërbimeve të kujdesit social dhe shërbimeve të tjera thelbësore publike duke dorëzuar kërkesën e disbursimit për këstin e parë fiks (në mënyrë indikative Q2 2020).

- Qeveria vërteton se në projektbuxhetin afatmesëm 2020–2022 siguron mbulim të mjaftueshëm për të financuar Fondin Social dhe rishikimin e metodologjisë së shpërndarjes dhe financimit të Fondit Social për të siguruar transparencë dhe barazi horizontale nëpër njësi vendore përmes paraqitjes së kërkesës për disbursim për këstin e parë fiks (në mënyrë indikative Q2 2020).

- Qeveria jep një propozim dhe angazhim të politikës së financimit për të zvogëluar hendekun e vlerësuar të financimit, përfshirë buxhetimin për koston e planit të veprimit për strategjitë përkatëse që do të paraqiten me secilën kërkesë të disbursimit.

- Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara më sipër mund të çojë në rikuperimin e fondeve në bazë të këtij programi dhe/ose në alokimin e fondeve të ardhshme.

**3. Mënyrat e zbatimit**

***3. a) Menaxhimi direkt përmes mbështetjes buxhetore***

a) Pranueshmëria për mbështetje buxhetore

*Politika publike*

Prioritetet për këtë veprim përcaktohen në përputhje me politikat e Qeverisë së Shqipërisë siç përcaktohet në shtyllën 3 (Investimi në njerëz dhe kohezioni social) të **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim** (NSDI) 2015–2020. Prioritetet për ndihmë janë, gjithashtu, të lidhura drejtpërdrejt me politikat specifike të përfshirjes sociale të përcaktuara në strategjitë sektoriale dhe përparësitë e fundit të vendosura, në lidhje me përgjigjen e krizës COVID-19. Drejtimet kryesore të politikave, siç përcaktohen nga strategjitë kryesore janë:

1. Për të përmirësuar aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të integruara sociale dhe të komunitetit dhe të kujdesit shëndetësor në nivelin lokal - objektivi A - Ulja dhe zbutja e varfërisë; objektivi B - Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara dhe objektivi C: Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (NSSP) 2020–2023 dhe paketa e masave të përgjigjes për COVID-19.

2. Për të promovuar përfshirjen sociale në punësim dhe punësueshmëri për të gjitha gratë dhe burrat në Shqipëri - objektivi C në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2020–2022 dhe paketën e masave të përgjigjes për COVID-19;

3. Për të rritur të mësuarit cilësor gjithëpërfshirës dhe për të promovuar arritjet arsimore në arsimin parauniversitar për të gjithë djemtë dhe vajzat me fokus të veçantë te romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera me prejardhje të pafavorizuara - objektivi B: Strategjia për Mbrojtjen Sociale (2020–2023) dhe objektivi B: Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (PUE) 2014–2020.

NESS, NSSP dhe PUE janë në përputhje me strategjitë Evropa 2020 dhe Evropa Juglindore 2020, si dhe Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale. Ato janë, gjithashtu, në përputhje me Strategjinë Nacionale Ndërsektoriale për

Decentralizimin dhe Qeverisjen Lokale 2015–2020, e cila, ndër të tjera, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në qasjen në shërbime dhe ofrimin e integruar të shërbimeve në nivelin lokal. Kjo thekson lidhjet midis mbrojtjes sociale, uljes së varfërisë, punësimit dhe aftësive, dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor. Është thelbësore që veprimi të lidhet me Strategjinë e Administratës Publike dhe parimet e saj pasi ai do të kontribuojë drejtpërdrejt në një administratë profesionale me aftësi të përmirësuara në analizimin dhe adresimin e politikave të përfshirjes, ai do të sigurojë trajnime të synuara mirë dhe zhvillimin e kapaciteteve për të forcuar kapacitetet në administratën publike në nivelin lokal dhe qendror dhe vendosjen e shërbimeve sociale të orientuara nga qytetarët përmes një qasjeje të integruar.

Paketa e masave të miratuara nga Qeveria e Shqipërisë në kuadrin e reagimit ndaj krizës COVID-19 është e lidhur me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale dhe Punësimin dhe strategjinë e VET, pasi ato synojnë të kontribuojnë kryesisht në adresimin e mbulimit të grupeve më të prekshme përmes asistencës *cash* dhe adresimit të punësimit krijuar si rezultat i një krize të tillë.

Më poshtë është një përshkrim i tri strategjive specifike sektoriale, për të cilat do të kontribuojë veprimi:

**Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2015–2020**[65]synon reformimin e politikave të mbrojtjes sociale përmes transformimit të skemës së asistencës sociale (NE) në një skemë aktive që mundëson riintegrimin social; rishikimi i sistemit të vlerësimit të paaftësisë; ndërhyrja dhe sigurimi i riintegrimit të fëmijëve në familje dhe komunitet, duke vendosur kujdes të veçantë për jetimët socialë dhe biologjikë, dhe duke siguruar shpërndarjen e shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. Një nga përparësitë është sigurimi i fondeve të nevojshme për grupet në fjalë përmes fondit social. NSSP-ja, gjithashtu shtjellon nevojën për të vendosur lidhje dhe integrim më të mirë midis politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes. Veprimi do të kontribuojë në të tre objektivat dhe do të **ketë një fokus të veçantë në objektivat A dhe C** që lidhen **me decentralizimin lokal dhe zhvillimin e shërbimeve të integruara të kujdesit social dhe të komunitetit dhe shtrirjen dhe transparencën e skemës së asistencës *cash*.** Tre objektivat kryesorë strategjikë të NSSP janë:

**Ulja dhe zbutja e varfërisë**, duke u përqendruar në modernizimin e sistemit të ndihmës ekonomike (NE) duke përfshirë në të administrimin e regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të llogaritjes; kapacitete të zgjeruara të menaxhimit në nivel kombëtar dhe lokal; synueshmëria më e mirë, si dhe shndërrimi i tij në një program të riintegrimit social përmes masave të aktivizimit të tregut të punës. Veprimet më specifike të përfshira në objektivin specifik të programit të veprimit janë: A1- Rritja e efektivitetit dhe transparencës së skemës së ndihmës *cash*.

**Përmirësimi i cilësisë së jetës për personat me aftësi të kufizuara**, duke u përqendruar në reformimin dhe synueshmërinë më të mirë të skemës së përfitimit të parave *cash* për njerëzit me aftësi të kufizuara bazuar në sistemin e vlerësimit biopsikosocial; transparencë e shtuar, duke përfshirë krijimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; forcuar sistemet e monitorimit dhe inspektimit si dhe krijimin e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social për të plotësuar përfitimet e parave *cash*.

**Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social** bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve të ndjeshme në programet e Mbrojtjes Sociale. Veprime më specifike të përfshira si pjesë e strategjisë dhe të lidhura me këtë objektiv specifik janë: C1 - Vendosja e një **sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit social** në njësitë e qeverisjes vendore në zonat e zgjedhura, deri në vitin 2017 dhe në nivelin kombëtar deri në vitin 2020; C2 - Rishikimi i **autoriteteve të planifikimit dhe shpërndarjes** në shërbimin e kujdesit social në nivele të ndryshme të qeverive lokale **dhe modelet e reja** që do të zbatohen C3 - Vendosja e një **sistemi të integruar informacioni** në nivel rajonal dhe qendror, me qëllim identifikimin dhe referimin e nevojave për shërbime të kujdesit social deri në vitin 2018; C4 - Vendosja dhe forcimi **i monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve** në nivelet lokale, rajonale dhe qendrore deri në vitin 2020; C4 - **Trajnimi i forcës punëtore dhe ofruesve të shërbimeve sociale**

[65] NSSP-ja është rishikuar dhe zgjeruar për të mbuluar 2020–2022 dhe ruan objektivat kryesorë të përcaktuar në këtë veprim të BE. Strategjia e rishikuar aktualisht është në pritje të miratimit me një vendim të Këshillit të Ministrave.

përmes futjes së një sistemi kualifikimi, **ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për parandalimin e problemeve sociale** dhe adresimi i tyre në shërbimet sociale, përmes fushatave të komunikimit.

Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Lokale për vitet 2015–2020 përshkruan një program ambicioz për zhvillimin e ofrimit të shërbimeve nga bashkitë. Sidoqoftë, është e qartë se kapaciteti i mjaftueshëm ose njohuritë teknike nuk ekzistojnë mbi një bazë uniforme në nivelin e njësive lokale për bashkërendimin efektiv të masave të përfshirjes sociale ose ofrimin e shërbimeve të kujdesit social. Për shembull, vetëm një pakicë e bashkive kanë hartuar plane me kosto të shërbimit social, siç parashikohet në strategjinë e decentralizimit dhe 27 bashki aktualisht nuk ofrojnë shërbime të kujdesit social gjë që përkeqëson pabarazinë dhe përjashtimin social. Për më tepër, zgjerimi i ofrimit të shërbimeve të kujdesit social kërkon aftësinë e qeverisë qendrore dhe lokale për t'u angazhuar në **kontraktimin dhe dhënien e shërbimeve bazuar në krijimin e partneriteteve midis bashkive, të Organizatave Joqeveritare (OJQ-ve) dhe sektorit privat**. Qëllimi është veçanërisht i rëndësishëm në lidhje me shërbimet që janë krijuar për të trajtuar nevoja komplekse dhe për të përmirësuar mundësitë ekonomike dhe sociale për përfshirjen sociale të komuniteteve të pafavorizuara. Çështja është veçanërisht aktuale në Shqipëri, ku përvoja e qeverive lokale, në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale është shumë e kufizuar, dhe ku kontributi nga shoqëria civile do të ishte veçanërisht i dëshirueshëm. Gjatë avancimit, qëllimi i dhënies së shërbimeve nga jashtë i duhet qeverisë për të siguruar që ekzistojnë rregulla të përshtatshme të prokurimit publik që mundësojnë pjesëmarrjen e OJQ-ve në tenderët publik për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.

Shqipëria ka bërë një progres të rëndësishëm në fushat e politikës së punësimit dhe arsimit dhe aftësimit profesional (AFP): **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2014–2020** (NESS)[66], aktualisht në vitin e katërt të zbatimit, ka gjeneruar një ndikim të rëndësishëm pozitiv si në aspektin e e rezultateve të punësimit dhe drejt modernizimit të sistemit të arsimit dhe aftësimit profesional në qark. NESS-ja nënvizon angazhimin e tij për rritjen e punësimit në një periudhë të ngadalësimit ekonomik. Strategjia synon të integrojë politikat ekonomike, arsimore, profesionale dhe të sipërmarrjes së bashku përmes një plani veprimi dhe duke unifikuar punësimin dhe arsimin profesional dhe trajnimin në një përpjekje për t'iu afruar kërkesave të tregut të punës. Strategjia përmban katër shtylla kryesore ose objektiva strategjikë: A. nxit mundësitë e denja për punë përmes politikave efektive të tregut të punës; B. të ofrojë arsim dhe aftësim profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit; C. **të promovojë përfshirjen sociale dhe kohezionin territorial**; D. të forcojë qeverisjen e tregut të punës dhe sistemet e kualifikimit.

Ai vendos njohuritë dhe aftësitë në zemër të modelit ekonomik dhe pret që të shkaktojë një ndikim pozitiv në rritjen afatgjatë, duke promovuar mundësi të denjë punësimi përmes politikave më efektive të tregut të punës dhe duke siguruar VET cilësore për të rinjtë, gratë dhe burrat dhe në të njëjtën kohë uljen e mundësive për punësim informal dhe nivelit të punësimit informal në sektorët jobujqësor. Strategjia përbëhet nga 52 veprime dhe raporte monitorimi dhe sipas Raportit të Progresit të NESS 2017 me 49 veprime që janë filluar tashmë me nivelin mesatar të zbatimit për veprimet e iniciuara prej 74%. Sidoqoftë, sfidat vazhdojnë: Raporti i Rishikimit Afatmesëm NESS 2018 (MTR) tregon se duhet bërë më shumë për të siguruar programe promovuese të punësimit me cilësi dhe me qasje të barabartë dhe futjen e masave për të mbështetur të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET), të zgjerojë mbulimin e masave të mirëqenies për në punë që synojnë të zvogëlojnë numrin e njerëzve që marrin transferta parash *cash*, dhe të zgjerojnë aksesin dhe rëndësinë e arsimit dhe aftësimit profesional për të rinjtë, gratë dhe burrat në të gjithë vendin.

NESS 2020 fokusohet në dy aspekte kryesore të përfshirjes sociale: 1. zhvillimi i shërbimeve të punësimit për grupet e pafavorizuara; dhe 2. përmirësimi i mundësive për formimin e aftësive përmes një aksesi më të mirë të VET. Në MTR 2018, programet e punësimit u vlerësuan të kishin arritur një ndikim të përgjithshëm pozitiv, por

[66] NESS-ja është rishikuar dhe zgjeruar për të mbuluar 2020–2022 dhe ruan objektivat kryesorë të përcaktuar në këtë veprim të BE-së. Strategjia e rishikuar aktualisht po pret miratimin nëpërmjet një vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM).

ndikimi në punësimin e grupeve të ndjeshme dhe të pafavorizuara u zbulua të ishte modest.

Siç është parashikuar në NESS, Shërbimi Kombëtar i Punësimit aktualisht po riorganizohet në një rrjet modern të shërbimeve kombëtare të punësimit në të gjithë vendin. Aktivitetet e trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve kanë filluar të rrisin nivelin e kompetencës së stafit të SHKP-së që nga viti 2017, dhe këto përpjekje kanë sjellë një përmirësim të dukshëm, por duhet të sigurohet mbështetje e mëtejshme për programet e ndërtimit të kapaciteteve. Numri i kufizuar i stafit dhe sfidat në lidhje me kalimin nga modeli i vjetër i ofrimit të shërbimeve në një model modern vazhdojnë të paraqesin probleme në zhvillimin e shërbimeve të punësimit, veçanërisht në lidhje me ofrimin e shërbimeve për grupe të pafavorizuara dhe të ndjeshme me nevoja të veçanta. Në vitet 2017–'18, Shërbimet Kombëtare të Punësimit, në bashkëpunim me programet e mbështetura nga donatorët, janë përpjekur të përmirësojnë synueshmërinë e shërbimeve ndaj grupeve në disavantazh dhe ofrimin e shërbimeve të larmishme, gjë që ka çuar në disa rezultate pozitive. Asnjë progres i rëndësishëm nuk është bërë deri më tani në lidhje me shtrirjen e mbulimit të shërbimeve të punësimit dhe ofrimit të VET-së të dukshme për aftësitë e kërkuara në ekonominë rurale. MTR-ja e NESS-së që mbulon katër vitet e para të zbatimit ka informuar procesin e rishikimit/rregullimit të NESS dhe planin e tij të veprimit i cili është në përputhje me këtë veprim të BE-së.

Objektivi B i Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar (2014–2020) është i **rëndësishëm** dhe i lidhur shumë ngushtë me objektivin C të NSSP-së, i cili synon disa mangësi dhe sfida të lidhura me sigurimin e mjediseve miqësore për fëmijët në shkolla; nevoja për mësim cilësor gjithëpërfshirës për fëmijët e pafavorizuar; zgjerimi i sigurimit të cilësisë në përputhje **me standardet e BE-së që nxisin bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë midis arsimit, shërbimeve të kujdesit social dhe përfshirjes sociale**[67]; dhe zbatimin e trajnimit profesional bashkëkohor dhe zhvillimit të mësuesve dhe administratorëve në arsimin gjithëpërfshirës.

Mangësitë aktuale janë të lidhura me mungesën e theksimit të dhënë për arsimin cilësor dhe gjithëpërfshirës për fëmijët në nevojë, për të mbështetur mësimin e kompetencës, dhe për sigurimin e cilësisë dhe standardizimin, transparencën dhe llogaridhënien. Mungesa e institucioneve të papërqendruara që mund të mbështesin shkollat dhe të ofrojnë shërbime mbështetëse të bazuara në komunitet është, gjithashtu, një lëshim i rëndësishëm. Ambicia është të ofrojmë një sistem arsimor që ka në themel nevojat dhe interesat e studentëve; që krijon mundësi dhe kushte të përshtatshme për studentët për të ndërtuar dhe për të zhvilluar njohuritë, aftësitë dhe vlerat e tyre; që i lejon studentët të zhvillohen në mënyrë të pavarur dhe të kontribuojnë në mirëqenien e tyre dhe të shoqërisë, në një mënyrë konstruktive dhe të përballen me sfidat e jetës. Objektivat strategjikë në arsimin gjithëpërfshirës parauniversitar përfshijnë përmirësimin e aksesit dhe rritjen e regjistrimit; ruajtja e raportit midis numrit të studentëve që mbarojnë arsimin bazë dhe atyre që mbarojnë arsimin e lartë. Ulja e niveleve të braktisjes në arsimin bazë dhe zbatimi i politikave për tërheqjen e fëmijëve nga grupet e ndjeshme përmes sigurimit të "Edukimit cilësor për të gjithë".

Disa përparime kryesore që priten për vitin 2019 përfshijnë rishikimet afatmesme të strategjive sektoriale dhe përpunimin e planeve të rishikuara të veprimit për arritjen e objektivave, si dhe krijimin dhe aktivizimin e fondit social si një instrument për të mbështetur krijimin e shërbimeve të kujdesit social. Zbatimi është i lidhur ngushtë me kapacitetet e aktorëve kryesorë të sektorit si në nivelin kombëtar dhe atë lokal. Edhe pse objektivat strategjikë janë të lidhura me buxhetimin afatmesëm, bazuar në financimin nga qeveria dhe partnerët e financimit, zbatimi i suksesshëm do të varet kryesisht nga aftësia e qeverisë për të nxitur koordinimin ndërsektorial dhe ofrimin e integruar të shërbimeve. Institucionet kryesore në sektor për sa i përket zbatimit të strategjive sektoriale janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), dhe në përputhje të plotë me

[67] Shikoni Agjencinë Evropiane për nevoja të veçanta dhe arsimin përfshirës: https://www.europeanagency.org/resources/publications/evidence-literature-review

**ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor**[68]. Programet e sipërpërmendura buxhetore përbëjnë sektorin e punësimit dhe të aftësive nën strukturat e koordinimit të politikave të Qeverisë së Shqipërisë, të udhëhequr nga grupi përkatës i menaxhimit të politikave të integruara (IPMG). Strategjitë për sektorin e përfshirjes sociale janë me kosto të llogaritura dhe janë të lidhura me procesin e buxhetimit dhe Planifikimin Buxhetor Afatmesëm (PBA) për ndarjen e tre viteve të ardhshme (2019–2021). Programet institucionale dhe buxhetore të konsideruara të rëndësishme për këtë veprim bazohen në alokimin dhe përbërjen e shpenzimeve që lidhen me mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë, dhe arsimin gjithëpërfshirës për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Arsimit.

Gjatë periudhës afatmesme, shpenzimet vjetore për mbrojtjen sociale, arsimin parauniversitar gjithëpërfshirës (me përjashtim të arsimit parashkollor), dhe punësimin dhe aftësitë kapin vlerën e vetëm nën 19 për qind të buxhetit të shtetit, pak më shumë se 3% të PBB-së së Prodhimit të Brendshëm Bruto, dhe rreth 11% të Shpenzimeve të Konsoliduara të Qeverisë së Përgjithshme. Shpenzimet për politikat sociale në Shqipëri janë nën shpërndarjen mesatare të shpenzimeve në BE (28)[69] në terma relativë dhe absolutë dhe kanë tipare dalluese që e veçojnë atë nga vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor[70]. Total i shpenzimeve afatmesme tavan (2018–2021) në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë, dhe parauniversitare arrijnë në 1.193 miliardë euro.

Në përputhje me objektivat kryesorë **të ligjit për financat e qeverisjes vendore** (neni 2), politika e financimit të qeverisjes lokale (LG) duhet të sigurojë përshtatshmërinë e burimeve financiare për njësitë e qeverisjes vendore (bashkitë dhe rajonet) për financimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre, të garantojnë autonominë e tyre fiskale, në lidhje me mbledhjen e taksave dhe tarifave lokale dhe të mbështeten në një mekanizëm efektiv për barazimin. Financat e LG-së referuar në të njëjtin ligj (neni 10) kanë të bëjnë me taksat dhe tarifat lokale dhe të ardhurat e tjera lokale, fondet e transferuara nga buxheti i shtetit, fondet nga taksat dhe tarifat e ndara kombëtare, huat lokale, donacionet; çdo burim tjetër lokal i përcaktuar me ligj.

Viti fiskal 2019 ka parë një konsolidim të mëtejshëm të burimeve të financimit dhe zbatimin e instrumenteve të reja të parashikuara nga ligji, pas decentralizimit fiskal dhe rritjes së autonomisë financiare. Transparenca dhe përmirësimi i mëtejshëm i mekanizmave efektivë të financimit janë faktorë të rëndësishëm të suksesit për zhvillimet në punësim/aftësi dhe sektorin social. Politikat e financimit të Qeverisë së Shqipërisë dhe autoriteteve buxhetore për të garantuar autonominë fiskale të NJQV-ve kanë synuar të: i. sigurojnë një fluks të qëndrueshëm të të ardhurave të ndërlidhura me zhvillimin e pasurisë së përgjithshme ekonomike të PBB-së përmes "transferimeve të pakushtëzuara" nga niveli qendror (buxheti i shtetit) në nivelin nënkombëtar (bashkitë/niveli i parë i njësive të qeverisjes vendore dhe qarqeve/niveli i dytë); dhe ii. krijojnë kushte të favorshme për njësitë e qeverisjes vendore për të rritur të ardhurat e tyre nga burimi vetjak (të hyrat vetjake), të dyja të drejtuara në një nivel të duhur të financimit të funksionit të shpenzimeve përmes të ardhurave të liruara diskrecionale, granteve të kushtëzuara nga

---

[68] Ligji nr. 9936 parashikon klasifikimin e buxhetit në Shqipëri - përfshirë kodet dhe emërtimet për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme (entet e qeverisjes qendrore dhe lokale, si dhe fondet e posaçme). Buxheti i çdo njësie të qeverisë së përgjithshme është i ndarë në fusha të programit (politikës). Programi buxhetor është një grup i aktiviteteve të njësive të qeverisjes së përgjithshme që menaxhohen në mënyrë efektive dhe së bashku kontribuojnë në rezultate të identifikueshme dhe të matshme, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt ose indirekt në arritjen e objektivave dhe qëllimeve të politikës së tij buxhetore. Secili program buxhetor ndahet në aktivitete (grup aktivitetesh të ndërmarra në nivelin e programit për shpërndarjen e një rezultati), dhe rezultate (mallra dhe shërbime të ofruara nga aktivitetet e një programi buxhetor).

[69] Përfundimet në lidhje me mbrojtjen sociale dhe shpenzimet e arsimit në vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të nxirren në bazë të statistikave kombëtare, të cilat nuk janë të krahasueshme me Sistemin Evropian për Metodologjinë e Integruar të Statistikave të Mbrojtjes Sociale (ESSPROS), e cila përdoret nga BE-ja/Eurostati.

[70] http://www.perform.network/upload/resources/documents/1510824428602_The_Welfare_State_in_Western_Balkan_Countries_Position_Paper.pdf

ministritë e linjës ose alokimeve nga Fondi i Zhvillimit Rajonal (RDF).

Transferta specifike parashikohen, gjithashtu ,për tre vjet për të financuar funksionet e reja të vetë LG me grante të kushtëzuara dhe për të lejuar Qeverinë Qendrore të rregullojë sistemin ndërqeveritar të financave (dhe legjislacionin sektorial/harmonizimin) që u drejtohet bashkive për të mbuluar shpenzimet për përgjegjësi të reja nga të ardhurat e përgjithshme (që është diskrecion bazuar në taksat/tarifat dhe transferimet e pakushtëzuara).

Ekzistojnë edhe transferime, të cilat nuk bazohen në formulat e buxhetit dhe kanë të bëjnë me funksione të dekoncentruara, të deleguara ose të ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive lokale dhe janë krijuar për të kompensuar shpenzime specifike, siç janë pagesa për përfitime *cash* ose kosto specifike për sigurimin e shërbimit të kujdesit social. **Fondi social**, për shkak të fillimit në 2019-ën, do të kontribuojë në shpenzimet financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social bazuar në planet sociale të bashkisë. Fondi Social do të jetë një grant specifik i bazuar në rregullat ligjore dhe rregullatore/legjislacionin sekondar. Qeveria shqiptare do të ndjekë një praktikë të vëzhguar gjerësisht të financimit të shërbimeve specifike përmes transferimeve shtesë për të mbuluar hendeqet financiare për funksionet e shpenzimeve që në parim janë të decentralizuara de jure dhe mbulojnë, të paktën në një fazë tranzicioni, hendeqet midis shpenzimeve nënkombëtare dhe të ardhurave. Transfertat e përcaktuara për shpenzime specifike do të bashkëjetojnë me transferimet e përgjithshme në rastin e shërbimeve të kujdesit social.

Nënfinancimi total në nivelin qendror të qeverisë bazuar në zbatimin e objektivave dhe masave të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (NSSP), dhe mirëqenien e fëmijëve në shkolla dhe arsimin gjithëpërfshirës, siç përcaktohet në Veprimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar (PEU) është 129.7 milionë euro. Në kontekstin e zbatimit të strategjisë së decentralizimit, mungesat për mandatet e pa financuara në shërbimet e kujdesit social (vlerësuar 15.8 milionë euro) dhe arsimit (9 milionë euro) 24.8 milionë euro. Kjo do të thotë që në PBA 2018–2021 mandatet e pa financuara në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë dhe arsimin gjithëpërfshirës në të gjithë qeverinë qendrore dhe qeverisjen lokale arrijnë në 154.5 milionë euro-shihni tabelën 2. Megjithatë ekzistojnë dallime të mëdha në aftësitë e bashkive për të mobilizuar të hyrat vetjake dhe NJQV-të mbeten shumë të varura nga burimet e nivelit kombëtar, në veçanti, në lidhje me financimin e mandateve të reja të tilla si shërbimet e kujdesit social. Transferimi i pakushtëzuar është burimi kryesor që përdoret për të financuar shumicën e funksioneve vetjake në sektorët e transportit dhe infrastrukturës, menaxhimin e mbeturinave si dhe arsimin.

MTBP 2019–2021 pasqyron të gjithë elementet thelbësore të reformës së përfshirjes sociale në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë dhe arsimin gjithëpërfshirës. Dispozitat e buxhetit për reformat në strategjitë përkatëse të sektorit janë llogaritur pjesërisht, por përgatitjet e PBA-së 2020–2023 do të duhet të sigurojnë që mandatet e pafinancuara në mbrojtjen sociale, punësimin dhe aftësitë dhe arsimin gjithëpërfshirës të minimizohen. Koha dhe kostot e planeve të veprimit të NESS-së dhe NSSP-së të rishikuara do të duhet të rishikohen në baza vjetore dhe t'i përshtaten progresit të zbatimit të PBA-së dhe anasjelltas.

Në lidhje me historikun, të gjitha pjesët përkatëse të legjislacionit të cilat janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të reformave në strategjinë e NESS-së janë miratuar; po kështu, në strategjinë e NSSP-së dhe ndërfaqen e saj me PUES dhe arsimin gjithëpërfshirës. Mbi bazën e vlerësimit, NESS-ja dhe zgjatja e tyre deri më 2022-shin konsiderohen të rëndësishme dhe të besueshme si strategjitë themelore të zhvillimit të sektorit për këtë Kontratë të Reformës Sektoriale.

*Politika makroekonomike*

Pas rritjes së ngadaltë dhe tërmetit në 2019-ën, Shqipëria po përballet me një recesion të thellë në 2020-ën, teksa recesioni edhe në BE po prek remitancat dhe flukset hyrëse IHD, duke ushtruar presion mbi llogarinë rrjedhëse dhe kursin e këmbimit.

Që para shpërthimit të krizës nga COVID-19, rritja vjetore e PBB-së ishte ngadalësuar ndjeshëm në 2.2% në vitin 2019, kryesisht nga rënia e prodhimit hidroelektrik, për shkak të reshjeve nën mesataren, situatë kjo që u përkeqësua nga tërmeti i fuqishëm i nëntorit që shkaktoi dëme materiale të

mëdha dhe humbje jetë njerëzish. Përveç kësaj, finalizimi i disa projekteve të mëdha energjetike rezultoi në tkurrje të investimeve me 4.1%. Konsumi familjar vazhdoi të jetë lokomotiva kryesore e rritjes (+3.3% në terma vjetorë), bazuar në rritjen e pagave dhe punësimin, sepse performanca e shumicës së sektorëve qëndroi relativisht e fortë. Rritja e punësimit u përshpejtua në 2.4% dhe pagat nominale u rritën me 3.8% në vitin 2019. Shkalla e papunësisë (15–64 vjeç) pësoi rënie në 12% në vitin 2019, ose 0.8 pikë përqindjeje më pak në terma vjetorë, ndërsa norma e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore u rrit në 69.6% në vitin 2019. Rritja e fuqishme e eksportit të shërbimeve, kryesisht turizmi, zbuti rënien e eksportit të energjisë elektrike, teksa eksportet neto kontribuuan në rritje me 0.6 pikë përqindjeje.

Konsolidimi fiskal ka vazhduar, por qeverisja fiskale shfaqi dobësi. Në vitin 2019, deficiti fiskal rezultoi 1.8% më pak se plani, pjesërisht për shkak të shpenzimeve më të ulëta të buxhetit kapital. Në përgjigje të tërmetit, qeveria planifikoi fillimisht një rritje të deficitit fiskal me 2.2% të PBB-së në vitin 2002. Raporti i borxhit publik neto ndaj PBB-së pësoi rënie me 1.4 pikë përqindjeje, duke arritur 66.3% në fund të vitit 2019; borxhi i jashtëm publik u rrit në 30.2% të PBB-së. Vitet e fundit, qeveria e zhvendosi borxhin publik duke rritur afatet e maturimit, me qëllim që të ulte nevojat e larta buxhetore vjetore, por nevojat e rifinancimit mbeten të larta.

Deficiti i lartë i llogarisë korrente u rrit lehtë nga 6.8% në vitin 2018 në 7.6% të PBB-së në vitin 2019, për shkak të tepricës së lartë të balancës së shërbimeve, kryesisht prej turizmit, ndërsa remitancat sa 5.2% e PBB-së nuk arritën të zbutin rritjen e deficitit të tregtisë së mallrave gjatë vitit 2019. IHD neto mbetën të qëndrueshme në raport me PBB-në në 7.9%, si edhe vazhduan të mbulojnë plotësisht deficitin e llogarisë rrjedhëse. Borxhi i jashtëm bruto u tkurr në rreth 60% të PBB-së (2 pikë përqindjeje më poshtë sesa viti 2018). Rezervat valutore mbuluan më shumë se 6 muaj importe dhe 40% të borxhit të jashtëm.

Norma e inflacionit ra në 1.4% në vitin 2019, shumë poshtë objektivit 3% të bankës qendrore. Banka e Shqipërisë ka mbajtur të pandryshuar kahun lehtësues të politikës monetare gjatë vitit 2019.

Kursi real efektiv i këmbimit u rrit me 9% nga fundi i vitit 2018, duke pasqyruar përshpejtimin e mbiçmimit të monedhës shqiptare, teksa gjatë vitit 2019 iu kthye niveleve normale.

Është përmirësuar stabiliteti i sektorit financiar, teksa bankat vazhduan të pakësojnë huat me probleme. Megjithatë, huadhënia për biznesin mbeti e shtrënguar dhe vazhdoi përdorimi i valutës në tregun e brendshëm. Ligji i ri për falimentin ende pret miratimin e akteve nënligjore, ndërsa mosmarrëveshjet po pengojnë zbatimin e ndryshimeve në ligjin për përmbaruesit privatë.

Në Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2020–2022 që u miratua në janar 2020 para se të shpërthente COVID-19, Shqipëria parashikonte që rritja ekonomike të arrinte në 4.1% deri në vitin 2020, bazuar në kërkesën e fuqishme të brendshme private, për shkak të rritjes së punësimit, rritjes së pagave dhe të kushteve të favorshme të kreditimit për familjet. Projeksionet për investimet private ishin se do të ruanin nivelin e qëndrueshëm prej 17.8% të PBB-së gjatë periudhës 2019–2021, pak më poshtë krahasuar me 18.5% të PBB-së në vitin 2018. Pritet që kjo situatë të përkeqësohet më tej pas emergjencës me COVID-19 në mars–prill dhe me masat shtrënguese të qeverisë, që shkaktuan bllokim të aktivitetit për shumicën e sipërmarrjeve. Eksportet neto pritet të japin vetëm një kontribut të lehtë në zgjerimin ekonomik. Parashikimet e rritjes duken optimiste, duke parë përkeqësimin e mjedisit të jashtëm, nivelet e ulëta të kreditimit të biznesit, si edhe dobësitë afatgjata në mjedisin e biznesit.

Në PRE, Shqipëria konfirmoi angazhimin për të vazhduar uljen e borxhit publik nga piku prej rreth 73% të PBB-së në vitin 2015, në rreth 65.4% të PBB-së në vitin 2020; 62.3% të PBB-së në vitin 2021 dhe 62.0% më 2022-shin. Për të arritur këtë ulje, skenari fiskal bazë synon deficitin fiskal në nivelin e 2.2% të PBB-së në vitin 2020; 2.0% më 2021-shin; dhe 1.7% në vitin 2022, duke synuar një bilanc primar pozitiv. Niveli relativisht i ulët i shpenzimeve publike nuk lejon shkurtime të mëdha të shpenzimeve, çka shpjegon deri diku ritmin e moderuar në uljen e borxhit. Përjashtimet e shumta nga TVSH-ja kohët e fundit do të ndërlikojnë përpjekjet për të zgjeruar bazën e tatimpaguesve dhe për të përmirësuar efikasitetin e mbledhjes së taksave, kombinuar me informalitetin dhe evazionin fiskal në ekonominë formale.

Në vitin 2019, shpenzimet kapitale ishin në nivelin 4.5% të PBB-së ose sa 15.2% i shpenzimeve totale, krahasuar me 4.8% të PBB-së dhe 16.5% të shpenzimeve totale më 2018-ën. Për periudhën 2020–2022, investime publike shtetërore vlerësohen mesatarisht sa 4.7% e PBB-së për secilin vit (ose rreth 5.5% të PBB-së, nëse përfshihen investimet e qeverisjes vendore). Ende shfaqen dobësi në planifikimin dhe menaxhimin e shpenzimeve kapitale. Me qëllim që të ngushtojë hendekun e madh infrastrukturor, qeveria po synon të mobilizojë kapital privat, kryesisht përmes partneriteteve publik-privat (PPP). Varësia në rritje te PPP-të krijon detyrime kontingjente dhe rrjedhimisht edhe rreziqe fiskale, për të cilat kapacitetet monitoruese janë të kufizuara.

Kombinimi i politikave makroekonomike ka qenë përgjithësisht i përshtatshëm dhe Shqipëria ka respektuar rregullat fiskale, kryesisht duke ruajtur uljen e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së derisa të arrihet limiti 45%, pavarësisht forcës madhore të tërmetit. Zbatimi i buxhetit dhe MFP-ja duhet të forcohen, për të shmangur akumulimin e detyrimeve ndaj biznesit dhe për të menaxhuar risqet fiskale. Rritja e të ardhurave tatimore mund të ndihmojë për të përshpejtuar arritjen e limit 45% të borxhit ndaj PBB-së, gjë që do të forconte qëndrueshmërinë e borxhit.

Teksa efektet e krizës së COVID-19 te ekonomia shqiptare vazhdojnë të thellohen, qeveria synon të rritë huamarrjen dhe deficit buxhetor pritet të rritet në vitin 2020, për të garantuar shërbimet bazë dhe për të ndihmuar bizneset të mbijetojnë; qeveria është e angazhuar që të ruajë konsolidimin fiskal në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Pas ndryshimit të buxhetit të shtetit në mars, një rishikim i dytë i buxhetit u miratua në prill 2020.

*Në tërësi, është përmbushur kriteri i një politike makroekonomike të besueshme dhe të orientuar drejt stabilitetit të duhur.*

*Menaxhimi i financave publike*

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë (MFE) ngriti mekanizma konsultimi ndërministror dhe brenda ministrive që të realizojë rishikimin afatmesëm të Strategjisë së Reformës së MFP 2014–2020, si edhe që të hartojë dhe të konsultojë Strategjinë e Reformës së MFP 2019–2022 që është e rishikuar dhe e zgjeruar. Rishikimi afatmesëm i Strategjisë së MFP-së përfundoi me një tryezë të rrumbullakët konsultimi në mars 2019, e cila identifikonte prioritetet gjatë periudhës së zgjatur deri në vitin 2022, që përfshijnë ndër të tjera: menaxhimin e investimeve publike, përfshirë proceset e fragmentuara të miratimit, përzgjedhjes dhe monitorimit për projektet e investimeve publike, PPP-të dhe koncesionet; analiza e monitorimit, raportimit dhe zbutjes së risqeve fiskale; riakumulimi i detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit[71] në nivelin e qeverisjes vendore dhe qendrore, pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të para vitit 2014; përmirësimin e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; forcimin e standardeve të kontrollit të brendshëm në të gjithë nivelet e qeverisjes, në përputhje me politikën tërësore KBFB; akses *online* te thesari për të gjitha institucionet buxhetore; si edhe krijimin e një shtylle të posaçme për mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Rishikimi i strategjisë shënoi zhvendosje të fokusit nga masat te rezultatet dhe produktet, përfshirë treguesit e performancës dhe kostimin.

Këtë proces e udhëhoqi njësia e koordinimit pranë MFE-së për lehtësimin dhe monitorimin e zbatimit të masave dhe treguesve të reformës, për të cilën konsultimet filluan në korrik 2019 dhe u përmbyllën në shtator 2019 nga Komiteti Drejtues i MFP-së si një mekanizëm zyrtar shtetëror për dialogun dhe konsultimin. Në dhjetor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi strategjinë MFP 2019–2022 si një version të rishikuar dhe të zgjeruar.

2019-ta shënoi vitin e pesë të zbatimit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike (MFP) dhe të planit të veprimit përkatës. Raportet e monitorimit njëvjeçare publikohen në gjuhën shqipe dhe angleze.[72] Në tërësi, Shqipëria ka shënuar progres, por që është ngadalësuar pas tërmetit në nëntor 2019 dhe situatës së COVID-19 në gjysmën e parë të vitit 2020. Në veçanti, është vonuar miratimi dhe zbatimi i kuadrit koordinues

[71] http://www.financa.gov.al/al/raportime/shlyerja-e-detyrimeve-te-prapambetura

[72] Në anglisht: https://financa.gov.al/ëp-content/uploads/2018/08/2017-PFM-Strategy-Monitoring-Report.pdf;
në shqip: https://financa.gov.al/ëp-content/uploads/2018/08/2017-Raporti-i-Monitorimit-t%C3%AB-trategjis%C3%AB-s%C3%AB-MFP-s%C3%AB.pdf

dhe monitorimi periodik siç parashikohet në strategjinë e rishikuar.

Vlerësimi i Përgjegjshmërisë Financiare dhe Shpenzimeve Publike (PEFA) i vitit 2017[73] tregon performancë të përzier, teksa 15 nga 31 tregues shfaqin performancë të fuqishme, ndërsa 16 treguesit e tjera kanë performancë të dobët. Krahasimi i agreguar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2011 tregon se nuk ka asnjë ndryshim në performancë për 16 tregues, përmirësim për 5 tregues, si edhe rezultat më të ulët për 7 tregues. Nga këto 7 tregues, tri rezultate nuk lidheshin me ndryshimin e performancës, por me një interpretim tejet optimist të kuadrit në vitin 2011. *Në tërësi, konsiderohet i përmbushur kriteri i një programi të besueshëm dhe relevant për përmirësimin e menaxhimit të financave publike.*

*Transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit*

Qeveria e Shqipërisë publikoi buxhetin 2020 në faqen e internetit të MFE-së[74] (propozimin dhe miratimin e buxhetit) në kohën e duhur për publikun e gjerë, si edhe në formë të shtypur në Fletoren Zyrtare[75]. Prandaj, *kriteri bazë konsiderohet i përmbushur, pasi si propozimi i buxhetit nga ekzekutivi dhe buxheti i miratuar janë publikuar brenda afatit ligjor.* Në tërësi, transparenca buxhetore është përmirësuar vitet e fundit për sa i përket sasisë dhe relevancës së informacionit si në nivel qendror edhe vendor, me zbatimin e reformës së MFP-së dhe udhërrëfyesit të transparencës. Tashmë, qeveria publikon të gjitha dokumentet buxhetore kyçe[76] në afate që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, raporti i mesvitit, publikuar për herë të parë në vitin 2017[77], mbulon pesë në vend të gjashtë muajve – në linjë me ligjin organik të buxhetit. Nisma BOOST përmirësoi aksesin publik në të dhënat buxhetore[78] dhe MFE-ja në bashkëpunim me Co-Plan krijuan një portal transparence për financat vendore[79]. Një problematikë kyçe është transparenca e pabarabartë mes bashkive, që duhet të adresohet sistematikisht. Është publikuar raporti i ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018,[80] por ka vend për përmirësim lidhur me raportimin për asetet shtetërore dhe mundësinë e krahasimit me buxhetin fillestar.

Më i fundit indeks i buxhetit të hapur është 55 (2019) krahasuar me 50 (2017) dhe 38 (2015)[81], çka tregon përmirësim në vazhdimësi. Sipas PEFA 2017, shumica e treguesve pësuan ndryshim për sa i përket performancës përkundër rezultateve tejet optimiste të PEFA 2011, me përjashtim të dokumentimit të buxhetit (TP-5). Raportet mujore të ekzekutimit të buxhetit publikohen në kohën e duhur, por mbulimi dhe klasifikimi i të dhënave nuk lejon krahasim drejtpërdrejtë me buxhetin fillestar, ndërkohë që shpenzimet kapen në fazën e pagesës (TP-28). Raportet financiare vjetore dorëzohen në kohën e duhur për auditimin e brendshëm, por nuk paraqesin krahasim mes buxhetit fillestar dhe ekzekutimit aktual, si edhe nuk zbulohen diferencat mes standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare (TP-29).

Ekzistojnë boshllëqe për sa i përket vëmendjes adekuate që duhet t'i kushtojë Parlamenti dhe ndjekjes së rekomandimeve (TP-30 dhe TP-31). Ligjvënësi nxjerr rekomandime për masa që duhen zbatuar, por nuk i monitoron ato. Dëgjesat mbahen në publik, me pak përjashtime. Auditimi i jashtëm ka mbulim të gjerë, por duhet përmirësuar zbatimi i rekomandimeve. KLSH-ja zhvilloi një sistem për të gjurmuar zbatimin e rekomandimeve, i cili pritet të bëhet plotësisht funksional në vitin 2020. Në vitin 2018, KLSH-ja nxori për herë të parë një opinion për raportin e ekzekutimit të buxhetit 2017. Vrojtimi i buxhetit të hapur (2019) e vlerësoi mbikëqyrjen me 65 pikë, pak më poshtë se në vitin 2017 (69 nga 100 pikë); prandaj, mbikëqyrja e auditit u konsiderua adekuate me 72 pikë, ndërsa mbikëqyrja legjislative pak mbi adekuate me 61 pikë (41–60 pikë është "i kufizuar"). Rekomandimi i VBH-së në këtë drejtim është që një komision legjislativ duhet të shqyrtojë ekzekutimin vjetor të buxhetit dhe të publikojë në internet raportet me konstatimet.

Vrojtimi i buxhetit të hapur vlerësoi Shqipërinë me 7 nga 100 pikë (me ngritje nga 2 pikë në vitin

---

[73] Referenca PEFA: https://pefa.org/assessments/albania-2017
[74] http://www.financa.gov.al/buxheti-2020/
[75] http://www.qbz.gov.al/
[76] Përfshirë buxhetin e qytetarit: https://financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit-2/
[77] http://financa.gov.al/buxheti-2017/
[78] https://financa.gov.al/boost/
[79] http://www.financatvendore.al/

https://financa.gov.al/buxheti-faktik-2018/
[80] https://www.internationalbudget.org/open-budget-survey/country-results/2019/albania [80] https://financa.gov.al/buxheti-faktik-2018/
[81] https://www.internationalbudget.org/open-budget-survey/country-results/2019/albania

2017), sepse ofron pak mundësi për publikun që të angazhohet në procesin e buxhetit. Megjithatë, mesatarja globale për këtë tregues është vetëm 14 pikë, mesatarja e OECD-së është 23 pikë; në rajon, renditjen e kryesojnë Kroacia (22 pikë) dhe Sllovenia (11). Rishikimi i ligjit organik të buxhetit më 2016-ën përfshiu konsultime me shoqërinë civile si kërkesë ligjore për të formalizuar nismat që më parë ishin vullnetare. Vlerësimi i ulët për Shqipërinë rezulton kryesisht ngaqë konsultimi publik është i kufizuar, vetëm gjatë procesit të miratimit të buxhetit, në vend që të bëhet edhe gjatë hartimit, miratimit dhe auditimit të buxhetit.

Në vitin 2018 u miratua një instrument planifikimi financiar i ri për PBA-në për njësitë vendore, si edhe manuali përkatës, të cilat u zbatuan në kuadrin e masave të trajnimit dhe forcimit të kapaciteteve të personelit. Udhëzimi i ri standard për hartimin e PBA-së do të forcojë rolin e këtij instrumenti për procesin e (përgatitjes së) buxhetit dhe alokimin strategjik të burimeve. MFE-ja publikon raportet e monitorimit të buxhetit të qeverisjes vendore mbi baza tremujore.[82] Në perspektivën afatmesme, një sfidë e veçantë - veçanërisht për qeverisjen vendore do të jetë – do të jetë realizimi i përqasjes me dy hapa: kostimi dhe buxhetimi i burimeve

Vlerësimi Kodi i Transparencës Fiskale të FMN-së[83] publikuar në vitin 2016, vlerësoi dhjetë nga 36 parime të kodit "mirë" ose "avancuar", si dhe 14 parime "bazë". Sidoqoftë, në tetë fusha, kërkesat bazë të Kodit "nuk janë përmbushur". Vlerësimi i transparencës së FMN-së nuk është përditësuar që nga viti 2016 dhe, si rrjedhojë, nuk pasqyron progresin e mundshëm në dy vitet e fundit.

Shqipëria vlerësohet se ka arritur progres domethënës në Standardet e Nismës për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse (EITI), siç konfirmohej nga bordi më 17 qershor 2019. Vlerësimi i dytë në vitin 2019 treguan performancë të përmirësuar në të gjitha kërkesat, krahasuar me vitin e parë, me përjashtim të tërësisë së mbledhjes së të ardhurave (#4.1) që pësoi përkeqësim. Objektivi afatgjatë është që deri në vitin 2020 të arrihet "Deklarimi i pronësisë përfituese".

[82] https://financa.gov.al/buxheti-i-pushtetit-vendor/
[83] http://www.imf.org/external/np/sec/pr/2016/pr1611.htm

Shqipëria është pjesë e Moneyvalit, mekanizmi i përhershëm i monitorimit rajonal që vlerëson përputhshmërinë dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (të ashtuquajturat "standarde FATF"). Mangësitë strategjike të sistemit shqiptar të nënvizuara në raundin e pestë të Raportit të Vlerësimit të Ndërsjellë nxitën FATF-në që të kryejë procesin e listimit, që rezultoi në vendosjen e Shqipërisë nën vëzhgim njëvjeçar. Më 17 qershor 2019, Parlamenti miratoi "paketën Moneyval" për të trajtuar pjesën teknike të rekomandimeve, përfshirë ndryshimet ligjore në katër ligje ekzistuese (për procedurat tatimore, regjistrimin e biznesit, financimin e terrorizmit, si edhe parandalimin e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit), si edhe miratimin e një ligji të ri për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Ndryshimet kryesore që u miratuan përfshinin detyrimin e bizneseve dhe OJF-ve që të hapin një llogari bankare, përmirësimin e transparencës për pronësinë përfituese të shoqërive tregtare, transpozimin më të shpejtë të sanksioneve të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së OSBE-së për bllokimin e pasurive të terrorizmit, si edhe zgjerimin e kompetencave të agjencisë përgjegjëse për pasuritë e konfiskuara. Pavarësisht progresit në disa fusha, plenarja Moneyval e vlerësoi si të pamjaftueshëm progresin e përgjithshëm të arritur në zbatimin e rekomandimeve, duke bërë që Shqipëria të përfshihej në listën gri të FATF-së në shkurt 2020.

Shqipëria ka nënshkruar Konventën për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore; është palë në kuadrin gjithëpërfshirës të Projektit Ndërkombëtar BEPS (mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit); si edhe palë e forumit global për shkëmbimin e informacionit me kërkesë, që ka qenë gjerësisht në përputhje sipas raundit të parë të vlerësimit. Raundi i vlerësimit i radhës është planifikuar për në vitin 2020. *Në tërësi, konsiderohet i përmbushur kriteri për transparencën dhe për mbikëqyrjen e buxhetit.*

b) Objektivat

Objektivi i përgjithshëm është zgjerimi i mbulimit, gjithëpërfshirja, efektiviteti dhe përballimi i emergjencave nga shërbimet e kujdesit e social, arsimi parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

Objektivat specifikë janë: i. përmirësimi i aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor; ii. promovimi i përfshirjes sociale në punësimin dhe punësueshmërinë e rinisë, meshkujve dhe femrave; iii. përmirësimi i nxënies cilësore gjithëpërfshirëse dhe promovimi i formimit arsimor në arsimin parauniversitar për të gjitha vajzat dhe djemtë – me fokus të veçantë te romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara dhe kategoritë e tjera të cenueshme.

c) Rezultatet e pritshme

Rezultatet e pritshme janë:

- sistemi i integruar i shërbimeve të kujdesit social dhe komunitar në nivel vendor ngrihet dhe bëhet funksional;
- ngrihet kuadri financiar dhe rregullator për standarde dhe praktika moderne të kujdesit social;
- përmirësohet mirëqenia e fëmijëve në shkolla;
- rritet përfshirja dhe mirëqenia e fëmijëve me nevoja të veçanta;
- rritet pjesëmarrja në tregun e punës, përfshirë nga të rinjtë, femrat, meshkujt dhe popullatat e tjera në rrezik përjashtimi;
- zgjerohet oferta e arsimit dhe formimit profesional (AFP) e përshtatur sipas nevojave të të rinjve, femrave, meshkujve dhe popullatave të tjera në rrezik përjashtimi nëpër bashki;
- rritet gama dhe synueshmëria e mbështetjes me asistencë monetare për familjet, në përgjigje të krizës së COVID-19;
- zgjerohet mbështetja për familjet më në nevojë përmes operacioneve ndihmëse, në përgjigje të krizës së COVID-19;
- rritet gama e masave të synuara për të papunët, në përgjigje të krizës së COVID-19.

d) Aktivitetet kryesore të mbështetjes buxhetore:

- Aktivitetet kryesore për zbatimin e paketës së mbështetjes buxhetore janë: dialogu për politikat, transfertat financiare, vlerësimi i performancës, raportimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.
- Angazhimi në dialog rreth kushteve dhe prioriteteve të reformave qeveritare, verifikimi i kushteve dhe pagesa e mbështetjes buxhetore.

Aktivitetet e detajuara janë:

- Angazhimi në dialogun për politikat mbi kushtet dhe prioritetet e reformave të qeverisë, verifikimi i kushteve, objektivave dhe pagimi i mbështetjes buxhetore;
- Transferimi i 50.65 milionë eurove vendit përfitues gjatë viteve fiskale 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024, me disbursimet e transheve fikse dhe variabël;
- Mbështetje e vazhdueshme për të forcuar kapacitetet institucionale të Qeverisë për zbatimin e Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS), Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe masat shtesë për të zgjeruar objektin dhe ofrimin e arsimit gjithëpërfshirës;
- Përmirësimi i aftësive dhe i kapaciteteve të fuqisë punëtore në nivel vendor dhe qendror, për të garantuar cilësi të mirë të ofrimit të shërbimeve sociale; aftësimin për arsim gjithëpërfshirës të mësuesve, psikologëve, punonjësve socialë dhe personelit tjetër nëpër shkolla, institucione AFP dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit; zhvillim të aftësive në menaxhim rastesh dhe praktika të tjera bashkëkohore në punën me nevojat e posaçme të grupeve të ndryshme përmes asistencës teknike;
- Forcimi i koordinimit të donatorëve përmes dialogut periodik dhe forcimit të kapaciteteve në kuadrin e strategjive për Mbrojtjen Sociale dhe Punësim dhe Aftësi, si edhe të arsimit gjithëpërfshirës përmes asistencës teknike dhe skemave grant;
- Forcimi i koordinimit dhe mbështetjes në përballimin e krizës së COVID-19 në fushën e mbrojtjes sociale dhe punësimit;
- Forcimi i sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit për të gjurmuar zbatimin e strategjive për mbrojtjen sociale dhe punësim dhe aftësi, si edhe të dimensioneve të arsimit gjithëpërfshirës dhe përfshirjes sociale në arsimin parauniversitar (APU);
- Forcimi i koordinimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, si edhe i partneriteteve mes bashkive dhe shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve dhe në monitorimin e vlerësimin e standardeve të reja dhe ekzistuese të ofrimit të shërbimit;
- Monitorimi periodik i kritereve të pranueshmërisë për mbështetjen buxhetore;
- Komunikimi dhe vizibiliteti i mbështetjes buxhetore e lidhur edhe me grantet në mbështetje të nivelit vendor;
- Rritja e transparencës dhe konsultimeve publike me aktorët e shoqërisë civile dhe palët e tjera kyçe të sektorit, si p.sh. operatorët e biznesit dhe partnerët socialë.

- Grantet që synojnë të mbështesin partneritetet bashkiake dhe të zgjerojnë ofrimin e shërbimeve; përmirësimin e tregut të punës dhe arsimit gjithëpërfshirës për popullatat rome dhe egjiptiane; si edhe zgjerimin e masave të arsimit gjithëpërfshirës në 320 shkolla - përfshirë shkollën për fëmijët me paaftësi dëgjimi dhe fëmijët me paaftësi shikimi.

e) Masat plotësuese

- Masa është pjesërisht vazhdim i Programit të Reformën Sektoriale, në kuadrin e IPA 2015, që mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2015–2020). Synimi i saj është të avancojë agjendën e përfshirjes sociale në fushat e punësimit dhe aftësive, kujdesit social dhe arsimit gjithëpërfshirës në Shqipëri.

- Asistenca plotësuese e këtij programi të mbështetjes buxhetore ka dy elemente: një me menaxhim indirekt me Shqipërisë, si edhe një me menaxhim direkt (prokurimet dhe grantet – lutemi, shihni metodat e zbatimit korrespondues).

***3. b) Menaxhimi Indirekt nga Shqipëria***

Një pjesë e kësaj mase do të zbatohet me menaxhim indirekt nga Shqipëria, që do të jetë përgjegjëse për realizimin e të gjitha detyrave lidhur me zbatimin e masës. Masa kontribuon direkt në objektivin specifik 3: Forcimi i kapaciteteve për nxënie me bazë kompetence dhe arsimin gjithëpërfshirës të përmirësuar në mbarë vendin bazuar në standardet e BE-së. Treguesi kyç i performancës është numri i mësuesve të trajnuar për kurrikulat parauniversitare të nivelit 1–5, bazuar në nxënien e kompetencave kyçe.

Struktura/t operuese përgjegjëse për ekzekutimin e masave janë: a) Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (CFCU); b) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si Koordinator Kombëtar IPA dhe c) Ministria e Arsimit që do të jetë përfituesja kryesore e aktivitetit.

Vendi përfitues do të jetë përgjegjës për kontraktimin, zbatimin, informimin dhe vizibilitetin, monitorimin dhe raportimin për aktivitetet IPA II, si edhe vlerësimin e tyre sipas rastit, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar të qëndrueshëm, si edhe për garantimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve të kryera në zbatimin e programit.

***3.(c) Menaxhimi direkt (qasja e projektit)***

**Prokurimi**

Rezultatet e pritshme nga mbështetje e asistencës teknike plotësuese janë:

- Monitorim i qëndrueshëm i zbatimit të mbështetjes buxhetore;

- Rritje ndërgjegjësimi për politikat dhe strategjitë SKPA dhe SKMS;

- Forcim i kapaciteteve teknike dhe organizative të MSHMS-së, MASR-së, MFE-së dhe bashkive që të koordinojnë dhe të zbatojnë masat e përfshirjes sociale dhe punësimit përmes grupeve të menaxhimit të integruar të politikave (GMIP) dhe grupeve tematike (GT), si edhe të një grupi për nxënien dhe zhvillimin e politikave dhe praktikave (PPDL) që fokusohet te koordinimi me bashkitë.

Zarfi buxhetor global rezervuar për prokurimin: 8,700,000 euro.

**Grantet**

a) Qëllimet e grantit/eve:

- Granti do të kontribuojë në arritjen e rezultateve të pritshme si më poshtë:

- Zgjerim i rrezes së shërbimeve të integruara të kujdesit social, masave të punësimit dhe arsimit gjithëpërfshirës në nivel vendor në përputhje me planet sociale të bashkive; përfshirë masat për mbrojtjen e grupeve të cenueshme nga kriza e fundit COVID-19.

- Rritje të përfshirjes sociale për të rinjtë dhe të rriturit romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga zgjerimi i rrezes së shërbimit të punësimit dhe arsimit gjithëpërfshirës në secilën bashki; duke përfshirë ndikimin e krizës së COVID-19 mbi këtë grup në fushën e punësimit dhe arsimit.

b) Llojet e aplikantëve të synuar: Për të pasur pranueshmërinë për grante, aplikanti duhet të jetë: a) organ publik, ose organ përkatës i autorizuar nga një departament qeveritar i një Shteti Anëtar të BE-së; ose b) një autoritet përgjegjës vendor në Shqipëri; ose c) organizatë ndërkombëtare (ndërqeveritare), siç parashikohet në nenin 62, germa "c", të rregulloreve financiare të BE-së; ose d) organizata jofitimprurëse, organizatë e shoqërisë civile.

c) dhënia e grantit direkt: N/A;

d) përjashtimi nga mosfuqia prapavepruese e kostove: *E pazbatueshme.*

Zarfi buxhetor global rezervuar për grantet: 9,300,000 euro

**4. Objekti i pranueshmërisë gjeografike për prokurimet dhe grantet**

Pranueshmëria gjeografike, për sa i përket selisë për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si dhe për sa i përket origjinës së mallrave të blera parashikohen në aktin bazë dhe përcaktohen në dokumentet kontraktuale përkatëse.

Në zbatim të nenin 10, pika 2, e rregullores (BE) nr. 236/2014, zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund të zgjerojë objektin e pranueshmërisë gjeografike mbi bazën e urgjencës apo të mungesës së produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve në fjalë apo në raste të tjera të vërtetuara, siç duhet ku rregullat e pranueshmërisë do ta bënin realizimin e kësaj mase të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë.

## 2. BUXHETI

### 2.1 TABELA INDIKATIVE E BUXHETIT – PROGRAMI I VEPRIMIT PËR SHQIPËRINË VITI 2019

| | | Menaxhim i tërthortë | | Menaxhim i drejtpërdrejtë | Kontributi total i BE (euro) | Përfituesi IPA-II ose kontributi i një pale të tretë (euro) | Totali (euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Me Përfituesin IPA II | Me një subjekt të besueshëm | | | | |
| | | Kontributi i BE-së (euro) | Kontributi i BE-së (euro) | Kontributi i BE-së (euro) | | | |
| **Objektivi 2** | **07. Arsimi, punësimi dhe politikat sociale** | **2,000,000** | **0** | **68,650,000** | **70,650,000** | **1,255,555** | **71,905,555** |
| | Veprimi 2 BE për përfshirjen sociale | 2,000,000 | 0 | 68,650,000 | 70,650,000 | 1,255,555 | 71,905,555 |
| | **TOTALI** | **2,000,000** | **0** | **68,650,000** | **70,650,000** | **1,255,555** | **71,905,555** |

**3. Marrëveshjet për monitorimin e performancës**

Si pjesë e kornizës së tij të matjes së performancës, Komisioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifikë të përcaktuar në rregulloren IPA II në bazë të treguesve të matshëm të paracaktuar, të qartë dhe transparentë. Raportet e progresit të referuara në nenin 4 të rregullores IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të ndihmës IPA II.

Komisioni do të grumbullojë të dhëna të performancës (treguesit e procesit, produktit dhe rezultateve) nga të gjitha burimet, të cilat do të grumbullohen dhe analizohen për sa i përket ecurisë së progresit kundrejt objektivave dhe pikave të përcaktuar për secilën prej veprimeve të këtij programi, si dhe në Dokumentin Strategjik Kombëtar.

Në kontekstin specifik të menaxhimit të tërthortë nga Përfituesit IPA II, Koordinatori Kombëtar i Fondeve IPA (KKIPA) do të mbledhë informacion mbi performancën e veprimeve dhe programeve (treguesit e procesit, produktit dhe rezultateve) dhe koordinojnë mbledhjen dhe prodhimin e treguesve që vijnë nga burime kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mjeteve të mëposhtme: a) Sistemi i Monitorimit të Orientuar të Rezultatit (MOR); b) Monitorimi vetjak i Përfituesve të IPA II; c) vetë-monitorimi i kryer nga delegacioni i BE-së; d) monitorimin e përbashkët nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit dhe Përfituesit IPA II, ku pajtueshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi në zbatimin e ndihmës financiare do të monitorohen rregullisht nga një Komitet Monitorues IPA II, i mbështetur nga Komitetet e Monitorimit Sektorial, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel sektori.

**5. Vlerësimi**

Duke u nisur nga rëndësia dhe natyra e veprimit, vlerësimet finale ose ato *ex-post* do të organizohen për këtë veprim ose komponentët e tij përmes konsultantëve të pavarur të kontraktuar nga Komisioni

Një vlerësim përfundimtar dhe *ex post* do të kryhet për për qëllime llogaridhënieje dhe nxjerrje mësimesh në nivele të ndryshme (edhe për rishikimin e politikave), duke pasur parasysh veçanërisht zbatimin e mbështetjes buxhetore për përfshirjen sociale.

Komisioni do të informojë partnerët zbatues të paktën 1 muaj përpara për datat e parashikuara kur do të kryhen misionet vlerësuese. Partneri zbatues do të bashkëpunojë efektivisht dhe në mënyrë efikase me ekspertin vlerësues dhe ndër të tjera, t'i mundësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, gjithashtu, të aksesojë në godinën ku zbatohet projekti dhe zhvillohen aktivitetet.

Raportet e vlerësimit i vihen në dispozicion Përfituesit IPA II dhe të grupeve të tjera të interesit. Partneri i zbatimit dhe Komisioni analizojnë përfundimet dhe rekomandimet e vlerësimeve dhe, sipas rastit, vendosin bashkërisht dhe në marrëveshje me Përfituesin IPA II për masat ndjekëse që duhen ndërmarrë dhe për modifikime të nevojshme, përfshirë edhe riorientimin e projektit nëse duhet.

SHTOJCA III
MODELI I RAPORTIT VJETOR

Periudha e mbuluar nga raporti:
1.1/20XX–31.12.20XX
Raporti i publikuar më XX.XX.20XX

**Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga *[vendi]* të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar IPA**

**I. Përmbledhje ekzekutive**

1. Referenca për objektivat e dokumenteve strategjike të vendit dhe një pasqyrë e përmbledhur e sfidave në sektorë.
2. Përfshirja në programim.
3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.
4. Problemet e hasura në përmbushjen e kushteve të kërkuara për zbatim dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, masat e ngjashme të marra/planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.
5. Çështjet përkatëse që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit nga IPA II në Komitetin Monitorues të IPA-së dhe në komitetet monitoruese sektoriale (përfshirë Komitetin e Përbashkët Monitorues për CBC/BNK (bashkëpunimi ndërkufitar), nëse ka.
6. Përfshirja në aksionet shumëvendëshe dhe çështjet që lidhen me to.

7. Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit, mësimet e nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve.
8. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit.
9. Koordinimi i donatorëve.
*Në rastin e menaxhimit e tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të mbulojë, gjithashtu:*
10. Zbatimin e përgjithshëm të asistencës IPA nën menaxhimin e tërthortë (maks. një faqe).
11. Problemet kryesore horizontale të ndeshura gjatë zbatimit të asistencës IPA dhe masat.
12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maks. gjysmë faqe).
13. Auditimet - konstatimet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të marra.

**II. Të dhënat për sektor**

**Titulli i sektorit[84]:** *[Transporti]*

Pjesa narrative/treguese: përmbledhja për sektor, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
1. Përfshirja në programim.
2. Përmbledhje e rezultateve në lëvizjen drejt një qasjeje të përsosur sektoriale (d.m.th. objektivat e arritur, sipas udhëzuesit të sektorit në dokumentin e planifikimit të sektorit).
3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe/ose donatorë/IFN në sektor.
4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit për zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në sektor, planifikim strategjik dhe buxhetim.
*Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet, gjithashtu, informacioni i mëposhtëm:*
5. Struktura/t operuese në funksionim dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e nevojshme: *[Ministria e Transportit];*
6. Të dhëna mbi zbatimin e programeve në sektor.
7. Arritjet kryesore në sektor.
8. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara p.sh. vonesat në kontraktim, dhe masat vijuese të marra/ planifikuara.
9. Rekomandime për masat e mëtejshme.
10. Aktivitetet e zbatuara për monitorimin dhe vlerësimin, auditimet – konstatimet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe masat korrigjuese të marra.

**Titulli i sektorit: Bashkëpunimi Ndërkufitar[85]**

1. Përfshirja në programim sipas rastit.
2. Progresi i bërë në zbatimin e programit të CBC/BNK-së dhe, veçanërisht në arritjen e objektivave specifikë për prioritetet tematike (duke përfshirë elementet cilësore dhe sasiore që tregojnë progresin në lidhje me objektivat).
3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe të gjitha masat korrigjuese të marra, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme korrigjuese.
4. Monitorimi, duke përfshirë marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme, aktivitetet e vlerësimit.
5. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit.
6. Koordinimi me vendin partner.

Në menaxhimin e tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm*:*
1. Strukturat operuese në funksion dhe ndryshimet që lidhen me to, nëse është e rëndësishme.
2. Çdo problem i rëndësishëm i hasur në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh., vonesat në kontraktim dhe masat vijuese të marra/ planifikuara.
3. Rekomandimet për veprime të mëtejshme
4. Auditimet e zbatuara – konstatimet kryesore dhe rekomandime dhe masat korrigjuese të marra.

[84] Sipas sektorëve në dokumentet strategjike indikative.

[85] Për bashkëpunimin ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

**II a) Treguesit e performancës në *[p.sh., Transport]* sektorin që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:**

**Treguesit[86] për program**

| Marrëveshja e Financimit/referenca[87] e programit | Treguesi për sektor *[Transport]* | Burimi | Pikënisja | Arritjet e rëndësishme (2017) | Objektivi (2020) | Vlera (2014[88]) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Programi i vendit 2014* | *Shkurtimi i kohës mesatare të udhëtimit të pasagjerëve ndërmjet qendrave të mëdha urbane me anë të mënyrës së transportit* | | | | | |
| *Programi shumëvjeçar 2014–20xx* | *Kosto të reduktuara transporti për njësi prodhimi* | | | | | |

**II b) Përmbledhje e nivelit të aksionit për sektor *[p.sh., Transport]***

| Marrëveshja e Financimit/ referenca e programit | Aksioni/veprimi | Gjendja aktuale/progresi për aksion të veçantë (p.sh., termat e referencës në përgatitje, tenderi i nisur, kontraktuar, në zbatim, i përfunduar) | Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre | Probleme të rëndësishme të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra/ planifikuara për kapërcimin e tyre | Zhvillimet që ndikojnë në procesin e zbatimit në të ardhmen | Rekomandime për masa të mëtejshme korrigjuese |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *[Programi i vendit 2014]* | *Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufirin me xxx* | *P.sh., kontratë shërbimi për përgatitjen e termave të referencës për kontratën e punimeve të nënshkruar dhe në zbatim, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë në tremujorin e dytë të vitit 2015* | | *P.sh., kontratë shërbimi për përgatitjen e termave të referencës, sepse kontrata e punimeve u vonua, ndërsa procedura e negocimit dështoi dhe duhet të rifillonte* | *P.sh., ndryshimi i së drejtës vendëse, si dhe qasja me zbatimin e paketës së katërt të hekurudhave* | |

*Në menaxhimin e tërthortë duhet të parashikohen edhe shtojcat e mëposhtme:*

**Shtojca 1**

Përmbledhje e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe të kontrollit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maks. një faqe).

Transparenca, vizibiliteti, aktivitetet e informimit dhe komunikimit në përputhje me MK (marrëveshja kuadër, maks. një faqe).

**Shtojca 2**

Histori suksesi. (Shënim. Kjo pjesë mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare të përgatitur nga Komisioni Evropian.)

**Shtojca 3**

Plani vjetor i prokurimit.

*Për menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë duhet të parashikohen gjithashtu shtojcat e mëposhtme:*

**Shtojca 4**

Udhëzuesi për qasjen e sektorit – arritjet (duke theksuar nëse janë përmbushur apo jo objektivat e planifikuar).

[86] Këta duhet të jenë kryesisht rezultate, si dhe tregues të prodhimit përkatës të përzgjedhur.

[87]

[88] Numri i kolonave të përshtatet për të gjitha vitet nga 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

# SHTOJCA IV(a)
# RAPORT VJETOR FINANCIAR - BUXHETI I PËRGJITHSHËM

## Raporti financiar i Përfituesit IPA II (*)

| Referenca e Programit | Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit | Buxheti i Programit | | | Veprimtaritë vendore të kontratës | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | Konteksti i rikthimit | | | | Balancat bankare (kontribut i BE-së) | | | Disbursimet e parashikuara | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Shuma e Përgjithshme e Kontraktuar | | | Shuma e Përgjithshme e Çliruar në përfundim | | | % e çlirimit | | | Shuma e përgjithshme e disbursuar | | | % e disbursimit | | | Kostot e Përgjithshme të Përcaktuara | | | % e Kostove | | | Totali i parafinancimeve të hapura | | | % e parafinancimeve të hapura | | | Gabime | Parregullsi | Mashtrim | Pa Kontekst | Gjithsej | Gjithsej si % e buxhetit | Gjithsej si disbursime të parashikuara mujore | 12 muajt e ardhshëm | % e programit të buxhetit |
| 1 | 2 | 3 | | | 4 | | | 5 | | | 6 | | | 7 | | | 8 | | | 9 | | | 10 | | | 11 | | | 12 | | | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 20 | 21 | 22 |
| | | Kontribut i BE-së | Kontribut kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE-së | Kontribut kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE-së | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE-së | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE-së | Kontribut kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE | Kontribut kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE-së | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | Kontribut i BE | Kontribut Kombëtar | Burimet të tjera | | | | | | | | | |
| NP2010 | 2010/123-456 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| CBC AA/BB 2010 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

# SHTOJCA IV(b)
# RAPORTI VJETOR FINANCIAR - KONTRIBUTET E BE-së PËR PROGRAME TË VEÇANTA

## Raporti financiar i Përfituesit IPA II (*)

| Referenca e Programit | Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit | Buxheti i Programit Kontribut i BE-së | Veprimtaritë vendore të kontratës | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shuma e përgjithshme e kontraktuar | Shuma e kontraktuar | % e çlirimit | Shuma e përgjithshme e disbursuar | % e disbursimit | Kostot e përgjithshme të përcaktuara | % e kostove | Totali i parafinancimeve të hapura | % e parafinancimeve |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| NP2010 | 2010/123-456 | | | 4/3*100% | 6/4*100% | | 8/4*100% | | 10/4*100% | | 12/4*100% |
| Nënprogrami | | | | | | | | | | | |
| Veprimi | | | | | | | | | | | |

(*) 15 shkurt

## SHTOJCA IV(c)
## RAPORTI VJETOR FINANCIAR - KONTRIBUTET E BE-së TË THJESHTUARA KONSOLIDUARA

**Raporti financiar i Përfituesit IPA II (*)**

| Referenca e Programit | Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit | Buxheti i Programit Kontribut i BE-së | Veprimtaritë vendore të kontratës | | | | | Balancat bankare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shuma e përgjithshme e kontraktuar | Shuma e përgjithshme e çliruar pas përfundimit | Shuma e përgjithshme e disbursuar | Kostot e përgjithshme të përcaktuara | Totali i parafinancimeve të hapura | Gjithsej |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| NP2010 | 2010/123-456 | | | | | | | |

(*) 15 janar

## SHTOJCA IV(d)
## PARASHIKIMI I PAGESAVE

| Referenca e Programit | Parashikimet e planifikuara të disbursimeve (shtoni vite sipas nevojës) | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Parashikimi i disbursimeve mujore (viti 1) | | | | | | | | | | | | Gjithsej, viti 1 | Viti 2 | Viti 3 |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | | | |
| NP2010 | | | | | | | | | | | | | 0 | | |
| CBC AA/BB 2010 | | | | | | | | | | | | | 0 | | |

**DEKRET**
**Nr. 11970, datë 18.2.2021**

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 13/2021, "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë, për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 27, datë 29.1.2021**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "AGETA" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "BORIE – LURË 1" ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a", të nenit 5, pika 1, germa "a", dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 15/3 prot., datë 26.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 259, datë 28.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendndodhje në ujërat e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me "Njoftimin për licencim" nr. 62/47 prot., datë 29.12.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Ageta" sh.p.k.
- Me shkresën nr. 32 prot., datë 11.1.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Ageta" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/1 prot., datë 18.1.2021 dhe nr. 32/2 prot., datë 25.1.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë prodhimi të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c". Plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e". Plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d". Plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC); 4.1.2 (të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); 4.1.3 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), germat: "a", "b", "c", "d"; 4.1.4 (dokumentacioni tekniko-ekonomik), germat: "a", "b", "c", "d", "e" dhe pika 4.1.5 (lejet nga

institucionet e tjera), germat: "a", "b", "c". Plotësuar.

- Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE, brenda 3 muajve, miratimin nga MIE të shoqërisë "Ageta" sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese, në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Borie – Lurë 1', me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë "Bajrami N" .

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 9.4.2022), do t'i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas rinovimit të saj.

- Kontrata nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., date 16.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Borie – Lurë 1', me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër", e lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Ageta" sh.p.k., dhe "Bajrami N" sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Borie – Lurë 1", me kapacitet të instaluar 1800 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria të dokumentojë në ERE, brenda 3 muajve, miratimin/njoftimin nga MIE të shoqërisë "Ageta" sh.p.k. si përfaqësuese dhe zbatuese, në vijim të kontratës nr. 65 rep., nr. 38/1 kol., datë 16.1.2018, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Borie – Lurë 1', me kapacitet prodhues 1800 kw, në rrjedhën e përrenjve të kurorës se Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, qarku Dibër, pas tërheqjes/largimit të shoqërisë 'Bajrami N'".

3. Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Dibër (data e përfundimit 16.11.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

4. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 9.4.2022), do t'i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara një muaj pas rinovimit të saj.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 28, datë 29.1.2021

## MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "AGETA" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e", të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i

ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 15/2 prot., datë 26.1.2021 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 260, datë 28.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me "Njoftimin për licencim" nr. 62/47 prot., datë 29.12.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Ageta" sh.p.k.

- Me shkresën nr. 32 prot., datë 11.1.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Ageta" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 32/1 prot., datë 18.1.2021, nr. 32/2 prot., datë 25.1.2021 dhe 32/3 prot., datë 26.1.2021, ka paraqitur dokumentacionin e munguar, i cili është pasqyruar në pjesët takuese të këtij relacioni.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, për t'u pajisur me licencën e tregtimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c". Plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "d", "e". Plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d". Plotësuar;

-dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c". Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Ageta" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 29, datë 29.1.2021**

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË FTL SHA, PËR DISA NDRYSHIME NË "RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT, DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 103/2016, TË BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa "l" dhe 69, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244/2016, "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar; të nenit 21, të "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të

miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 103, datë 23.6.2016, të ndryshuar, dhe të nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.15/4 prot., datë 28.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut, mbi miratimin e kërkesës së Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL sh.a.), për disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria FTL sh.a., me shkresën nr. 2773 prot., datë 23.9.2020, ka parashtruar kërkesën për rishikimin e pikës 1/c, të nenit 11, të "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar.

-Shoqëria FTL sh.a. e bazon kërkesën për ndryshimin e pikës 1/c, të nenit 11, të rregullores sipërcituar, në dy arsye kryesore: së pari eliminimin e kostove financiare të përditësimit të dokumenteve çdo tre (3) muaj; dhe së dyti referuar praktikave më të mira të industrisë dhe precedentëve lokal, në lidhje me tregtimin e energjisë elektrike.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 178, datë 4.11.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për një ndryshim në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të ERE-s.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 1203 prot., datë 12.11.2020, ndryshimet e propozuara në vendimin e Bordit të ERE-s, sipërcituar, janë dërguar për opinione/komente palëve të interesuara, përkatësisht: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a., Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Foring Investors Assocation of Albania (FLAA), *Albania Renewable Energy Association* (AREA) dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në shkresën nr. 1203 prot., datë 12.11.2020, afati i përcaktuar për opinione/komente nga palët e sipërcituara u përcaktua 30 ditë nga marrja dijeni. Me përfundimin e këtij afati, u konstatua se asnjë nga palët e interesuara nuk ka përcjellë opinione/komente, lidhur me sa parashtruar në vendimin e Bordit nr. 178/2020.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 2.12.2020, vendosi miratimin e "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit".

- Përcaktimet e nenit 10, të "Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-S nr. 202, datë 2.12.2020, janë të njëjta me ato të nenit 11, të "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103/2016, të ndryshuar.

- Sa më sipër, vlerësohet se në nenin 11, pika 1, e "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të ndryshuar, të Bordit të ERE-s, "Dokumentacioni ligjor dhe administrative", të shtohet germa "d", me përmbajtje:

"Pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit dhjetor të çdo viti, duhet të deklarojnë nëse kanë pësuar ndryshime në statusin ligjor, në përputhje me kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në germën "c", të nenit 11. Në çdo kohë, blerësi mund t'i

kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar paraqitjen, brenda 30 ditëve dhe jo më shumë se 2 herë në vit, të dokumenteve të parashikuara në germën "c" të këtij neni, me qëllim verifikimin e deklarimit, si dhe statusin ligjor të subjektit. Në rast se konstatohet deklarimi i pasaktë, si dhe mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar, sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i blerësit.".

- Gjithashtu, duke qenë se me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 202/2020 është miratuar "Rregullorja për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit", e cila shërben për shitjen e energjisë elektrike dhe "Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të ndryshuar, të Bordit të ERE-s, e cila shërben vetëm për blerjen e energjisë elektrike, shihet i nevojshëm korrigjimi i titullit të kësaj rregulloreje duke hequr fjalën "shitje", pasi ky akt në tërësinë e vet nuk përcakton procedura për shitjen e energjisë elektrike por vetëm për blerjen e energjisë elektrike.

- Fjala "shitje" hiqet përkatësisht dhe në përmbajtjen e nenit 2, pika 1; të nenit 4, pika 2 dhe 13; të nenit 6, germa "b".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik", të miratuar me vendimin nr. 103/2016, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë**, të ndryshuar, si vijon:**

A. Neni 11, pika 1, germa "c":

*Ishte:*

Dokumentacionin lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, jo më vonë se 3 muaj që nga paraqitja e ofertës, i cili duhet të vërtetojë, që:

*Bëhet:*

Dokumentacionin lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, i cili duhet të vërtetojë që:

B. Në nenin 11, pika 1, shtohet germa "d": Dokumentet e parashtruara në germën "c", të këtij neni, do të përtërihen nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit dhjetor të çdo viti, dhe do të jenë të vlefshëm për vitin pasardhës. Në çdo rast dhe në çdo kohë blerësi mund t'i kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar, paraqitjen, brenda 30 ditëve dhe jo më shumë se 3 herë në vit, të secilit nga dokumentet e parashikuar në germën "c" të këtij neni, me qëllim verifikimin e statusit ligjor të subjektit. Mosdërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i blerësit.".

Çdo pjesëmarrës në një procedurë blerjeje, sipas kësaj rregulloreje, do të dorëzojë deklarimin për ndryshimet mbi statusin ligjor, që lidhet me dokumentacionin e përcaktuar në nenit 11/1, brenda afateve të përcaktuar nga blerësi.

C. Rregullorja emërtohet: "Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit, dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik".

D. Hiqet fjala "shitje" në nenin 2, pika 1; në nenin 4, pika 2 dhe 13; në nenin 6, germa "b".

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 30, datë 29.1.2021**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERDY ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e", të nenit 5, pika 1 germa "e", dhe të nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.15/1 prot., datë 26.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë "Erdy Energy" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 208, datë 11.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Erdy Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/43 prot., datë 15.12.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Erdy Energy" sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1232/1 prot., datë 11.12.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1232/2 prot., datë 14.12.2020, ka përcjellë pjesërisht dokumentacionin e munguar dhe duke qenë se u konstatua sërish mungesë, ERE iu drejtua sërish shoqërisë me shkresën nr. 1232/3 prot., datë 15.12.2020, duke i kërkuar të përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar në këtë aplikim.
- Shoqëria, me shkresën nr. 105, datë 22.1.2021, ka përcjellë të gjithë dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencën e tregtimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar, si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c". Plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e". Plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d". Plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c". Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Erdy Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 31, datë 4.2.2021**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ARIS ALBANIA" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "GURI I ZI", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC "DAZNJANË" ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, DHE HEC "SHËLLI" ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "a", të nenit 5, pika 1, germa "a", të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 20/7 prot., datë 1.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë "Aris Albania" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Aris Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109 prot., datë 25.1.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Daznjanë" me kapacitet të instaluar 1518 kw, me vendndodhje në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër; HEC "Guri i Zi" me kapacitet të instaluar 1719 kw, me vendndodhje në pjesën e sipërme të lumit Kurvajt dhe në degët e tij, Bashkia Mat, qarku Dibër, dhe HEC "Shëlli" me kapacitet të instaluar 1518 kw, me vendndodhje në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin Kurvajt, ky i fundit me derdhje në Liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "Aris Albania" sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", pa plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "e", "f", "g", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat: 4.1.2; 4.1.3, germat: "a", "b", "c", "d", dhe pika 4.1.4, germat: "a", "b", "c", "e", "f", plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: "a", "c", plotësuar.

- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht apo të pa plotësuar që ka të bëjë me:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa "a" (të dhënat për aplikim), germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit )dhe germa "c" (të dhëna për aplikuesin);

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa "d" (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata e qarkut të Dibrës për administratorin e saj, duke qenë se shoqëria nuk ka seli në Tiranë);

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1, të dhëna teknike për HEC "Guri i Zi", "Daznjanë" dhe "Shëlli" (plotësimi i "Ekonomisë pyjore" dhe "Datës së fillimit të operimit për të tri HEC");

- lejet nga institucionet e tjera, neni 9, pika 4.1.5, germa b. Leja e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike për HEC "Shëlli", do të

njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë ato brenda afateve.

- Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC "Daznjanë" dhe nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC "Guri i Zi", do t'i kërkohet shoqërisë që t'i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 16.7.2021), do t'i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Kontrata me nr. 2638 rep., nr. 1242/3 kol., datë 24.11.2017, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Guri i Zi', me kapacitet prodhues 1719 kw, në pjesën e sipërme të lumit të Kurvajt dhe në degët e tij, Bashkia Mat, qarku Dibër"; kontrata me nr. 2639 rep., nr.1243 kol., datë 24.11.2017, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Daznjanë', me kapacitet prodhues 1518 kw, në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzëz, Bashkia Mat, qarku Dibër"; kontrata me nr. 2440 rep., nr. 1244/3 kol., datë 24.11.2017, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Shëlli', me kapacitet prodhues 1518 kw në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzëz, Bashkia Mat, qarku Dibër", të lidhura midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit shoqërisë "Aris Albania" sh.p.k., kanë një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Aris Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Guri i Zi" me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC "Daznjanë" me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC "Shëlli" me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 32, datë 4.2.2021

## MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "E-VENTO SRL ALBANIA" SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 84, DATË 17.7.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes se licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 20/8 prot., datë 3.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 84, datë 17.7.2008, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën

tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve, për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) kryerjen e një studimi fizibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve;

b) shoqëria "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k., duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit;

c) shoqëria "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;

d) koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj;

e) mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në vendimin nr. 84/2008, të ndryshuar.

- Së fundi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 253, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria, në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur te përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 84/2008, të ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme' dhe të ligjit nr. 43/2015, 'Për Sektorin e Energjisë Elektrike'". Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese, për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese, të cilat kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, për ndërtimin e parqeve eolike, është përcjellë një memo mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë e elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

- Sipas projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, rezulton se një pjesë e mirë e turbinave të shoqërisë "E-Vento S.R.L Albania" sh.p.k. kalojnë në zona historike, rreth 15% e sipërfaqes ku do të ndërtohen turbinat bie në zona të mbrojtura.

- MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit të kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut:

Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (infrastruktura.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të

plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. nr. 60, seria NPM08P.

3. Shoqëria "E-Vento s.r.l Albania" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 33, datë 4.2.2021**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ERS-08" SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 63, DATË 13.6.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes se licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 20/8 prot., datë 3.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 13.6.2008, ka vendosur:

1. Licencimin e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me ere, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga Parku eolik Kavajë, me kusht zbatimin, përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) kryerjen e një studimi fizibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve;

b) shoqëria "ERS-08" sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit;

c) shoqëria "ERS-08" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;

d) koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj;

e) mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në vendimin nr. 63/2008, të ndryshuar.

- Së fundi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 252, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë "ERS-08" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria, në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur te përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 63/2008, të ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme' dhe të ligjit nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike'. Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese të cilët kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, për ndërtimin e parqeve eolike, është përcjellë një memo mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

- MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut:

Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (infrastruktura.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "ERS-08" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 63, datë 13.6.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "ERS-08" sh.p.k. nr. 59, seria NPM08P.

3. Shoqëria "ERS-08" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 34, datë 4.2.2021

## MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "HERA" SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 2.11.2007, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes se licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 20/8 prot., datë 3.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 2.11.2007, ka vendosur:

Dhënien e licencës shoqërisë "HERA" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (projekti KAPPET), me fuqi 150 mgw, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

1. Brenda një afati kohor 9-mujor të realizojë:

- Sigurimin e dokumenteve të pronësisë, duke realizuar kalimin nga premtim shitjeje në titull pronësie dhe realizimin e kontratave të huapërdorjes ose qiramarrjes, për të gjithë sipërfaqen e nevojshme për realizimin e projektit.

- Kryerja e një studimi fizibiliteti që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të

eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim edhe i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE përpara fillimit të punimeve, për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

2. Shoqëria "Hera" sh.p.k., duhet të paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.

3. Shoqëria "Hera" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

4. Koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj.

5. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në vendimin nr. 61/2007, të ndryshuar.

- Së fundi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë "HERA" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur te përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 61/2007, të ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme' dhe të ligjit nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike'". Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese të cilët kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i për ndërtimin e parqeve eolike, është përcjellë një memo mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë e elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut:

Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (infrastruktura.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "HERA" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "HERA" sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P.

3. Shoqëria "HERA" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 35, datë 4.2.2021**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "BIOPOWER GREEN ENERGY" SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 90, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes se licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 20/8 prot., datë 3.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 90, datë 6.8.2008, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "Biopower Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike "BPGE 1" dhe "BPGE 2", me kusht zbatimin, përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) kryerjen e një studimi fizibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve;

b) shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit;

c) shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar;

d) shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s oponencën tekniko-ekonomike nga ekspertë të licencuar brenda 60 ditëve nga lëshimi i licencës;

e) koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj;

f) mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në vendimin nr. 90/2008, të ndryshuar.

- Së fundi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 251, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6. 8.2008, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe të dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur te përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 90/2008, të ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike

eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar për ndërtimin e impianteve eolike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme' dhe të ligjit nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike'". Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.02.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese të cilët kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, për ndërtimin e parqeve eolike, është përcjellë një memo mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë e elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

- Sipas projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, rezulton se një pjesë e turbinave të shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. është vendosur në zonën e aeroportit.

- MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut:

Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (infrastruktura.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. nr. 64, seria NPM08P.

3. Shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 36, datë 4.2.2021

## MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ALBANIAN GREEN ENERGY" SHPK PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 89, DATË 6.8.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5 dhe 6, të "Rregullores për procedurat e heqjes se licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 20/8 prot., datë 3.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 89, datë 6.8.2008, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "Albanian Green Energy" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë, me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) shoqëria duhet të paraqesë pranë ERE-s oponencën tekniko-ekonomike nga ekspertë të licencuar, brenda 60 ditëve nga lëshimi i licencës;

b) shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. duhet të paraqesë pranë ERE-s marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit;

c) Shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik, që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;

d) koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës, të jetë 36 muaj;

e) mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

- Në vijim, me vendimet përkatëse, Bordi i ERE-s ka miratuar shtyrjet e afateve të plotësimit të kushteve të sipërcituara në vendimin nr. 89/2008, të ndryshuar.

- Së fundi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 250, datë 21.12.2020, vendosi të shtyjë me 30 ditë afatin e vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 90, datë 6.8.2008, të ndryshuar, me qëllim verifikimin e plotë të dosjes së dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të kërkesës së shoqërisë për shtyrje të afateve të plotësimit të kushteve, si dhe dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga shoqëria në kuadër të monitorimit, për të vlerësuar statusin e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe duke u mbështetur te përfundimet e monitorimit, ka rezultuar se nga ana e shoqërisë kanë mbetur ende pa u plotësuar disa kushte të vendimit nr. 89/2008, të ndryshuar.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 714/1, datë 13.7.2020, ka bërë me dije qëndrimin e saj si vijon: "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është dakord me shtyrjen e afatit të licencave të lëshuara nga ERE, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese nga energjia elektrike eolike, pasi është në fuqi baza ligjore për të aplikuar, për ndërtimin e impianteve eolike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme' dhe të ligjit nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike'". Të njëjtin qëndrim MIE ka mbajtur edhe në takimin e datës 3.2.2021, të zhvilluar mes përfaqësuesve të MIE-s, BERZH-it dhe ERE-s, duke theksuar se nuk duhet të zgjaten afatet e plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit të këtyre subjekteve, pasi kjo mund të binte në kundërshtim me strategjinë e MIE-s për zhvillimin e procedurave konkurruese për ndërtimin e këtyre objekteve gjeneruese të cilët kanë mundësinë e marrjes pjesë në ankandin që do të zhvillohet.

- Në kuadër të projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, për ndërtimin e parqeve eolike, është përcjellë një memo mbi statusin ligjor të licencave ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike nga era dhe revokimin e mundshëm të tyre, si dhe një studim mbi zonat potenciale për ndërtimin e këtyre parqeve eolike dhe zonat në të cilat, për shkak të statusit të tyre, nuk mund të ndërtohen parqe të tilla.

- Sipas projektit të asistencës që MIE ka marrë nga BERZH-i, rezulton se një pjesë e mirë e turbinave (gati 1/3) të shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k., që përfshijnë zonat e Balldrenit, Dajcit dhe Bushatit, kalojnë në zona historike, si dhe pranë aeroportit. Po ashtu turbinat në zonën e Balldrenit të Rid dhe Shëngjinit kalojnë tërësisht në zona të mbrojtura.

- MIE ka publikuar njoftimin për hapjen e ankandit e kapaciteteve të reja gjeneruese, nëpërmjet linkut:

Shprehje Interesi - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (infrastruktura.gov.al).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 89, datë 6.8.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k. nr. 63, seria NPM08P.

3. Shoqëria "Albanian Green Energy" sh.p.k. ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 48, datë 15.2.2021**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRJES NË SHQYRTIM TË KËRKESËS, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s, NR. 169, DATË 3.11.2020, "PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR DHJETËVJEÇAR, 2015 – 2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SHA"**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germat "a" dhe "e", të nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 3, pika 7, germa "a", të nenit 33, pika 1, të nenit 53, pika 3 dhe neneve 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të neneve 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12, të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 135, datë 6.9.2017, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 27/4 prot., datë 11.2.2021, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), për shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 3, datë 15.1.2021, vendosi shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.", deri në 30 ditë.

- OST sh.a., me shkresën drejtuar në ERE nr. 165/1 prot., datë 9.2.2021, parashtroi se:

- OST sh.a. është në pritje të finalizimit të masterplanit: "Plani mbi investimet dhe zhvillimin e rrjetit për sektorin e transmetimit të energjisë në shqipëri për vitet 2018–2033", pasi të jenë reflektuar dhe elemente të tjera që mund të dalin nga studimi i masterplanit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Pavarësisht se procesi i hartimit të këtij dokumenti ka hyrë në fazën përfundimtare dhe angazhimi për dërgimin e draftit final të masterplanit për miratim në ERE ishte brenda muajit janar 2021, për shkaqe të pavarura nga OST sh.a., të imponuara nga masat që janë marrë për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga virusi *COVID-19*, ka qenë e pamundur finalizimi i këtij drafti final, kjo si pasojë e kufizimeve që ka pësuar qoftë kontraktori, qoftë personeli i OST sh.a.

- Një nga risitë e masterplanit është edhe metodologjia e zhvillimit të tij, e cila është zbatuar në studim. Ky trajtim merr në konsideratë të gjithë paketën e investimeve ekzistuese, si dhe zgjerimin, të cilit i përkasin projektet e reja që dalin si rezultat i analizës së rrjetit në projeksion për të ardhmen.

- Për sa parashtruar më sipër, dhe veçanërisht referuar kushteve të ushtrimit të aktivitetit nga personeli i OST sh.a., në mënyrë të kufizuar, si në numër dhe në eficiencë, kërkohet marrja në konsideratë e kërkesës për shtyrje të afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga

OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, data 3.11.2020, "Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a."

- Kërkesa e parashtruar nga OST sh.a. ka ardhur brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 3, datë 15.1.2021.

- OST sh.a. është palë me interes të drejtpërdrejtë në këtë proces, në kuptim të parashikimeve të nenit 3, pika 7, germa "a" dhe "b", si dhe të nenit 33, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe për këtë arsye legjitimohet si palë në këtë procedurë për shkak të interesit të drejtpërdrejtë në këtë vendimmarrje.

- Për të analizuar të gjithë elementet e nevojshëm, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, OST sh.a., duhet të paraqesë të gjithë informacionin e kërkuar nga ERE nëpërmjet komunikimeve zyrtare, me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 53, pika 3 dhe nenet 91 dhe 92, të Kodit të Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për dorëzimin e dokumentacioneve nga ana e shoqërisë OST sh.a., brenda 30 ditëve.

2. Shoqëria OST sh.a. të paraqesë realizimin faktik të investimeve për vitin 2020, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 29
Datë: 2021/02/25 15:39:23
9aac86b4-d75b-4851-85a5-ba316da54caf

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*


| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 368 lekë